



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2023 – Numri: 2

Tiranë – E enjte, 5 janar 2023

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 871, datë 27.12.2022	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikualifikimi i Sheshit të Flamurit”, Bashkia Vlorë..... 139
Udhëzim i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 27, datë 23.9.2022	Për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 589, datë 7.9.2022, “Për rregullat dhe procedurat për konfiskimin për interes publik të objekteve të ndërtuara pa leje, për qëllim fitimi”..... 141
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 57, datë 21.12.2022	Për miratimin e rregullores “Për ushtrimin e veprimtarisë dhe mbikëqyrjen e institucioneve të parasë elektronike”..... 143
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 58, datë 21.12.2022	Për miratimin e disa ndryshimeve në rregulloren “Për administrimin e rrezikut në veprimtarinë e subjekteve financiare jobanka”..... 155
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 59, datë 21.12.2022	Për miratimin e rregullores “Për krahasueshmërinë e tarifave të lidhura me llogaritë e pagesave dhe për shërbimin e transferimit të llogarive të pagesave..... 156
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 63, datë 21.12.2022	Për miratimin e rregullores “Për raportimin statistikor të mjeteve dhe detyrimeve të fondeve të investimit”..... 174
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 64, datë 21.12.2022	Për miratimin e rregullores “Për raportimin statistikor të mjeteve dhe detyrimeve të fondeve të pensionit”..... 197
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 65, datë 21.12.2022	Për miratimin e rregullores “Për raportimin statistikor të mjeteve dhe detyrimeve të shoqërive të sigurimit”..... 213
Vendim qarkullues i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave nr. 38, datë 29.12.2022	Për miratimin e formatit standard të skedarëve të raportimit të të dhënave nga bankat dhe shoqëritë e kursim-kreditit..... 238

**VENDIM****Nr. 871, datë 27.12.2022**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË
PRIVATE, QË PREKEN NGA
REALIZIMI I PROJEKTIT
“RIKUALIFIKIMI I SHESHIT TË
FLAMURIT”, BASHKIA VLORË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikualifikimi i Sheshit të Flamurit”, Bashkia Vlorë.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Vlorë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “truall” dhe “ndërtesë”, me një vlerë të përgjithshme prej 15 004 074 (pesëmbëdhjetë milionë e katër mijë e shtatëdhjetë e katër) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 15 004 074 (pesëmbëdhjetë milionë e katër mijë e shtatëdhjetë e katër) lekësh, përballohet nga Bashkia Vlorë.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga Bashkia Vlorë.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Bashkisë Vlorë.

8. Bashkia Vlorë kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Vlorë.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Vlorë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë për pasuritë e shpronësuar në favor të Bashkisë Vlorë.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Vlorë, pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistrimit të aktit të kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Vlorë për pasuritë e shpronësuar.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Vlorë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Vlorë, dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**



LISTA EMËRORE E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTTI “RIKUALIFIKIMI I SHESHIT TË FLAMURIT”, BASHKIA VLORË

Nr.	ZK	Nr. i pasurisë	Adresa	Pronari	Lloji i pasurisë	Sipërfaqe e pronës truall	Sipërfaqe e pronës ndërtesë	Sip. truall që preket nga projekti	Çmimi i truallit lekë/m²	Vlera e Truallit Lekë	Sipërfaqe ndërtimi	Çmimi i ndërtimit lekë/m²	Vlera e ndërtimit lekë	Vlera e truall dhe ndërtesë	Shënime në kartelë
1	8603	3/33-T	Vlorë	Pavlo Cika, Fatic Cika	truall	180		180	10,903	1,962,540				1,962,540	Konfirmuar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Vlorë
2	8603	3/15-T	Vlorë	Tefta Rrapi, Anita Rrapi, Alfred Rrapi	truall	210		210	10,903	2,289,630				2,289,630	Konfirmuar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Vlorë
3	8603	3/24	Vlorë	"Pespa&Albania Alumin" shpk	truall	360	217	360	10,903	3,925,080	217		3,300,378	7,225,458	Hipotekohet në favor të Bankës Credins
4	8603	15/3	Vlorë	Faik Bataj	truall	222		222	10,903	2,420,466				2,420,466	Konfirmuar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Vlorë
5	8603	15/12-T	Vlorë	Miti Sholla	truall	4		4	10,903	43,612				43,612	Konfirmuar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Vlorë
6	8601	14/166	Vlorë	Hilmi Nepravishta	truall	354		44	10,903	479,732				479,732	Kufizim – urdhër i regjistruarit
7	8601	14/166-Nd	Vlorë	Ndricim Çobani	Ndërtesë		102				15		582,636	582,636	Mungon marrëdhënia me truallin. Vija e shpronësimit prek 15 m² të objektit e certifikuar. Deklaratë noteriale për dakordësinë për prerjen e objektit hartuar nga dy bashkëpronarë. Akt ekspertize për qëndrueshmërinë nga realizimi i prerjes së objektit. Plotësim dokumentacioni.
VLERA TOTALE														15,004,074	



UDHËZIM
Nr. 27, datë 23.9.2022

**PËR ZBATIMIN E VENDIMIT TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 589,
DATË 7.9.2022, “PËR RREGULLAT DHE
PROCEDURAT PËR KONFISKIMIN PËR
INTERES PUBLIK TË OBJEKTEVE TË
NDËRTUARA PA LEJE, PËR QËLLIM
FITIMI”**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 589, datë 7.9.2022, “Për rregullat dhe procedurat për konfiskimin për interes publik të objekteve të ndërtuara pa leje, për qëllim fitimi”, ministri përgjegjës për administrimin e pronave shtetërore,

UDHËZON:

1. Në zbatim të pikës 1, të VKM-së nr. 589, datë 7.9.2022, “Për rregullat dhe procedurat për konfiskimin për interes publik të objekteve të ndërtuara pa leje, për qëllim fitimi”, të gjitha objektet e ndërtuara pa leje për qëllime fitimi dhe të konfiskuara për interes publik, administrohen nga ministria përgjegjëse për administrimin e pronës shtetërore.

2. Në zbatim të pikës 5, të VKM-së, çdo institucion ligj zbatues, i cili vepron në përputhje me legjislacionin për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, ka detyrim ligjor të hartojë aktin e konstatimit të paligjshmërisë në ndërtim dhe të njoftojë për ndërtimin pa leje ose tejkallim të lejes së ndërtimit subjektin zhvillues, për të lidhur kontratën premtim shitje me vlerën 1 euro për interes publik dhe ministrinë përgjegjëse për administrimin e pronës shtetërore.

3. Drejtoria e Administrimit të Pronës Shtetërore pranë kësaj ministrie, do të njoftojë zhvilluesin ose çdo subjekt të autorizuar prej tij, për mundësinë dhe afatin kohor që ai ka në dispozicion për të rregulluar pasojat e një parregullsie të mundshme në zbatimin e një leje ndërtimi, duke i ftuar të paraqiten vullnetarisht për të kaluar me akt noterial në favor të shtetit, me një kontratë premtim shitje/ me vlerë 1 euro, të drejtën e pronës, të sipërfaqes së ndërtuar pa leje ose në tejkallim të lejes së ndërtimit. Në rastet kur subjekti zhvillues kryen apo nuk kryen nënshkrimin e

kontratës e premtim shitjes me vlerë 1 euro apo kontratën finale të shitjes, Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (referuar më poshtë “IKMT”) njoftohet nga ministria përgjegjëse për administrimin e pronës shtetërore.

4. Me nënshkrimin e aktit noterial sipas pikës 2, të VKM-së, i cili përbën shprehje interesi të subjektit për ndryshim të lejes së ndërtimit, ministria përgjegjëse për administrimin e pronës shtetërore, përcjell këtë akt për shqyrtim në Këshillin Kombëtar të Territorit (*referuar më poshtë KKT*) dhe kur pranohet kërkesa, KKT-ja vendos ndryshimin e lejes përkatëse të ndërtimit duke njohur të drejtën e ministrisë përgjegjëse për administrimin e pronës shtetërore, si bashkë përfituese e objektit të ri. Një kopje e vendimit i dërgohet zyrtarisht subjektit zhvillues dhe ministrisë përgjegjëse për administrimin e pronës shtetërore, me qëllim marrjen e masave për zbatimin e vendimit të konfiskimit. Këshilli Kombëtar i Territorit në vendim do të përcaktojë pjesën takuese të shtetit në përqindje (%-je), në raport me subjektin zhvillues.

5. Procedura dhe afatet e konfiskimit për interes publik, sipas pikës 6 deri në pikën 10 të VKM-së, do të miratohen me vendim të KKT-së dhe do t'u njoftohen institucioneve të përfshira në procedurën e konfiskimit.

6. Me njoftimin e vendimit të KKT-së për konfiskimin e sipërfaqes të ndërtuar pa leje ose në tejkallim të lejes së ndërtimit, Drejtoria e Administrimit të Pronës Shtetërore pranë ministrisë përgjegjëse për administrimin e pronës shtetërore, regjistron vendimin pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës dhe nxjerr urdhrin për marrjen në dorëzim të objektit.

7. Ministri përgjegjës për administrimin e pronës shtetërore, nxjerr urdhrin për zbatimin e vendimit të konfiskimit, i cili përmban:

- autorizimin e Drejtorisë së Administrimit të Pronës Shtetërore për fillimin e procedurës të zbatimit të vendimit të konfiskimit të objektit;

- të dhënat identifikuese të objektit që konfiskohet;

- verifikimin e zbatimit të masave të parashikuara në pikat 2, 3, 4, të VKM-së;

- njoftimin e subjektit ndaj të cilit kryhet konfiskimi, brenda një afati 10-ditor për fillimin e procedurës së konfiskimit.



8. Për ndërtimet që do t'i nënshtrohen parashikimeve të pikës 2, të VKM-së, procedura që do të zbatohet nga Drejtoria e Administrimit të Pronës Shtetërore do të jetë si më poshtë:

- ministri përgjegjës për administrimin e pronës shtetërore, nxjerr urdhrin për vlerësimin e pronës dhe cakton ekspertin/ekspertët vlerësues të licencuar të pasurisë paluajtshme, të cilët do të hartojnë raportin e vlerësimit. Numri i ekspertëve do të përcaktohet nga volumi i ndërtimit të konfiskuar;

- vlerësimi i objektit bëhet në përputhje me vlerën reale të tregut. Ekspertët vlerësues mbajnë përgjegjësi për vlerësimin e kryer, për dokumentet e hartuara e të nënshkruara prej tyre (genplane, situacione, akt vlerësimi) dhe hartojnë raportin përfundimtar të vlerësimit, i cili përmban vlerën minimale të shitjes me ankand. Drejtoria e Administrimit të Pronës Shtetërore, shqyrton raportin e vlerësimit dhe ia paraqet ministrit për miratim;

- shpenzimet për ekspertët përballohen nga ministria përgjegjëse për administrimin e pronës shtetërore, nga të ardhurat e siguruar nga shitja e objektit. Kjo pagesë do të jetë 2 (dy) % e vlerës së objektit apo të grup-objekteve të vlerësuara, por jo më pak se 60.000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë dhe jo më shumë se 300.000 (treqind mijë) lekë pa TVSH;

- afati për vlerësimin do të jetë jo më shumë se 10 (dhjetë) ditë nga dalja e urdhrin të ministrit;

- pas miratimit të raportit të vlerësimit, Drejtoria e Administrimit të Pronës Shtetërore njofton subjektin ndaj të cilit është kryer konfiskimi, për kryerjen e pagesës në llogarinë thesarit, të vlerës prej 10% të çmimit të blerjes, si formë për garancinë e nënshkrimit të kontratës së “Kalimi të drejtash dhe detyrimesh”. Kjo pagesë do të kryhet nga përfituesi, brenda një afati 10-ditor nga dita e njoftimit. Nëse subjekti nuk paraqitet për nënshkrimin e kontratës, vlera e garancisë së kontratës nuk do të kthehet.

9. Procedura e kalimit të të drejtave reale mbi pronën e konfiskuar, do të zhvillohet nëpërmjet ankandit publik në zbatim të ligjit nr. 9874, datë 14.2.2008, “Për ankandin publik”, i ndryshuar. Ndërmjet ministrisë përgjegjëse për administrimin e pronës shtetërore (transferuesi) dhe subjektit zhvillues (përfituesi), nënshkruhet kontrata “Kalimi të drejtash dhe detyrimesh”, e cila mundëson kalimin e të gjitha të drejtave dhe detyrimeve të

cilat për shkak të ligjit, i gëzonte transferuesi në lidhje me pronën e transferuar.

10. Të ardhurat e krijuara nga shitja do të përdoren për shpronësim, trajtim të posaçëm apo kompensime, me qëllim realizimin e punëve publike. Me urdhrin të ministrit përgjegjës për administrimin e pronës shtetërore, një pjesë e të ardhurave nga shitja kalojnë në llogarinë speciale të shpronësimeve pranë Bankës së Shqipërisë.

11. Vendimi i KKT-së për konfiskimin e sipërfaqes të ndërtuar pa leje ose në tejkalim të lejes së ndërtimit, përcillet nga Drejtoria e Administrimit të Pronës Shtetërore për regjistrim pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës. Certifikata e përdorimit, si për pjesën e objektit konform lejes, ashtu edhe për pjesën e konfiskuar me vendim të KKT-së, do të lëshohet në zbatim të legjislacionit për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit.

12. Institucionet e interesuara për të përdorur objektet e konfiskuara sipas pikës 2, të VKM-së (për qëllime strehimi social apo për interes publik), do të shprehin interesin e tyre pranë ministrisë përgjegjëse për administrimin e pronës shtetërore, për t'i përdorur për nevojat e tyre. Ky institucion kur e gjen në raport të drejtë me interesin publik, kryen transferimin e tyre me vendim të Këshillit të Ministrave.

13. Brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, ministria përgjegjëse për administrimin e pronës shtetërore, krijon dhe administron një regjistër të veçantë për regjistrimin dhe inventarizimin e objekteve të konfiskuara me çdo të dhënë të tyre.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE DHE
EKONOMISË
Delina Ibrahimaj

**VENDIM****Nr. 57, datë 21.12.2022****PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
“PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË
DHE MBIKËQYRJEN E
INSTITUCIONEVE TË PARASË
ELEKTRONIKE”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 1, pika 4, shkronja “b”, nenit 12, shkronja “a” dhe nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të ligjit nr. 55/2020, datë 30.4.2020, “Për shërbimet e pagesave”; dhe nenit 126 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren “Për ushtrimin e veprimtarisë dhe mbikëqyrjen e institucioneve të parasë elektronike”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen subjektet e rregullores për zbatimin e këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes në Bankën e Shqipërisë me ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

4. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

5. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet rregullorja nr. 11, datë 6.2.2008, “Për instrumentet e pagesave elektronike”.

Ky vendim hyn në fuqi, më 1 mars 2023.

**KRYETAR
Gent Sejko**

RREGULLORE

**PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË DHE
MBIKËQYRJEN E INSTITUCIONEVE TË
PARASË ELEKTRONIKE**

**KREU I
TË PËRGJITHSHME**

Neni 1**Objekti**

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave për ushtrimin e veprimtarisë së institucioneve të parasë elektronike, për administrimin e rreziqeve që lidhen me këtë veprimtari dhe për mbikëqyrjen e tyre, si dhe i rregullave dhe kërkesave për emetimin e parasë elektronike nga emetuesit e parasë elektronike.

Neni 2**Subjektet**

Subjekte të kësaj rregulloreje, janë:

a) institucionet e parasë elektronike, siç përcaktohen në pikën 46, të nenit 4, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”;

b) bankat dhe degët e bankave të huaja, në cilësinë e emetuesve të parasë elektronike, për sa parashikohet në kërkesat VI dhe VII të kësaj rregulloreje.

Neni 3**Baza juridike**

Kjo rregullore nxirret në bazë dhe për zbatim të nenit 1, pika 4, shkronja “b”, nenit 12, shkronja “a”, dhe nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të ligjit nr. 55/2020, datë 30.4.2020, “Për shërbimet e pagesave” (i cili në këtë rregullore do të quhet ligji “Për shërbimet e pagesave”); dhe nenit 126 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (i cili në këtë rregullore do të quhet ligji “Për bankat”).



Neni 4 Përkufizime

1. Termat e përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me termat e përkufizuar në ligjin “Për shërbimet e pagesave” dhe në ligjin “Për bankat”.

2. Përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, për qëllime të zbatimit të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

a) “tepricë mesatare e parasë elektronike” – është mesatarja e shumës totale të detyrimeve financiare të lidhura me paranë elektronike të emetuar, në fund të çdo dite kalendarike përgjatë gjashtëmujorit paraardhës, të përlogaritur në ditën e parë kalendarike të çdo muaji kalendarik pasardhës të gjashtëmujorit dhe që aplikohet për këtë muaj kalendarik;

b) “emetues i parasë elektronike” – janë kategoritë e mëposhtme:

i. bankat dhe degët e bankave të huaja, të licencuara nga Banka e Shqipërisë për emetimin e parasë elektronike,

ii. institucionet e parasë elektronike, siç përcaktohen në pikën 46 të nenit 4 të ligjit “Për bankat”;

c) “mbajtës i parasë elektronike” – është personi (individi, personi fizik ose personi juridik), i cili, në bazë të kontratës përkatëse me emetuesin e parasë elektronike, mban paranë elektronike;

d) “sistemi i kontrollit të brendshëm” - përfshin procesin e monitorimit dhe të vlerësimit të vazhdueshëm të mjaftueshmërisë dhe efektivitetit të akteve të brendshme e mekanizmave të kontrollit brenda një institucioni si dhe të cilësisë së operacioneve të veprimtarisë së tij, të kryera nga strukturat përgjegjëse, për realizimin e funksioneve të sistemit të kontrollit të brendshëm.

3. Kërkesat e kësaj rregulloreje dhe të akteve të tjera ligjore e nënligjore për institucionet e parasë elektronike, nuk do të zbatohen për:

a) vlerat monetare që ruhen në instrumente të përjashtuara, siç përcaktohen në shkronjën “gj”, të nenit 4, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”;

b) vlerat monetare që përdoren për të kryer transaksione të pagesave të përjashtuara, siç përcaktohen në shkronjën “h”, të nenit 4, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”.

KREU II KËRKESA TË PËRGJITHSHME PËR ADMINISTRIMIN E RREZIKUT DHE MBIKËQYRJEN GJATË USHTRIMIT TË VEPRIMTARISË SË INSTITUCIONEVE TË PARASË ELEKTRONIKE

Neni 5 Kërkesa të përgjithshme prudenciale

1. Përveç sa parashikohet në këtë rregullore dhe në akte të tjera nënligjore të Bankës së Shqipërisë për institucionet e parasë elektronike, kërkesat e parashikuara në nenet 8 dhe 22–26 të ligjit “Për shërbimet e pagesave” zbatohen në të njëjtën mënyrë edhe për institucionet e parasë elektronike.

2. Institucionet e parasë elektronike duhet të kenë procedura administrimi, kontabiliteti dhe sisteme të mjaftueshme të kontrollit të brendshëm, mbi baza individuale e të konsoliduara, në përputhje me këtë rregullore.

3. Institucionet e parasë elektronike nuk pranojnë depozita monetare ose fonde të tjera të ripagueshme nga publiku, sipas kuptimit të nenit 4, të ligjit “Për bankat”.

4. Fondet e pranuar/marra nga institucionet e parasë elektronike prej mbajtësit të parasë elektronike, kthehen pa vonesë në para elektronike. Këto fonde nuk konsiderohen depozita monetare ose fonde të tjera të ripagueshme nga publiku, sipas kuptimit të nenit 4, të ligjit “Për bankat”.

5. Dispozitat e pikave 2, 3 dhe 5, të nenit 19 të ligjit “Për shërbimet e pagesave” do të zbatohen edhe për fondet e marra për shërbimet e pagesave të parashikuara në aneksin 1 të atij ligji, që nuk lidhen me emetimin e parasë elektronike.

6. Institucionet e parasë elektronike njoftojnë Bankën e Shqipërisë, para se të ndodhin ndryshime të rëndësishme në masat e marra prej tyre, për mbrojtjen e fondeve të pranuar në këmbim të emetimit të parasë elektronike.

Neni 6 Veprimtaritë

1. Në përputhje me sa parashikohet në nenin 19, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”, institucionet e parasë elektronike, përveç emetimit të parasë elektronike, mund të kryejnë një ose disa nga veprimtaritë e mëposhtme:



a) shërbimet e pagesave të listuara në aneksin 1, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”, që nuk janë të lidhura me emetimin e parasë elektronike;

b) dhënien e kredive lidhur me shërbimet e pagesave, të parashikuara në pikat 4 ose 5, të aneksit 1, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”, nëse plotësohen kushtet e parashikuara në pikat 4 dhe 6, të nenit 19, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”;

c) shërbime operacionale dhe ndihmëse, në funksion të emetimit të parasë elektronike ose të ofrimit të shërbimeve të pagesave të parashikuara në shkronjën “a” të kësaj pike;

d) operimin e sistemeve të pagesave, sipas nenit 20, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”, dhe pa cenuar pjesëmarrjen në sisteme të tjera, sipas nenit 29 të ligjit “Për shërbimet e pagesave”;

e) veprimtari tregtare të ndryshme nga ato të emetimit të parasë elektronike, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

KREU III

PARIMET DHE RREGULLAT BAZË TË DREJTIMIT TË PËRGJEGJSHËM DHE EFEKTIV DHE SISTEMIT TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM

Neni 7

Kërkesa të përgjithshme

Institucionet e parasë elektronike krijojnë rregulla, procedura dhe sisteme të kontrollit të brendshëm lidhur me drejtimin e përgjegjshëm dhe efektiv, të cilët duhet të jenë gjithëpërfshirës e proporcionale me natyrën, shkallën dhe kompleksitetin e aktivitetit dhe shërbimeve të ofruara nga institucioni i parasë elektronike.

Neni 8

Organet drejtuese dhe kultura e përgjithshme e drejtimit

1. Organet drejtuese të institucionit të parasë elektronike, në zbatimin e detyrave dhe përgjegjësi që lidhen me drejtimin dhe kontrollin e institucionit të parasë elektronike, njohin në mënyrë të plotë dhe të qartë profilin e rrezikut të këtij institucioni, duke përcaktuar e miratuar paraprakisht ndërmarrjen dhe tolerancën ndaj rrezikut, si dhe ndjekjen në vazhdimësi të tij në përputhshmëri me këto të

fundit, duke siguruar që nivelet e kapitalit të mbulojnë mjaftueshëm këtë rrezik.

2. Organet drejtuese të institucionit të parasë elektronike, nëpërmjet mënyrës së drejtimit, nxitin (stimulojnë) një kulturë të përshtatshme drejtimi, të bazuar në standarde të larta profesionale dhe vlera të larta etike.

3. Organet drejtuese të institucionit të parasë elektronike marrin masa për arritjen e standardeve të larta etike dhe profesionale në drejtimin e institucionit të parasë elektronike.

Neni 9

Sistemi i administrimit të rrezikut

1. Institucionet e parasë elektronike krijojnë dhe zhvillojnë sistemin e administrimit të rrezikut, lidhur me veprimtaritë/shërbimet për të cilat janë licencuar, në përputhje me natyrën, vëllimin dhe kompleksitetin e veprimtarisë/shërbimeve të tyre. Rreziqet që lidhen me veprimtarinë e emetimit të parasë elektronike ose të shërbimeve të pagesave, mund të përfshijnë, por nuk kufizohen në:

a) rrezikun e shlyerjes (rreziku që shlyerja e një transaksioni pagese të mos kryhet sipas parashikimeve);

b) rrezikun operacional (rreziku që subjekti të pësojë humbje financiare si rezultat i papërshtatshmërisë ose dështimit të proceseve të brendshme dhe të sistemeve, gabimeve njerëzore, ose i ngjarjeve të jashtme);

c) rrezikun e kundërpartisë (rreziku që pala tjetër e përfshirë në transaksion të mos përmbushë detyrimet);

d) rrezikun e likuiditetit (rreziku që institucioni i parasë elektronike të ketë flukse të pamjaftueshme monetare për të përmbushur detyrimet financiare);

e) rrezikun e tregut (rreziku që shkaktohet nga luhatjet në çmimet e tregut);

f) rrezikun e pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit (rreziku që institucioni i parasë elektronike ose shërbimet që ofron, të përdoren për qëllime që lidhen me pastrimin e parave ose financimin e terrorizmit);

g) rrezikun e kursit të këmbimit (rreziku që shkaktohet nga luhatjet në kursin e këmbimit).

2. Sistemi i administrimit të rrezikut është tërësia e politikave, procedurave, rregullave dhe strukturave të institucioneve të parasë elektronike, që shërbejnë për administrimin e rrezikut.



3. Sistemi i administrimit të rrezikut përfshin:

a) procesin e identifikimit, të matjes, të monitorimit, të kontrollit dhe të raportimit, të të gjitha rreziqeve brenda institucionit të parasë elektronike, në të gjithë aktivitetin e tij (për të gjithë bilancin, linjat e biznesit, agjentët etj.);

b) përcaktimin e funksioneve të strukturave të administrimit të rrezikut, të cilat sigurojnë:

i. identifikimin e të gjitha rreziqeve,

ii. vlerësimin e rreziqeve dhe matjen e ekspozimit ndaj tyre,

iii. monitorimin e ekspozimit të rrezikut dhe përcaktimin e nevojave për kapital në mënyrë të vazhdueshme,

iv. monitorimin dhe vlerësimin e vendimeve për pranimin e rreziqeve të caktuara, masat për zbutjen e rrezikut dhe nëse vendimet janë në përputhje me vendimet e organeve drejtuese për politikat e rrezikut,

v. raportimin, në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të pavarur, në organet drejtuese të të gjitha çështjeve të përcaktuara më lart.

Neni 10

Funksioni/njësia e kontrollit të brendshëm

1. Institucionet e parasë elektronike krijojnë funksionin/njësine e kontrollit të brendshëm, si pjesë të sistemit të kontrollit të brendshëm.

2. Funksioni/njësia e kontrollit të brendshëm është njësi organizative e veçantë e subjektit, e pavarur nga veprimtaritë, strukturat dhe personat që ajo shqyrton ose kontrollon, e cila raporton përpara këshillit të administrimit/mbikëqyrës dhe/ose komitetit të kontrollit të subjektit.

3. Funksioni/njësia e kontrollit të brendshëm siguron, në mënyrë të pavarur, organet drejtuese mbi cilësinë dhe efektivitetin e kontrollit të brendshëm të subjektit, si dhe mbi sistemin dhe proceset e drejtimit/qeverisjes dhe të administrimit të rreziqeve.

4. Funksioni/njësia e kontrollit të brendshëm zbaton standardet ndërkombëtare të kontrollit të brendshëm.

5. Institucionet e parasë elektronike hartojnë dhe miratojnë akte të brendshme për funksionimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së këtij funksioni/kësaj njësie, të cilat hartohen dhe rishikohen sa herë gjykohet e nevojshme.

6. Aktet e brendshme që përcaktojnë mënyrën e

funksionimit dhe të ushtrimit të veprimtarisë së funksionit/njesisë së kontrollit të brendshëm, përmbajnë minimalisht elementet e mëposhtme:

a) qëllimin dhe fushën e veprimit të funksionit/njesisë së kontrollit të brendshëm;

b) rolin, autoritetin dhe përgjegjësitë e funksionit/njesisë së kontrollit të brendshëm;

c) marrëdhëniet e funksionit/njesisë së kontrollit të brendshëm me funksione të tjera të sistemit të kontrollit brenda subjektit;

d) mënyrat dhe linjat e komunikimit të rezultateve të veprimtarisë së kontrollit;

e) procedurat për koordinimin me audituesin ligjor ose shoqërinë e auditimit, si dhe me autoritetin mbikëqyrës;

f) të drejtën për të përdorur në mënyrë të plotë dhe të pakushtëzuar çdo regjistrim, dosje, bazë të dhënash, aktive fizike të institucionit të parasë elektronike, si edhe çdo dokumentacion të organeve drejtuese apo njësive organizative, të nevojshme për kryerjen e funksioneve;

g) të drejtën e drejtuesit të funksionit/njesisë së kontrollit të brendshëm për të pasur kontakt të drejtpërdrejtë me organet drejtuese;

h) të drejtën e planifikimit dhe përcaktimit të kontroleve në mënyrë të pavarur;

i) sigurimin e shmangies së çdo konflikti interesash në kryerjen e detyrave të kontrollit të brendshëm;

j) kërkesa për përputhshmërinë me standardet më të mira të kontrollit të brendshëm.

7. Frekuenca e kontrollit bazohet në vlerësimin e çdo fushe veprimtarie dhe shërbimi, si dhe njësie organizative të institucionit të parasë elektronike, të bazuar në rrezik. Të gjitha fushat e veprimtarisë dhe shërbimeve dhe njësitë organizative të institucionit të parasë elektronike janë objekt kontrolli nga funksioni/njësia e kontrollit të brendshëm, të paktën çdo tre vjet, përfshirë edhe ato fusha veprimtarie dhe shërbimi dhe njësi organizative me rrezik të ulët, si dhe degët, agjentët dhe palët e treta të kontraktuara.

8. Funksioni/njësia e kontrollit të brendshëm përgatit një raport për çdo kontroll të kryer, i cili përmban të paktën:

a) objektin e kontrollit;

b) përshkrimin e punës së kontrollit (përshkrimin e metodologjisë, hapat dhe procedurat e ndjekura për të arritur objektivat e kontrollit etj.);



c) gjetjet e kontrollit;

d) komentet e drejtuesve përgjegjës të njësive organizative të kontrolluar, për gjetjet e kontrollit;

e) vlerësime për kualifikimin e personelit, mjaftueshmërinë e akteve të brendshme dhe sistemet e vlerësimit të rrezikut, sipas rasteve përkatëse;

f) rekomandime për korrigjimin dhe përmirësimet e gjetjeve, të vërejtura gjatë aktit të kontrollit; si dhe

g) nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga kontrollet e mëparshme.

9. Punonjësit e funksionit/njësive së kontrollit të brendshëm kanë:

a) reputacion të lartë etik dhe profesional;

b) aftësi profesionale në zbatimin e standardeve ndërkombëtare të kontrollit të brendshëm, të procedurave dhe teknikave të kontrollit në të gjitha fushat e aktivitetit të institucionit të parasë elektronike;

c) njohje dhe/ose përvojë në zbatimin e standardeve të kontabilitetit;

d) njohje të parimeve të administrimit të rrezikut.

10. Në fund të çdo viti, funksioni/njësia e kontrollit të brendshëm përgatit planin e punës për vitin e ardhshëm, i cili paraqitet për miratim në organet drejtuese të institucionit të parasë elektronike.

11. Funksioni/njësia e kontrollit të brendshëm paraqet një raport vjetor mbi punën e tij/saj tek organet drejtuese të institucionit të parasë elektronike, i cili përmban elementet e mëposhtme:

a) një raport mbi nivelin e zbatimit të planit vjetor të punës së funksionit/njësive së kontrollit të brendshëm;

b) një listë të të gjitha aktiviteteve të planifikuara dhe të realizuara nga funksioni/njësia e kontrollit të brendshëm;

c) një listë të të gjitha aktiviteteve të realizuara, por të paplanifikuara në planin vjetor të punës së funksionit/njësive së kontrollit të brendshëm;

d) një listë të të gjitha aktiviteteve të planifikuara, por të parealizuara nga funksioni/njësia e kontrollit të brendshëm, shoqëruar me arsyet e mosrealizimit;

e) një përmbledhje të gjetjeve më të rëndësishme të identifikuar gjatë kontrolleve;

f) një vlerësim të përgjithshëm të mjaftueshmërisë dhe eficiencës së sistemit të kontrollit të

brendshëm, në fushat e mbuluara nga funksioni/njësia e kontrollit të brendshëm;

g) një vlerësim të përgjithshëm të mjaftueshmërisë dhe eficiencës së sistemit të administrimit të rrezikut;

h) një raport mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve dhe masave korrektuese të përcaktuara në bazë të rekomandimeve, si dhe arsyet e moszbatimit të tyre.

Neni 11

Funksioni i përputhshmërisë

1. Institucionet e parasë elektronike duhet të kenë një drejtues ekzekutiv që kryen funksionin e identifikimit, koordinimit dhe të administrimit të rrezikut të përputhshmërisë.

2. Struktura/njësia e përputhshmërisë është e pavarur nga linjat e biznesit dhe nga njësitë e brendshme që kontrollojnë dhe ka autoritetin, reputacionin dhe burimet e mjaftueshme.

3. Përgjegjësia kryesore e strukturës/njësive që përmbush funksionin e përputhshmërisë së subjektit është të asistojë organet drejtuese të institucionit të parasë elektronike, në administrimin efektiv të rrezikut të përputhshmërisë.

4. Struktura/njësia e përputhshmërisë këshillon organet drejtuese të institucionit të parasë elektronike, lidhur me përputhshmërinë me ligjet, rregullat dhe standardet, duke i informuar ato në vazhdimësi mbi zhvillimet në këtë fushë, si dhe në veçanti kryen detyrat e mëposhtme:

a) edukimin dhe trajnimin e personelit për çështjet e përputhshmërisë, duke shërbyer edhe si pikë kontakti brenda subjektit për çështje apo pyetje të personelit lidhur me përputhshmërinë;

b) hartimin e udhëzimeve të brendshme për zbatimin e ligjeve, të rregulloreve dhe të standardeve, nëpërmjet politikave dhe procedurave apo dokumenteve të tjera, si manualët e përputhshmërisë, kodet e brendshme të etikës dhe udhëzimet praktike;

c) identifikimin, dokumentimin dhe vlerësimin e rreziqeve të përputhshmërisë në veprimtarinë e institucionit të parasë elektronike, duke përfshirë produktet dhe praktikën e reja, tipet e linjave të reja të propozuara të veprimtarisë ose të marrëdhënieve me klientët dhe ndryshimet e rëndësishme në këto marrëdhënie;



d) vlerësimin e ndikimit të mundshëm të çdo ndryshimi ligjor dhe rregullativ në veprimtarinë e institucionit të parasë elektronike dhe në kuadrin e përputhshmërisë;

e) matjen e rrezikut të përputhshmërisë duke përdorur treguesit e performancës (të tillë si rritja e numrit të ankesave të klientëve, parregullsitë në pagesa etj.), me qëllim vlerësimin e këtij rreziku;

f) vlerësimin e përshtatshmërisë së procedurave dhe rregulloreve të përputhshmërisë, si dhe vlerësimin e mangësive të identifikuar, duke mundësuar edhe propozime për amendime;

g) monitorimin, testimin dhe raportimin e rezultateve nga testimi i mjaftueshmërisë së përputhshmërisë, sipas procedurave të sistemit të brendshëm të administrimit të rrezikut, duke evidentuar edhe ndryshimet në profilin e rrezikut të përputhshmërisë, mbështetur në treguesit e performancës, shkeljeve dhe/ose mangësive të identifikuar dhe të masave korrigjuese të ndërmarra;

h) krijimin e një kulture inkurajuese dhe të përshtatshme për sinjalizimin nga ana e punonjësve të institucionit të parasë elektronike, të mospërputhshmërisë me rregullat, procedurat, operacionet etj. duke siguruar njëkohësisht konfidencialitetin dhe mbrojtjen e këtyre të fundit (punonjësve).

5. Struktura/njësia e përputhshmërisë mund të kryejë dhe detyra të tjera të veçanta, në kuadër të përmbushjes së detyrimeve ligjore të subjektit (të tilla si ato të parandalimit të pastrimit të parave etj.), si dhe mban lidhje me Bankën e Shqipërisë dhe/ose autoritete të tjera të mbikëqyrjes së veprimtarisë financiare, audituesin ligjor ose shoqërinë e auditimit etj.

6. Struktura/njësia e përputhshmërisë kryen detyrat e përcaktuara në këtë rregullore dhe në aktet rregullative të institucionit të parasë elektronike, mbështetur në një program pune që përcakton aktivitetet e planifikuara, të tilla si zbatimi dhe rishikimi i politikave, procedurave të veçanta të rrezikut të përputhshmërisë, vlerësimet, testet e përputhshmërisë dhe edukimin e trajnimit e personelit për çështje të përputhshmërisë.

7. Programi i strukturës/njesisë së përputhshmërisë duhet të jetë i bazuar te rreziku dhe duhet të rishikohet në mënyrë të vazhdueshme, me qëllim që të sigurohet që ky program mbulon të gjitha linjat e biznesit/

veprimtarisë së subjektit dhe siguron koordinimin midis funksioneve të administrimit të rrezikut.

KREU IV KËRKESAT PËR KAPITAL, MBROJTJA E FONDEVE DHE ADMINISTRIMI I RREZIQEVE

NËNKREU I MJAFTUESHMËRIA E KAPITALIT

Neni 12

Kërkesa të përgjithshme për kapitalin e institucionit të parasë elektronike

1. Institucioni i parasë elektronike siguron nivele të mjaftueshme të kapitalit, për ushtrimin e veprimtarisë të sigurt dhe të qëndrueshme, si dhe për përmbushjen e detyrimeve të tij gjatë ushtrimit të kësaj veprimtarie.

2. Kapitali rregullator i institucionit të parasë elektronike, në çdo kohë, nuk mund të bjerë nën shumën e kapitalit fillestar minimal të përcaktuar sipas kërkesave të parashikuara në rregulloren “Për licencimin e institucioneve të pagesave dhe institucioneve të parasë elektronike, si dhe për regjistrimin e ofruesve të shërbimeve të pagesave”, ose nën shumën e kërkesës për kapital rregullator të llogaritur në përputhje me nenin 14 të kësaj rregulloreje, cilado të jetë më e lartë.

3. Në rast se kapitali rregullator i institucionit të parasë elektronike bie nën kufijtë e përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, institucioni raporton menjëherë në Bankën e Shqipërisë, e cila përcakton masat e nevojshme dhe kohën për të rivendosur kapitalin brenda kufijve të mësipërm.

4. Në rastin kur institucioni i parasë elektronike jep kredi në lidhje me shërbimet e pagesave, shuma e përgjithshme e kredisë së dhënë, nuk cenon në asnjë rast kapitalin rregullator dhe përmbushjen e kërkesave mbikëqyrëse të Bankës së Shqipërisë.

5. Banka e Shqipërisë, bazuar në vlerësimin e proceseve të administrimit të rrezikut, të të dhënave mbi rrezikun e humbjeve dhe të mekanizmave të kontrollit të brendshëm të institucionit të parasë elektronike, mund të kërkojë në çdo rast nivele shtesë kapitali, deri në 20% (njëzet për qind) më të larta se kërkesa për kapital rregullator e llogaritur sipas përcaktimeve në nenin 14 të kësaj rregulloreje.



Neni 13

Elementet përbërëse të kapitalit rregullator të institucionit të parasë elektronike

1. Institucionet e parasë elektronike llogaritin kapitalin rregullator të tyre si shumë të kapitalit të nivelit të parë dhe kapitalit të nivelit të dytë. Kapitali i nivelit të parë është shuma e kapitalit bazë të nivelit të parë dhe kapitalit shtesë të nivelit të parë.

2. Institucionet e parasë elektronike përfshijnë në llogaritjen e kapitalit rregullator:

a) zërat e kapitalit bazë të nivelit të parë të parashikuar në nenin 6 të rregullores “Për kapitalin rregullator të bankës”, pas aplikimit të filtrave prudencialë të parashikuar në nënkreun II, të kreut II, të asaj rregulloreje, si dhe zbritjeve dhe përjashtimeve kufi të parashikuar në nenin 11, pika 1, shkronjat “a” deri në “i” dhe në nenin 20 të së njëjtës rregullore. Për zbritjet e parashikuara dhe përjashtimet kufi të parashikuara në nenet 11 dhe 20 rregullores “Për kapitalin rregullator të bankës”, institucionet e parasë elektronike zbatojnë kërkesat e parashikuara në nenet 12–13 dhe 15–20 të asaj rregulloreje;

b) zërat e kapitalit shtesë të nivelit të parë të parashikuar në nenin 21 të rregullores “Për kapitalin rregullator të bankës”, pas aplikimit të zbritjeve të parashikuara në nenin 25 të së njëjtës rregulloreje. Për zërat e kapitalit shtesë të nivelit të parë dhe zbritjet nga kapitali shtesë i nivelit të parë, institucionet e parasë elektronike zbatojnë kërkesat e parashikuara në nenet 22–24 dhe 26–29 të rregullores “Për kapitalin rregullator të bankës”;

c) zërat e kapitalit të nivelit të dytë të parashikuar në nenin 30 të rregullores “Për kapitalin rregullator të bankës”, pas aplikimit të zbritjeve të parashikuara në nenin 33, të së njëjtës rregulloreje. Për zërat e kapitalit të nivelit të dytë dhe zbritjet nga kapitali i nivelit të dytë, institucionet e parasë elektronike zbatojnë kërkesat e parashikuara në nenet 31–32 dhe 34–37 të rregullores “Për kapitalin rregullator të bankës”.

3. Institucionet e parasë elektronike, për qëllime të llogaritjes së kapitalit rregullator, sigurojnë respektimin e kufijve të mëposhtëm:

a) të paktën 75% (shtatëdhjetë e pesë për qind) e kapitalit të nivelit të parë është në formën e kapitalit bazë të nivelit të parë; dhe

b) kapitali i nivelit të dytë përbën jo më shumë

se 33.3% (tridhjetë e tre presje tre për qind) të kapitalit të nivelit të parë.

4. Institucionet e parasë elektronike nuk përfshijnë në llogaritjen e kapitalit rregullator, zërat që janë pjesë e kapitalit rregullator të një subjekti tjetër, i cili është pjesë e të njëjtut grup financiar/bankar ku bën pjesë institucioni i parasë elektronike.

5. Institucioni i parasë elektronike që ushtron edhe veprimtari të tjera tregtare, të ndryshme nga emetimi i parasë elektronike, siç parashikohet në nenin 6, pika 1, shkronja “e”, të kësaj rregulloreje, nuk përfshin ato zëra kapitali që përdoren për veprimtaritë e tjera në llogaritjen e kapitalit rregullator.

NËNKREU II LLOGARITJA E KËRKESËS PËR KAPITAL RREGULLATOR

Neni 14

Metoda e llogaritjes së kërkesës për kapital rregullator të institucionit të parasë elektronike

1. Institucioni i parasë elektronike llogarit kërkesën për kapital rregullator, të detyrueshëm për t’u mbajtur në çdo kohë prej tij, sipas rregullave të parashikuara në këtë nen.

2. Nëse institucioni i parasë elektronike ushtron vetëm veprimtarinë e emetimit të parasë elektronike, kërkesa për kapital rregullator do të jetë në çdo kohë të paktën sa 2% (dy për qind) e tepicës mesatare të parasë elektronike.

3. Në rastin kur institucioni i parasë elektronike që ushtron vetëm veprimtarinë e emetimit të parasë elektronike, në datën e llogaritjes së kërkesës për kapital, nuk ka mbushur gjashtë muaj në ushtrimin e aktivitetit të tij, e llogarit kërkesën për kapital mbi bazën e parashikimit të tepicës së parasë elektronike, siç parashikohet në planin e biznesit, të paraqitur në procesin e aplikimit për marrjen e licencës, duke reflektuar edhe rishikimet e propozuara nga Banka e Shqipërisë në planin e biznesit (nëse është e aplikueshme).

4. Nëse institucioni i parasë elektronike ofron edhe shërbime të pagesave që nuk lidhen me emetimin e parasë elektronike, kërkesa për kapital rregullator, referuar veprimtarisë së shërbimeve të pagesave, llogaritet sipas rregullave të mëposhtme:



a) kërkesa për kapital rregullator e institucionit të parasë elektronike duhet të jetë të paktën sa shuma e elementeve të mëposhtme, e shumëzuar me faktorin e përshkallëzuar (*scaling factor*) k të përcaktuar në shkronjën “b” të kësaj pike:

i. 4,0% (katër për qind) e pjesës së VP deri në vlerën ekuivalente në lekë të shumës 5 milionë euro, *plus*

ii. 2,5% (dy presje pesë për qind) e pjesës së VP mbi vlerën ekuivalente në lekë të shumës 5 milionë euro deri në 10 milionë euro, *plus*

iii. 1% (një për qind) të pjesës së VP mbi vlerën ekuivalente në lekë të shumës 10 milionë euro deri në 100 milionë euro, *plus*

iv. 0,5% (zero presje pesë për qind) të pjesës së VP mbi vlerën ekuivalente në lekë të shumës 100 milionë euro deri në 250 milionë euro, *plus*

v. 0,25% (zero presje njëzet e pesë për qind) të pjesës së VP mbi vlerën ekuivalente në lekë të shumës 250 milionë euro,

ku, **VP** është vëllimi i pagesave, i cili përfaqëson 1/12 e shumës totale të transaksioneve të pagesave të ekzekutuara nga institucioni i parasë elektronike në vitin e mëparshëm;

b) faktori i përshkallëzuar k i parashikuar në shkronjën “a” të kësaj pike është:

i. **0,5** kur institucioni i parasë elektronike ofron vetëm shërbimin e pagesave të parashikuar në pikën 6 të aneksit 1 të ligjit “Për shërbimet e pagesave”,

ii. **1** kur institucioni i parasë elektronike ofron shërbimet e pagesave të parashikuara në pikat 1-5 të aneksit 1 të ligjit “Për shërbimet e pagesave”.

5. Përrjashtohen nga kërkesat për kapitalin rregullator të parashikuar në pikën 4 të këtij neni, institucionet e parasë elektronike që përveç emetimit të parasë elektronike ofrojnë vetëm shërbimet e pagesave sipas pikës 7 ose 8, ose të dyja njëkohësisht, sipas aneksit 1 të ligjit “Për shërbimet e pagesave”.

6. Në rastin kur institucioni i parasë elektronike që ushtron edhe shërbime të pagesave (përveç emetimit të parasë elektronike), në datën e llogaritjes së kërkesës për kapital rregullator nuk ka mbushur një vit të plotë në ushtrimin e aktivitetit të tij, vëllimi i pagesave i parashikuar në pikën 4 të këtij neni, do të llogaritet bazuar në të dhënat e parashikuara në planin e biznesit të paraqitur në procesin e aplikimit për marrjen e licencës, duke reflektuar edhe rishikimet e propozuara nga Banka

e Shqipërisë në planin e biznesit (nëse është e aplikueshme).

7. Në rastin kur institucioni i parasë elektronike ushtron edhe shërbime të pagesave (përveç emetimit të parasë elektronike) ose një apo disa nga veprimtaritë e parashikuara në shkronjat “b” deri në “e” të pikës 1 të nenit 6 të kësaj rregulloreje dhe teprica e parasë elektronike nuk njihet paraprakisht, institucioni i parasë elektronike mund të llogaritet kërkesën për kapital mbi bazën e një pjese përfaqësuese që supozohet se do të përdoret për emetimin e parasë elektronike, me kusht që kjo pjesë përfaqësuese të mund të vlerësohet, në mënyrë të arsyeshme, bazuar në të dhënat historike të pranuar nga Banka e Shqipërisë.

8. Institucionet e parasë elektronike që japin kredi në përputhje me kërkesat e nenit 19, pikat 4 dhe 6 të ligjit “Për shërbimet e pagesave”, llogarisin një kërkesë për kapital për rrezikun e kredisë, të paktën sa 6% (gjashhtë për qind) e tepricës së kredive të disbursuara, duke përjashtuar transaksionet e pagesave të kryera me karta krediti.

9. Institucionet e parasë elektronike mbajnë në çdo kohë një nivel kapitali të paktën sa shuma e kërkesës për kapital për emetimin e parasë elektronike, të kërkesës për kapital për shërbimet e pagesave (aty ku është e zbatueshme), si dhe të kërkesës për kapital për rrezikun e kredisë (aty ku është e zbatueshme).

NËNKREU III

MBROJTJA E FONDEVE

Neni 15

Mbrojtja e fondeve të klientëve të institucioneve të parasë elektronike

1. Institucioni i parasë elektronike mbron të gjitha fondet e pranuar në këmbim të emetimit të parasë elektronike në vlerën e tepricës së parasë elektronike, në përputhje me kërkesat e nenit 12, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”, dhe në njërin nga format e mëposhtme:

a) fondet e mbajtësve të parasë elektronike nuk duhet të bashkohen në asnjë rast me fondet e vetë institucionit të parasë elektronike apo të ndonjë personi fizik apo juridik, të ndryshëm nga mbajtësit e parasë elektronike në emër të të cilëve janë mbajtur fondet dhe ato do të vendosen (depozitohen) në një llogari të veçantë në bankë,



ose do të investohen në aktive të sigurta, me rrezik të ulët e likuide, siç përcaktohet në pikën 5 të këtij neni;

b) fondet e mbajtësve të parasë elektronike do të mbulohen nëpërmjet një police sigurimi ose ndonjë garancie tjetër të njëjtë me të nga një shoqëri sigurimi ose nga një bankë, e cila nuk i përket të njëjtit grup bankar/financiar të institucionit të parasë elektronike, për një shumë të barasvlershme me atë që do të ishte veçuar në mungesë të policës së sigurimit ose të garancisë tjetër.

Për qëllime të kësaj pike, vlera e tepricës së parasë elektronike llogaritet në fund të çdo dite pune.

2. Fondet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, të marra në formën e pagesës me instrument page (jo pagesë në *cash*) nuk është e nevojshme të mbrohen (sigurohen), derisa ato të kreditohen në llogarinë e pagesave të institucionit të parasë elektronike ose derisa të vihen në dispozicion të institucionit të parasë elektronike, në përputhje me kërkesat për kohën e ekzekutimit të përcaktuara në ligjin “Për shërbimet e pagesave”, aty ku është e aplikueshme. Në çdo rast, këto fonde do të mbrohen (sigurohen), jo më vonë se 5 (pesë) ditë pune pas emetimit të parasë elektronike.

3. Institucioni i parasë elektronike që ofron edhe shërbime të pagesave që nuk lidhen me emetimin e parasë elektronike, mbron (siguron) në mënyrë të veçantë nga fondet e pranuar në këmbim të emetimit të parasë elektronike, edhe fondet e përdoruesve të shërbimeve të pagesave, siç parashikohet në nenin 12 të ligjit “Për shërbimet e pagesave” dhe në pikën 1 të këtij neni. Në rastin e përdorimit të policës së sigurimit ose garancisë, institucioni i parasë elektronike duhet të sigurohet që ato mbulojnë të dy grupet e fondeve.

4. Polica e sigurimit ose garancia duhet të jetë e pagueshme, në rast se institucioni i parasë elektronike nuk është në gjendje të përmbushë detyrimet e tij financiare ndaj mbajtësve të parasë elektronike dhe përdoruesve të shërbimeve të pagesave, sipas shkaqeve/ngjarjeve (*triggers*) që aktivizojnë zbatimin e tyre dhe të cilat janë të përcaktuara përkatësisht, në kontratën e sigurimit ose në kontratën e garancisë. Polica e sigurimit ose garancia nuk ka ndonjë klauzolë mbi franshizën, pjesën e zbritshme (*deductible*) ose shumën minimale (*threshold*) që mund të cenojë disbursimin e

pagesave të përfituesit ose ndonjë ofrues tjetër i shërbimeve të pagesave.

5. Për qëllime të zbatimit të shkronjës “a” të pikës 1 të këtij neni, “aktive të sigurta, me rrezik të ulët e likuide” të një institucioni të parasë elektronike, do të konsiderohen:

a) titujt e borxhit të emetuar ose të garantuar nga qeveria shqiptare, qeveritë qendrore dhe bankat qendrore, nga organizatat ndërkombëtare, nga bankat shumëpalëshe të zhvillimit, ose nga qeveritë rajonale ose autoritetet lokale, të cilëve u caktohet shkalla e cilësisë së kredisë “1”, ose që ponderohen me peshën e rrezikut 0% (zero për qind), në përputhje me rregulloren “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”;

b) titujt e borxhit të emetuar ose të garantuar nga qeveria shqiptare, qeveritë qendrore dhe bankat qendrore, nga organizatat ndërkombëtare, nga bankat shumëpalëshe të zhvillimit, ose nga qeveritë rajonale ose autoritetet lokale, të cilëve u caktohet shkalla e cilësisë së kredisë “2” ose “3”, në përputhje me rregulloren “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”;

c) titujt e borxhit të emetuar nga institucionet e mbikëqyrura, të cilave u caktohet shkalla e cilësisë së kredisë “1” ose “2”, ose titujt e borxhit të emetuar nga institucionet e mbikëqyrura, të cilëve u caktohet shkalla e cilësisë së kredisë “3”, por që trajtohen sipas kërkesave të nenit 17/2, pika 3, të rregullores “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”;

d) titujt e borxhit të emetuar nga shoqëritë tregtare, të cilëve u caktohet shkalla e cilësisë së kredisë “1” ose “2”, në përputhje me rregulloren “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”;

e) kuotat në sipërmarrjet e investimeve kolektive në tituj të transferueshëm (SIKIT), të cilat investojnë vetëm në aktivet e përmendura në shkronjat “a” deri në “d” të kësaj pike.

Neni 16

Diversifikimi i mbrojtjes së fondeve

1. Institucionet e parasë elektronike që i mbrojnë fondet e pranuar në këmbim të emetimit të parasë elektronike, në format e parashikuara në shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 15 të kësaj rregulloreje, ose fondet e përdoruesve të shërbimeve të pagesave, siç parashikohet në shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 12 të ligjit “Për



shërbimet e pagesave”, investojnë fondet e klientëve në mënyrë të diversifikuar, në kundërparti të ndryshme.

2. Institucioni i parasë elektronike, në vendimarrjen e tij për format e mbrojtjes së fondeve sipas parashikimeve në nenin 15 të kësaj rregulloreje, mund të marrë në konsideratë edhe elementet e mëposhtme:

a) nivelin e kapitalit të bankës dhe/ose shoqërisë së sigurimit, i cili duhet të jetë në proporcion me shumën e fondeve që do të vendoset në llogari ose që do të garantohej apo sigurohet;

b) nivelin e ekspozimit ndaj rrezikut që shoqëron aktivitetin e kredidhënies apo investimeve të bankës dhe/ose shoqërisë së sigurimeve.

3. Institucioni i parasë elektronike dokumenton vendimarrjen e tij sipas parashikimeve në pikën 2 të këtij neni.

NËNKREU IV EKSPOZIMET NDAJ RREZIKUT DHE KUFIZIMET

Neni 17

Normat e lejueshme për pozicionet e hapura valutore

1. Pozicioni i hapur valutore në një valutë të caktuar, përfaqëson shumën ekuivalente në lekë të diferencës midis të drejtave dhe detyrimeve gjithsej të institucionit të parasë elektronike, në këtë valutë.

2. Institucionet e parasë elektronike nuk duhet të tejkalojnë në fund të çdo dite pune, normat e mëposhtme për pozicionet e hapura në valutë:

a) raporti i pozicionit të hapur valutore për një monedhë me kapitalin rregullator, nuk duhet të jetë më shumë se 30% (tridhjetë për qind); dhe

b) raporti i pozicionit të hapur valutore për të gjitha monedhat me kapitalin rregullator, nuk duhet të jetë më shumë se 40% (dyzetë për qind).

3. Institucionet e parasë elektronike, në llogaritjen e pozicionit të hapur valutore, nuk përfshijnë pozicionin strukturor në valutë, i cili është pozicioni që krijohet nga:

a) elemente (zëra të bilancit ose jashtë bilancit), të cilat nuk janë të natyrës së veprimtarisë (biznesit) kryesore financiare të subjektit dhe/ose janë elemente të qëndrueshme/afatgjata të tillë si: “interesa pjesëmarrës”, “investimet në filiale”,

“aktivet e qëndrueshme të patrupëzuara dhe të trupëzuara” etj.;

b) transaksione të institucionit të parasë elektronike, të cilët ruajnë nivelin e kërkesave për kapital rregullator, në rastet kur kjo kërkesë ndikohet nga luhatjet e kursit të këmbimit.

Neni 18

Rreziku i likuiditetit

1. Rreziku i likuiditetit është mundësia e humbjes financiare si rezultat i mungesës së aktiveve likuide të mjaftueshme për të përmbushur detyrimet kur ato maturohen dhe kërkohen dhe/ose kur institucioni i parasë elektronike nuk ka mundësi të financojë rritjen e aktiveve të veta.

2. Institucionet e parasë elektronike krijojnë sistemin e administrimit të rrezikut të likuiditetit, i cili ka për qëllim administrimin e rrezikut të likuiditetit. Ky sistem përfshin minimalisht strategjinë dhe politikat për administrimin e rrezikut të likuiditetit, strukturën organizative të krijuar për administrimin e rrezikut të likuiditetit, sistemin e kontrollit të brendshëm, sistemin e administrimit të informacionit etj.

3. Institucionet e parasë elektronike sigurojnë që sistemi i administrimit të rrezikut të likuiditetit, në mënyrë sasiore dhe cilësore, të jetë në përputhje me madhësinë e subjektit, tipologjinë e veprimtarisë së tij dhe nivelin e ekspozimit ndaj rrezikut të likuiditetit.

Neni 19

Dhënia e kredive në lidhje me shërbimet e pagesave

1. Institucionet e parasë elektronike mund të japin kredi në lidhje me shërbimet e pagesave, të parashikuara në pikat 4 ose 5 të aneksit 1 të ligjit “Për shërbimet e pagesave”, siç parashikohet në nenin 19 të atij ligji, nëse plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) institucionet e parasë elektronike hartojnë dhe miratojnë rregullore të brendshme, me qëllim administrimin e rrezikut të kredisë, duke parashikuar kërkesa mbi çdo hap të këtij procesi, që përfshijnë analizën paraprake financiare, disbursimin, monitorimin, rishikimin e linjave të kredisë etj.;

b) kredia lehtëson dhe jepet ekskluzivisht me



qëllim ekzekutimin e transaksionit të pagesës. Për të siguruar pajtueshmërinë me këtë kusht, institucionet e parasë elektronike miratojnë sisteme dhe procedura për të monitoruar financimin dhe sigurojnë mekanizmat e kontrollit të brendshëm;

c) institucionet e parasë elektronike nuk japin kredi nga fondet e pranuar në këmbim të parasë elektronike të emetuar, të cilat i mbrojnë në përputhje me nenin 15 të kësaj rregulloreje;

d) kredia do të jepet nga fondet e vetë institucionit të parasë elektronike dhe jo nga fondet e marra ose të mbajtura nga përdoruesit e shërbimeve të pagesave, me qëllim ekzekutimin e një transaksioni pagese;

e) kredia është afatshkurtër dhe duhet të shlyhet brenda një periudhe jo më të gjatë se 12 (dymbëdhjetë) muaj. Përfshirë nga ky rregull mund të bëjë afati i kredisë së dhënë në lidhje me pagesat e bëra me kartë krediti, i cili mund të jetë më shumë se 12 muaj;

f) institucionet e parasë elektronike respektojnë kërkesën për kapital rregullator të përcaktuar në nenin 14 të kësaj rregulloreje, që përfshin edhe kërkesat për kapital për rrezikun e kredisë që rrjedh nga këto kredi.

KREU V KONTABILITETI, AUDITIMI DHE KËRKESAT RAPORTUESE PËR INSTITUCIONET E PARASË ELEKTRONIKE

Neni 20

Kontabiliteti dhe raportet financiare

1. Institucionet e parasë elektronike mbajnë llogaritë kontabël dhe përgatisin raportet financiare për pasqyrimin e gjendjes së tyre financiare, në mënyrë të saktë dhe në përputhje me rregullat e parimet kontabël, mbi baza individuale e të konsoliduara, sipas legjislacionit në fuqi për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.

2. Kur institucioni i parasë elektronike kryen edhe veprimtari të tjera sipas nenit 6 të kësaj rregulloreje, përveç emetimit të parasë elektronike dhe ofrimit të shërbimeve të pagesave (në rastet kur është e zbatueshme), për qëllime të mbikëqyrjes, institucioni mban informacion kontabël të veçantë për këto veprimtari, që duhet të jetë pjesë e raportit të audituesit ligjor.

Neni 21

Auditimi ligjor

1. Llogaritë vjetore dhe llogaritë e konsoliduara të institucioneve të parasë elektronike auditohen nga auditues ligjorë ose shoqëri auditimi, sipas legjislacionit në fuqi për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare dhe të atij për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar.

2. Detyrimet e përcaktuara në ligjin për bankat dhe në aktin nënligjor përkatës të Bankës së Shqipërisë për ekspertin kontabël të autorizuar të bankave, zbatohen në të njëjtën mënyrë edhe për audituesit ligjorë ose shoqëritë e auditimit të institucioneve të parasë elektronike lidhur me veprimtarinë e emetimit të parasë elektronike dhe ofrimit të shërbimeve të pagesave (në rastet kur është e zbatueshme).

Neni 22

Raportimi në Bankën e Shqipërisë

1. Institucionet e parasë elektronike raportojnë në Bankën e Shqipërisë sipas kërkesave të përcaktuara në aktet nënligjore për sistemin raportues të unifikuar të këtyre subjekteve.

2. Institucionet e parasë elektronike dërgojnë në Bankën e Shqipërisë, brenda 6-mujorit të parë të vitit pasardhës, një kopje të raportit vjetor dhe të opinionit të ekspertit kontabël të autorizuar, ku pasqyrohet gjendja financiare dhe kontabël, mbi baza individuale dhe të konsoliduara.

3. Institucionet e parasë elektronike raportojnë menjëherë në Bankën e Shqipërisë, për çdo rast të tejkalimit të normave mbikëqyrëse të lejueshme, sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje. Banka e Shqipërisë përcakton dhe njofton institucionin e parasë elektronike për kohën dhe masat e nevojshme, me qëllim rivendosjen e treguesve brenda kufijve të lejueshëm.

KREU VI EMETIMI I PARASË ELEKTRONIKE DHE RIPAGIMI I FONDEVE

Neni 23

Ndalimi i emetimit të parasë elektronike

Asnjë person fizik apo juridik që nuk është emetues i parasë elektronike, nuk mund të emetojë para elektronike.



Neni 24

Emetimi i parasë elektronike dhe ripagimi i fondeve

1. Emetuesi i parasë elektronike emeton para elektronike për një vlerë të barabartë me vlerën nominale (*at par value*) të fondeve të marra nga mbajtësi i parasë elektronike.

2. Emetuesi i parasë elektronike, me kërkesë të mbajtësit të parasë elektronike, i ripaguan atij, në çdo moment dhe në vlerë nominale (*at par value*), vlerën monetare të parasë elektronike të mbajtur prej tij.

3. Emetuesi i parasë elektronike dhe mbajtësi i parasë elektronike lidhin një kontratë me shkrim, në format letër ose nëpërmjet një mjeti tjetër të qëndrueshëm komunikimi, me qëllim krijimin dhe rregullimin e marrëdhënies për emetimin e parasë elektronike.

4. Kontrata midis emetuesit të parasë elektronike dhe mbajtësit të parasë elektronike përcakton qartë dhe në formë të kuptueshme kushtet në lidhje me emetimin dhe ripagimin e fondeve, përfshirë edhe ndonjë komision të zbatueshëm. Emetuesi i parasë elektronike informon mbajtësin e parasë elektronike, mbi kushtet e kontratës, para nënshkrimit të saj (kontratës).

5. Ripagimi i fondeve mund të jetë subjekt i aplikimit të komisioneve, vetëm nëse këto të fundit parashikohen në kontratën midis palëve dhe vetëm në një nga rastet e mëposhtme:

a) kur ripagimi kërkohej përpara zgjidhjes së kontratës;

b) kur kontrata parashikon një datë për zgjidhjen e saj dhe mbajtësi i parasë elektronike e zgjidh kontratën, para kësaj date (datës së zgjidhjes); ose

c) kur ripagimi për shumën e papërdorur kërkohej pas më shumë se një viti nga data e zgjidhjes së kontratës.

6. Komisionet e parashikuara në pikën 5 të këtij neni, duhet të jenë proporcionale dhe të mbështetura në kostot reale të emetuesit të parasë elektronike.

7. Në rastet kur mbajtësi i parasë elektronike kërkon ripagimin e fondeve, përpara zgjidhjes së kontratës, ai ka të drejtën të kërkojë ripagim të plotë ose të pjesshëm të parasë elektronike që zotëron.

8. Në rastet kur ripagimi i fondeve kërkohej nga mbajtësi i parasë elektronike, një vit ose deri në një vit pas datës së zgjidhjes së kontratës:

a) emetuesi i parasë elektronike ripaguan totalin e vlerës monetare të parasë elektronike të mbajtur; ose

b) nëse institucioni i parasë elektronike kryen edhe veprimtari të tjera tregtare të ndryshme nga emetimi i parasë elektronike, siç parashikohet në nenin 6, pika 1, shkronja “e”, të kësaj rregulloreje dhe nuk dihet paraprakisht se çfarë përqindje e fondeve do të përdoret si para elektronike, do të ripaguhet të gjitha fondet e kërkuara nga mbajtësi i parasë elektronike.

9. Pavarësisht nga sa parashikohet në pikat 5-8 të këtij neni, e drejta e ripagimit të fondeve të një personi që nuk është konsumator, që pranon para elektronike, do të jetë subjekt i marrëveshjes kontraktuale midis emetuesit të parasë elektronike dhe këtij personi.

Neni 25

Ndalimi i pagimit të interesit

Emetuesi i parasë elektronike ndalohet t'i paguajë interes ose ndonjë përfitim tjetër mbajtësit të parasë elektronike, për periudhën gjatë së cilës ky i fundit mban paranë elektronike.

Neni 26

Zgjidhja alternative e mosmarrëveshjeve

Kërkesat e parashikuara në kreun VI, të titullit IV, të ligjit “Për shërbimet e pagesave” zbatohen në të njëjtën mënyrë edhe për emetuesit e parasë elektronike, në lidhje me detyrimet e parashikuara në nenet 24 dhe 25, të kësaj rregulloreje.

KREU VII

MBIKËQYRJA, SHKELJET DHE SANKSIONET

Neni 27

Masat ndëshkimore dhe mbikëqyrëse

Banka e Shqipërisë, në rast mosplotësimi të kërkesave të kësaj rregulloreje, zbaton masat mbikëqyrëse dhe/ose ndëshkimore të parashikuara në ligjin “Për bankat” dhe në kreun I, të titullit V, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”.

KRYETAR I KËSHILLIT MBIKËQYRËS
Gent Sejko



VENDIM
Nr. 58, datë 21.12.2022

PËR MIRATIMIN E DISA
NDRYSHIMEVE NË RREGULLOREN
“PËR ADMINISTRIMIN E RREZIKUT NË
VEPRIMTARINË E SUBJEKTEVE
FINANCIARE JOBANKA”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 1, pika 4, shkronja “b”, dhe nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; dhe nenit 126 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Në rregulloren “Për administrimin e rrezikut në veprimtarinë e subjekteve financiare jobanka”, miratuar me vendimin nr. 2, datë 17.1.2013, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, e ndryshuar, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) në nenin 3, togfjalëshi “*subjektet financiare jobanka, institucionet financiare të mikrokredisë dhe institucionet e parasë elektronike*” zëvendësohet me togfjalëshin “*subjektet financiare jobanka dhe institucionet financiare të mikrokredisë*”;

b) në nenin 4 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

i. në pikën 2, përmbajtja e shkronjës “a”, ndryshon si më poshtë:

“a) **“kapital rregullator”** – është kapitali që përdoret për matjen e treguesve rregullatorë dhe llogaritet si shuma algjebrike e elementeve të mëposhtme të bilancit:

i. kapital i paguar,

ii. primet e aksioneve,

iii. rezervat,

iv. diferenca rivlerësimi,

v. fitimet e pashpërndara,

vi. fitim-humbja e vitit ushtrimor,

vii. (minus) pjesëmarrjet në kapitalin e subjekteve të tjera,

viii. borxhi i varur.”

ii. në pikën 2, shkronja “d” shfuqizohet,

iii. në pikën 2, shkronja “f”, paragrafi i dytë ndryshon me përmbajtjen e mëposhtme:

“Subjektet përfshijnë borxhin e varur në kapitalin rregullator, deri në 50% të shumës së elementeve të kapitalit

deri më 31.12.2023 dhe, duke filluar nga 1.1.2024, deri në 33.3% të shumës së elementeve të kapitalit, vetëm nëse plotësohen kërkesat e përcaktuara në shkronjën “f” të pikës 2 të këtij neni. Për qëllime të kësaj llogaritjeje, konsiderohet shuma e elementeve të kapitalit të parashikuara në nënpikat “i” deri në “viii” të shkronjës “a” të pikës 2 të këtij neni.”

iv. në pikën 2, shkronja “f”, paragrafi i tretë, togfjalëshi “*Subjekti që kërkon të përfshijë borxhin e varur në kapitalin e tij*,” zëvendësohet me togfjalëshin “*Subjekti që kërkon të përfshijë borxhin e varur në kapitalin e tij rregullator*,” dhe në nënpikën “ii” të paragrafit të tretë të shkronjës “f” të pikës 2, togfjalëshi “*të karakteristikave të borxhit të varur të përcaktuara në shkronjën “f” të këtij neni*” zëvendësohet me togfjalëshin “*të kërkesave dhe karakteristikave të borxhit të varur të përcaktuara në shkronjën “f” të pikës 2 të këtij neni*”;

c) në nenin 7 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

i. në pikat 2, 3 dhe 5, kudo ku parashikohet togfjalëshi “*kapitalit të subjektit*” zëvendësohet me togfjalëshin “*kapitalit rregullator të subjektit*”;

ii. në pikat 3 dhe 5, togfjalëshi “*veprimtarinë e faktoringut, të qirasë financiare, dhe institucioneve të parasë elektronike*” zëvendësohet me togfjalëshin “*veprimtarinë e faktoringut dhe të qirasë financiare*”;

iii. në pikën 4, pas shkronjës “b” shtohet shkronja “c” me përmbajtjen e mëposhtme:

“c) pjesëmarrjet në kapitalin e subjekteve të tjera, të cilat janë zbritur nga kapitali rregullator i subjektit.”;

d) në nenin 10 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

i. në pikën 2, shkronjat “a” dhe “b”, togfjalëshi “*me kapitalin*,” zëvendësohet me togfjalëshin “*me kapitalin rregullator*,”

ii. në pikën 2, shkronja “b”, togfjalëshi “*nuk duhet të jetë më shumë se 40% (dyzetë për qind) e kapitalit*” zëvendësohet me togfjalëshin “*nuk duhet të jetë më shumë se 40% (dyzetë për qind)*”;

e) kudo në nenin 11, pika 2, togfjalëshi “*raporti i kapitalit*” zëvendësohet me togfjalëshin “*raporti i kapitalit rregullator*”;

f) në nenin 12, shkronjat “d” dhe “e”, togfjalëshi “*të kapitalit të subjektit*” zëvendësohet me togfjalëshin “*të kapitalit rregullator të subjektit*”;

g) në nenin 21, pikat 1 dhe 2, togfjalëshi “*kapitalit të subjektit*” zëvendësohet me togfjalëshin “*kapitalit rregullator të subjektit*”;

h) në nenin 22, pas pikës 2 shtohet pika 3 me përmbajtjen e mëposhtme:

“3. Subjektet financiare jobanka të licencuara për ushtrimin e qirasë financiare, zbatojnë kërkesat e



parashikuara në nenet 16 dhe 17 të kësaj rregulloreje, për ekspozimet e ristrukturuara dhe ekspozimet që do të fsihjen nga bilanci.”;

i) në nenin 25, pas pikës 2 shtohet pika 3 me përmbajtjen e mëposhtme:

“3. Subjektet zbatojnë kërkesat e parashikuara në nenet 16 dhe 17, të kësaj rregulloreje, për ekspozimet e ristrukturuara dhe ekspozimet që do të fsihjen nga bilanci.”;

j) Kreu VI “Administrimi i rrezikut në institucionet e parasë elektronike” që përfshin nenet 27-29, shfuqizohet;

k) në nenin 35, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

i. në pikën 1, shkronja “b”, hiqet togfjalëshi “, përfshirë edhe kërkesat për agentët”,

ii. në pikën 1, shkronja “j”, togfjalëshi “*subjekti financiar jobankë, institucioni financiar i mikrokredisë ose institucioni i parasë elektronike*” zëvendësohet me togfjalëshin “*subjekti financiar jobankë ose institucioni financiar i mikrokredisë*”;

l) në nenin 36, pika 1, shkronja “i”, togfjalëshi “*kur raporti i kapitalit*” zëvendësohet me togfjalëshin “*kur raporti i kapitalit rregullator*”.

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Bankës së Shqipërisë për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi, më 1 mars 2023.

KRYETAR
Gent Sejko

VENDIM

Nr. 59, datë 21.12.2022

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR KRAHASUESHMËRINË E TARIFAVE TË LIDHURA ME LLOGARITË E PAGESAVE DHE PËR SHËRBIMIN E TRANSFERIMIT TË LLOGARIVE TË PAGESAVE”¹

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja “a” dhe nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të nenit 53, pika 4, nenit 55, pika 1, shkronja “e”, të neneve 124 dhe 126 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; dhe të ligjit nr. 55/2020, datë 30.4.2020, “Për shërbimet e pagesave”; Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes,

VENDOSI:

1. Të miratojë rregullore “Për krahasueshmërinë e tarifave të lidhura me llogaritë e pagesave dhe për shërbimin e transferimit të llogarive të pagesave”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi. Rregullorja hyn në fuqi më datë 1 mars 2023.

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes në Bankën e Shqipërisë për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gent Sejko

¹ Kjo rregullore është përafuar pjesërisht me direktivën 2014/92/BE, të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 23 korrik 2014 “Mbi krahasueshmërinë e tarifave në lidhje me llogaritë e pagesave, transferimin e llogarive të pagesave dhe aksesin në llogarinë e pagesave me shërbime bazike”.

Numri CELEX 32014L0092, Fletore Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 257, datë 28.8.2014, faqe 214-246.

**RREGULLORE****PËR KRAHASUESHMËRINË E TARIFAVE
TË LIDHURA ME LLOGARITË E PAGESAVE
DHE PËR SHËRBIMIN E TRANSFERIMIT TË
LLOGARIVE TË PAGESAVE****KREU I
TË PËRGJITHSHME****Neni 1****Objekti**

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kërkesave mbi transparencën dhe krahasueshmërinë e tarifave që u ngarkohen konsumatorëve në llogaritë e tyre të pagesave, si dhe përcaktimi i kërkesave për transferimin e llogarive të pagesave ndërmjet ofruesve të shërbimeve të pagesave.

Neni 2**Subjektet**

Subjekte të kësaj rregulloreje janë ofruesit e shërbimeve të pagesave, në kuptim të ligjit nr. 55/2020, “Për shërbimet e pagesave”.

Neni 3**Baza ligjore**

Kjo rregullore nxirret në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja “a” dhe nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar (më poshtë ligji “Për Bankën”); të nenit 53, pika 4, nenit 55, pika 1, shkronja “e”, të neneve 124 dhe 126, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (më poshtë ligji “Për bankat”); dhe të ligjit nr. 55/2020, datë 30.4.2020, “Për shërbimet e pagesave” (më poshtë ligji “Për shërbimet e pagesave”).

Neni 4**Përkufizime**

1. Termat e përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me termat e përkufizuar sipas nenit 4, të ligjit “Për bankat” dhe nenit 5 të ligjit “Për shërbimet e pagesave”.

2. Përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, për qëllime të zbatimit të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

a) “llogari pagese” – do të ketë të njëjtin kuptim si në ligjin “Për shërbimet e pagesave”;

b) “mjet i qëndrueshëm komunikimi” - është çdo mjet komunikimi që i mundëson konsumatorit ruajtjen e informacionit adresuar personalisht atij konsumatori, në një mënyrë të tillë që mundëson përdorimin e këtij informacioni si referencë në të ardhmen, për një periudhë kohe të përshtatshme për qëllime të informacionit dhe që lejon riprodhimin e pandryshuar të informacionit të ruajtur;

c) “shërbimet e lidhura me llogarinë e pagesës” – janë të gjitha shërbimet që lidhen me hapjen, funksionimin dhe mbylljen e një llogarie pagese, përfshirë shërbimet e pagesave dhe transaksionet e pagesave, në lidhje me transaksionet e parashikuara në shkronjën “e” të nenit 4 të ligjit “Për shërbimet e pagesave” dhe kreditë e lidhura me shërbimet e pagesave sipas parashikimeve në nenin 19, pika 4, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”;

d) “ofruesi marrës i shërbimit të pagesës” – është ofruesi i shërbimit të pagesave, tek i cili transferohet informacioni i kërkuar për të kryer transferimin e llogarisë së pagesave;

e) “ofruesi transferues i shërbimit të pagesës” – është ofruesi i shërbimit të pagesave, i cili transferon informacionin e kërkuar për të kryer transferimin e llogarisë së pagesave;

f) “kredi lidhur me shërbimet e pagesave” nënkupton shumën maksimale të fondeve që tejkalon balancën pozitive në llogarinë e pagesës së konsumatorit dhe të cilën ofruesi i shërbimit të pagesave vë në dispozicion të konsumatorit në formën e një kredie kufi, bazuar në një kontratë me shumë të përcaktuar dhe afat maksimal 12 muaj;

g) “shërbimi i transferimit” – nënkupton transferimin nga ofruesi transferues i shërbimit të pagesave tek ofruesi marrës i shërbimit të pagesave, të të paktën njërit prej elementeve të mëposhtme, shoqëruar kjo me mbylljen ose jo të llogarisë së pagesës me ofruesin transferues të shërbimit të pagesave:

i. të informacionit mbi disa ose të gjithë urdhrat për transfertat e kreditit, mandatet e debitimit direkt periodik dhe urdhërpagesat periodike për transferta krediti të ekzekutuara në llogarinë e pagesës,



ii. të një pjesë ose të gjithë balancës kreditore të llogarisë së pagesës, nga një llogari pagese në tjetrën;

h) “konsumator” – do të ketë të njëjtin kuptim të përcaktuar në ligjin nr. 9902, datë 17.4.2008, “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, i ndryshuar.

Neni 5

Kërkesa të përgjithshme

1. Banka e Shqipërisë harton dhe publikon në faqen zyrtare të saj, një listë me të paktën 10 dhe jo më shumë se 20 shërbimet më përfaqësuese të lidhura me një llogari pagese, të cilat janë subjekt i një tarife. Lista përmban termat dhe përshkrimin për secilin prej shërbimeve të paraqitura në të. Banka e Shqipërisë njofton subjektet e kësaj rregulloreje për hartimin dhe publikimin e listës së shërbimeve më përfaqësuese të lidhura me një llogari pagese.

2. Banka e Shqipërisë, për hartimin e listës të parashikuar në pikën 1 të këtij neni, merr në konsideratë shërbimet që:

a) përdoren më shpesh nga konsumatorët në lidhje me llogarinë e tyre të pagesës;

b) gjenerojnë koston më të lartë për konsumatorët, si në terma të përgjithshëm, ashtu edhe për njësi.

3. Banka e Shqipërisë, çdo katër vjet, pas publikimit të listës së parashikuar në pikën 1 të këtij neni, vlerëson dhe, kur është e përshtatshme, përditëson listën e shërbimeve më përfaqësuese të krijuara në përputhje me parashikimet e pikave 1 dhe 2 të këtij neni. Banka e Shqipërisë njofton subjektet e kësaj rregulloreje për çdo përditësim të listës së shërbimeve më përfaqësuese të lidhura me një llogari pagese.

4. Ofruesit e shërbimeve të pagesave raportojnë pranë Bankës së Shqipërisë raporte tremujore mbi tarifat e aplikuar për shërbimet e përfshira në listën e parashikuar në pikën 1 të këtij neni. Këto raporte duhet të raportohen jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas përfundimit të tremujorit, në përputhje me formatin e standardizuar të hartuar nga Departamenti i Mbikëqyrjes.

5. Ofruesit e shërbimeve të pagesave në rast të ndonjë ndryshimi të tarifave ose hedhjes në treg të produkteve të reja, përpara afatit të raportimit të përcaktuar në pikën 4 të këtij neni, pas marrjes së vendimit raportojnë menjëherë në Bankën e Shqipërisë, tarifat e reja të zbatueshme.

6. Banka e Shqipërisë publikon në mënyrë të përmbledhur dhe krahasimore, tarifat e aplikuar nga ofruesit e shërbimeve të pagesave për shërbimet e përfshira në listën e parashikuar në pikën 1 të këtij neni.

7. Kërkesat e përcaktuara në rregulloren nr. 59, datë 29.8.2008, “Për transparencën për produktet dhe shërbimet bankare dhe financiare”, të ndryshuar, mbi raportimin dhe publikimin e normave të interesit për kreditë dhe depozitat dhe komisionet për produktet dhe shërbimet bankare dhe financiare, mbeten në fuqi pavarësisht nga kërkesat e përcaktuara të paraqitura në këtë rregullore për raportimin dhe publikimin e tarifave për llogaritë e pagesave.

KREU II

KRAHASUESHMËRIA E TARIFAVE TË LIDHURA ME LLOGARITË E PAGESËS

Neni 6

Informacioni mbi tarifat edhe termat e standardizuar për konsumatorët

1. Ofruesit e shërbimeve të pagesave i vendosin në dispozicion konsumatorit, në një kohë të përshtatshme dhe të mjaftueshme përpara lidhjes së kontratës për një llogari pagese, në format letër ose me mjete të tjera të qëndrueshme komunikimi, një dokument që përmban informacion mbi tarifat, i cili përfshin termat e standardizuar në listën e shërbimeve më përfaqësuese të lidhura me një llogari pagese të parashikuar në pikën 1 të nenit 5 të kësaj rregulloreje dhe nëse këto shërbime ofrohen nga ofruesi i shërbimeve të pagesave, edhe tarifat përkatëse për çdo shërbim. Ofruesit e shërbimeve të pagesave duhet të dokumentojnë nënshkrimin e dokumentit nga konsumatori dhe datën e nënshkrimit të tij.

2. Dokumenti që përmban informacion mbi tarifat:

a) është një dokument i shkurtër dhe i veçantë;

b) paraqitet në një mënyrë të qartë dhe të lehtë për t’u lexuar, duke përdorur karaktere të një madhësie të lexueshme;

c) të jetë jo më pak i kuptueshëm në rast se, pasi është përgatitur fillimisht me ngjyra, të shtypet ose fotokopjohet në bardh e zi;

d) të jetë i shkruar të paktën, në gjuhën shqipe dhe, nëse është rënë dakord shprehimisht ndërmjet



konsumatorit dhe ofruesit të shërbimeve të pagesave, edhe në një gjuhë tjetër;

e) të jetë i saktë, joçorientues dhe i shprehur në monedhën e llogarisë së pagesës ose, nëse bihet dakord ndërmjet konsumatorit dhe ofruesit të shërbimeve të pagesave, edhe në një monedhë tjetër;

f) ka titullin “Dokument që përmban informacion mbi tarifat” në krye të faqes së parë;

g) përfshin një pasqyrë që përmban tarifat për shërbimet më përfaqësuese në lidhje me llogarinë e pagesës.

3. Ofruesit e shërbimeve të pagesave vendosin në dispozicion të konsumatorëve, dokumentin që përmban informacion mbi tarifat, të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, sipas formatit të paraqitur në aneksin 1 të kësaj rregulloreje.

4. Në rastet kur ofruesit e shërbimeve të pagesave ofrojnë një ose më shumë shërbime si pjesë të një pakete shërbimesh të lidhura me një llogari pagese, dokumenti që përmban informacion mbi tarifat duhet të paraqesë tarifat për të gjithë paketën, shërbimet e përfshira në paketë dhe sasinë e tyre, si dhe tarifat shtesë për çdo shërbim që tejkalon sasinë e mbuluar nga tarifat e paketës.

5. Në rastet kur një llogari pagese ofrohet si pjesë e një pakete, së bashku me një produkt ose shërbim tjetër i cili nuk është i lidhur me llogarinë e pagesës, ofruesit e shërbimeve të pagesave informojnë konsumatorët nëse është e mundur të përfitojnë llogarinë e pagesës në mënyrë të veçantë dhe, nëse është e mundur, ofrojnë informacion të veçantë në lidhje me tarifat që lidhen me secilin nga produktet dhe shërbimet e tjera të ofruara në atë paketë që mund të përfitohen në mënyrë të veçantë.

6. Ofruesit e shërbimeve të pagesave vënë në dispozicion të konsumatorëve, një fjalor të paktën të kushteve të standardizuara të përcaktuara në listën e shërbimeve më përfaqësuese të lidhura me një llogari pagese, të parashikuara në pikën 1 të nenit 5 të kësaj rregulloreje. Ofruesit e shërbimeve të pagesave sigurojnë që fjalori i dhënë është hartuar në gjuhë të qartë, të kuptueshme dhe joteknike dhe që nuk është çorientuese.

7. Ofruesit e shërbimeve të pagesave vendosin në dispozicion të konsumatorëve, në çdo kohë, dokumentin që përmban informacion mbi tarifat dhe fjalorin. Dokumenti dhe fjalori paraqiten në një formë lehtësisht të përdorshme, përfshirë edhe konsumatorët që nuk janë klientë të ofruesve të

shërbimeve të pagesave, në formë elektronike në faqen e tyre të internetit, aty ku është e zbatueshme, si dhe në mjediset e punës së ofruesve të shërbimeve të pagesave, të aksesueshme për konsumatorët. Dokumenti dhe fjalori gjithashtu paraqiten në format letër ose me mjete të tjera të qëndrueshme komunikimi, pa pagesë, me kërkesën e konsumatorit.

Neni 7

Pasqyra mbi tarifat e aplikuara

1. Ofruesit e shërbimeve të pagesave i paraqesin konsumatorit, të paktën çdo vit dhe pa pagesë, një pasqyrë mbi të gjitha tarifat e aplikuara, si dhe, kur është e zbatueshme, informacion në lidhje me normat e interesit të parashikuara në shkronjat “c” dhe “d” të pikës 3 të këtij neni, për shërbimet e lidhura me një llogari pagese. Kur është e zbatueshme, ofruesit e shërbimeve të pagesave përdorin termat e standardizuar, të përcaktuara në listën e referuar në pikën 1 të nenit 5 të kësaj rregulloreje.

2. Ofruesit e shërbimeve të pagesave informojnë konsumatorët mbi pasqyrën e tarifave, sipas mënyrës së rënë dakord në kontratë. Pasqyra e tarifave paraqitet në format letër, me kërkesën e konsumatorit.

3. Pasqyra mbi tarifat e aplikuara përmban të paktën informacionin e mëposhtëm:

a) tarifën për njësi, të aplikuar për secilin shërbim dhe numrin e rasteve që shërbimi është përdorur gjatë periudhës përkatëse, dhe nëse shërbimet janë të kombinuara në një paketë, tarifat e aplikuara për paketën në tërësi, numrin e rasteve kur tarifa e paketës është aplikuar gjatë periudhës përkatëse dhe tarifat shtesë të aplikuara për çdo shërbim që tejkalon sasinë e mbuluar nga tarifat e paketës;

b) shumën totale të tarifave të aplikuara gjatë periudhës përkatëse për secilin shërbim, secilën paketë të shërbimeve të ofruara dhe shërbimet që tejkalojnë sasinë e mbuluar nga tarifat e paketës;

c) normën e interesit të kredisë kufi të aplikuar për llogarinë e pagesës dhe shumën totale të interesit të aplikuar në lidhje me kredinë kufi gjatë periudhës përkatëse, kur është e zbatueshme;

d) normën e interesit kreditor të aplikuar për llogarinë e pagesës dhe shumën totale të interesit të fituar gjatë periudhës përkatëse, kur është e zbatueshme;



e) shumën totale të tarifave të aplikuara për të gjitha shërbimet e ofruara gjatë periudhës përkatëse.

4. Pasqyra mbi tarifat e aplikuara:

a) paraqitet në një mënyrë të qartë dhe të lehtë për t'u lexuar, duke përdorur karaktere të një madhësie të lexueshme;

b) të jetë e saktë, joorientuese dhe e shprehur në monedhën e llogarisë së pagesës ose, nëse bihet dakord ndërmjet konsumatorit dhe ofruesit të shërbimeve të pagesave, edhe në një monedhë tjetër;

c) ka titullin "Pasqyra mbi tarifat e aplikuara" në krye të faqes së parë; dhe

d) të jetë e shkruar të paktën, në gjuhën shqipe ose, nëse është rënë dakord shprehimisht ndërmjet konsumatorit dhe ofruesit të shërbimeve të pagesave, edhe në një gjuhë tjetër.

5. Ofruesit e shërbimeve të pagesave vendosin në dispozicion të konsumatorëve, pasqyrën e tarifave të përcaktuar në pikat 3 dhe 4, të këtij neni, sipas formatit të paraqitur në aneksin 2 të kësaj rregulloreje.

Neni 8

Informacioni për konsumatorët

1. Ofruesit e shërbimeve të pagesave, në informacionin kontraktor dhe promocional për konsumatorët, kur është e zbatueshme, përdorin termat e standardizuar të përcaktuar në listën e parashikuar në pikën 1, të nenit 5, të kësaj rregulloreje. Ofruesit e shërbimeve të pagesave mund të përdorin emërtime tregtare në dokumentin që përmban informacion mbi tarifat dhe në pasqyrën e tarifave, me kusht që emërtime të tilla të përdoren përveç termave të standardizuar të përcaktuar në listën e parashikuar në pikën 1 të nenit 5 të kësaj rregulloreje, si një përcaktim dytësor i atyre shërbimeve, të paraqitur në kllapa ose në madhësi shkrimi më të vogël.

2. Ofruesit e shërbimeve të pagesave mund të përdorin emërtime tregtare për të përcaktuar shërbimet e tyre në informacionin e tyre kontraktor dhe promocional për konsumatorët, me kusht që ata të identifikojnë qartë, kur është e zbatueshme, termat përkatës të standardizuar të përcaktuar në listën e parashikuar në pikën 1 të nenit 5 të kësaj rregulloreje.

KREU III

TRANSFERIMI I LLOGARIVE TË PAGESËS

Neni 9

Ofrimi i shërbimit të transferimit

1. Ofruesit e shërbimeve të pagesave ofrojnë shërbimin e transferimit midis llogarive të pagesave të mbajtura në të njëjtën monedhë, për të gjithë konsumatorët që hapin ose mbajnë një llogari pagese me një ofrues të shërbimeve të pagesave.

2. Shërbimi i transferimit të llogarive të pagesave nuk ofrohet nëse në llogarinë e pagesës së konsumatorit ka një urdhër bllokimi ose sekuestro nga institucionet që e gëzojnë këtë të drejtë me ligj.

Neni 10

Autorizimi i konsumatorit për transferimin

1. Ofruesi marrës i shërbimit të pagesës kryen shërbimin e transferimit pas marrjes së autorizimit nga konsumatori. Në rastin kur llogaria zotërohet nga dy ose më shumë persona, autorizimi merret nga secili prej tyre.

2. Autorizimi duhet të jetë të paktën, në gjuhën shqipe ose, nëse është rënë dakord shprehimisht ndërmjet konsumatorit dhe ofruesit të shërbimeve të pagesave, edhe në një gjuhë tjetër.

3. Autorizimi lejon që konsumatori:

a) të sigurojë ofruesin transferues të shërbimit të pagesës me pëlqimin specifik për të kryer secilin nga veprimet e parashikuara në nenin 11 të kësaj rregulloreje; dhe

b) të sigurojë ofruesin marrës të shërbimit të pagesës me pëlqimin specifik për të kryer secilin nga veprimet e parashikuara në nenin 13 të kësaj rregulloreje.

4. Autorizimi i lejon konsumatorit të identifikojë në mënyrë specifike transfertat e kreditit në mbërritje, urdhërpagesat periodike për transfertat e kreditit dhe mandatet e debitimit direkt që do të transferohen.

5. Autorizimi gjithashtu i lejon konsumatorit të specifikojë datën nga e cila urdhërpagesat periodike për transfertat e kreditit dhe debitimet direkte do të ekzekutohen nga llogaria e pagesës së hapur ose të mbajtur me ofruesin marrës të shërbimit të pagesës. Kjo datë do të jetë të paktën 6 (gjashtë) ditë pune pas datës në të cilën ofruesi marrës i



shërbimit të pagesës merr dokumentet e transferuara nga ofruesi transferues i shërbimit të pagesës, në përputhje me nenin 12 të kësaj rregulloreje.

6. Autorizimi nga konsumatori duhet të jetë me shkrim, në letër ose nëpërmjet një mjeti të qëndrueshëm komunikimi, dhe një kopje e autorizimit i vihet në dispozicion konsumatorit.

Neni 11

Kërkesat e ofruesit marrës të shërbimit të pagesave ndaj ofruesit transferues të shërbimit të pagesave

Ofruesi marrës i shërbimit të pagesës, brenda dy ditëve të punës nga marrja e autorizimit të parashikuar në nenin 10 të kësaj rregulloreje, i kërkon ofruesit transferues të shërbimit të pagesës të kryejë veprimet e mëposhtme, nëse parashikohet në autorizimin e konsumatorit:

a) të dërgojë tek ofruesi marrës i shërbimit të pagesës dhe, nëse kërkohet specifikisht nga konsumatori, te vetë konsumatori, një listë të urdhërpagesave periodike për transferta krediti dhe informacionin e disponueshëm për mandatet e debitimit direkt që janë transferuar;

b) të dërgojë tek ofruesi marrës i shërbimit të pagesës dhe te konsumatori, informacionin e disponueshëm në lidhje me transfertat e kreditit periodike në mbërritje dhe mandatet e debitimeve direkte të iniciuara nga kreditori dhe të ekzekutuara në llogarinë e pagesës së konsumatorit në 13 muajt e mëparshëm;

c) të ndalojë pranimin e debitimeve direkte dhe transfertave të kreditit në mbërritje, me efekt nga data e specifikuar në autorizim, në rastet kur ofruesi transferues i shërbimit të pagesës nuk siguron një sistem për ridrejtimin e automatizuar të transfertave të kreditit në mbërritje dhe debitimeve direkte në llogarinë e pagesës të mbajtur nga konsumatori me ofruesin marrës të shërbimit të pagesës;

d) të anulojë urdhërpagesat periodike, me efekt nga data e specifikuar në autorizim;

e) të transferojë çdo balancë kreditore të mbetur drejt llogarisë së pagesës të hapur ose të mbajtur me ofruesin marrës të shërbimit të pagesës në datën e specifikuar nga konsumatori; dhe

f) të mbyllë llogarinë e pagesës të mbajtur me ofruesin transferues të shërbimit të pagesës në datën e specifikuar nga konsumatori me paraqitjen

e konsumatorit tek ofruesi transferues i shërbimit të pagesës.

Neni 12

Detyrimet e ofruesit transferues të shërbimit të pagesave

1. Ofruesi transferues i shërbimit të pagesës, pas marrjes së kërkesës nga ofruesi marrës i shërbimit të pagesës, kryen veprimet e mëposhtme, nëse parashikohet në autorizimin e konsumatorit:

a) dërgon tek ofruesi marrës i shërbimit të pagesës informacionin e parashikuar në nenin 11, shkronjat “a” dhe “b”, të kësaj rregulloreje, brenda 5 (pesë) ditëve pune;

b) ndalon pranimin e transfertave të kreditit në mbërritje dhe të debitimeve direkte në llogarinë e pagesës, me efekt nga data e specifikuar në autorizim, në rastet kur ofruesi transferues i shërbimit të pagesës nuk siguron një sistem për ridrejtimin e automatizuar të transfertave të kreditit në mbërritje dhe debitimeve direkte në llogarinë e pagesës të mbajtur ose të hapur nga konsumatori me ofruesin marrës të shërbimit të pagesës. Ofruesi i shërbimit të pagesave informon paguesin ose përfituesin e pagesës për arsyen e mospranimit të transaksionit të pagesës;

c) anulon urdhërpagesat periodike, me efekt nga data e specifikuar në autorizim;

d) transferon çdo balancë (tepricë) kreditore (pozitive) të mbetur nga llogaria e pagesës, në llogarinë e pagesës të hapur ose të mbajtur me ofruesin marrës të shërbimit të pagesës në datën e specifikuar në autorizim;

e) pa cenuar kërkesat e ligjit “Për shërbimet e pagesave” lidhur me zgjidhjen e kontratës, mbyll llogarinë e pagesës në datën e specifikuar në autorizim, nëse konsumatori nuk ka detyrime të papaguara në atë llogari pagese dhe me kusht që veprimet e renditura në shkronjat “a”, “b” dhe “d” të këtij neni janë përmbushur. Ofruesi i shërbimit të pagesave informon menjëherë konsumatorin kur detyrime të tilla të papaguara pengojnë mbylljen e llogarisë së pagesës së konsumatorit.



Neni 13

Detyrime të tjera të ofruesit marrës të shërbimit të pagesave

1. Ofruesi marrës i shërbimit të pagesës, brenda 5 (pesë) ditëve pune nga marrja e informacionit të kërkuar nga ofruesi transferues i shërbimit të pagesës siç referohet në nenin 11 të kësaj rregulloreje dhe në përputhje me autorizimin e konsumatorit, kryen veprimet e mëposhtme, deri në masën që i lejon informacioni i siguruar nga ofruesi transferues i shërbimit të pagesave dhe/ose konsumatori:

a) aktivizon urdhërpagesat periodike për transferta krediti, të kërkuara nga konsumatori dhe i ekzekuton ato me efekt nga data e specifikuar në autorizim;

b) kryen përgatitjet e nevojshme për të pranuar debitimet direkte dhe i pranon ato me efekt nga data e specifikuar në autorizim;

c) kur është e nevojshme, informon konsumatorët për të drejtat e tyre, në përputhje me kërkesat e nenit 15, pika 5, shkronja “a”, të rregullores 50/2021, “Për debitimin direkt”;

d) informon paguesit e specifikuar në autorizim dhe që kryejnë pagesa periodike nëpërmjet transfertave të kreditit në llogarinë e pagesës së konsumatorit mbi detajet e llogarisë së pagesës së konsumatorit pranë ofruesit marrës të shërbimit të pagesës dhe iu dërgon paguesve një kopje të autorizimit të konsumatorit. Nëse ofruesi marrës i shërbimit të pagesës, nuk ka të gjitha informacionet që i duhen për të informuar paguesin, i kërkon konsumatorit ose ofruesit transferues të shërbimit të pagesës, të sigurojë informacionin që mungon;

e) informon përfituesit e pagesës të specifikuar në autorizim dhe që përdorin debitimet direkte për të tërhequr fonde nga llogaria e pagesës së konsumatorit, mbi detajet e llogarisë së pagesës së konsumatorit me ofruesin marrës të shërbimit të pagesës dhe datën nga e cila do të ekzekutohen debitimet direkte nga ajo llogari pagese dhe u siguron përfituesve të pagesës një kopje të autorizimit të konsumatorit. Nëse ofruesi marrës i shërbimit të pagesës, nuk ka të gjitha informacionet që i duhen për të informuar përfituesin e pagesës, i kërkon konsumatorit ose ofruesit transferues të shërbimit të pagesës, të sigurojë informacionin që mungon.

2. Konsumatori mund të zgjedhë të sigurojë personalisht informacionin e parashikuar në pikën 1, shkronjat “d” dhe “e”, të këtij neni, për paguesit ose përfituesit e pagesës në vend që të sigurojë autorizimin përkatës në përputhje me nenin 10 të kësaj rregulloreje, tek ofruesi marrës i shërbimit të pagesës. Në këtë rast, ofruesi marrës i shërbimit të pagesave do t'i sigurojë konsumatorit, brenda afatit kohor të specifikuar në pikën 1 të këtij neni, një njoftim me shkrim, në letër ose nëpërmjet një mjeti të qëndrueshëm komunikimi, mbi detajet e llogarisë së pagesës dhe datën e fillimit të specifikuar në autorizim nga konsumatori.

3. Pa rënë ndesh me parashikimet e nenit 61, pika 2, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”, ofruesi transferues i shërbimit të pagesës nuk bllokoi instrumentet e pagesës para datës së përcaktuar në autorizimin e konsumatorit.

Neni 14

Tarifat e lidhura me shërbimin e transferimit

1. Ofruesi transferues dhe ofruesi marrës i shërbimeve të pagesave, në rastin e shërbimit të transferimit, u mundësojnë konsumatorëve akses falas në informacionin e tyre personal në lidhje me urdhërpagesat periodike për transferta krediti ekzistuese dhe debitimet direkte, të mbajtura nga ofruesit e shërbimit të pagesës.

2. Ofruesi transferues i shërbimit të pagesës siguron informacionin e kërkuar nga ofruesi marrës i shërbimit të pagesës, në përputhje me shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 12 të kësaj rregulloreje, pa ngarkuar me tarifa konsumatorin ose ofruesin marrës të shërbimit të pagesës.

3. Çdo tarifë, nëse aplikohet, që i ngarkohet konsumatorit nga ofruesi transferues i shërbimit të pagesës për mbylljen e llogarisë së pagesës të mbajtur me të, përcaktohet në përputhje me kërkesat e parashikuara në nenin 48, pikat 2 dhe 4 të ligjit “Për shërbimet e pagesave”.

4. Çdo tarifë, nëse aplikohet, që i ngarkohet konsumatorit nga ofruesi transferues i shërbimit të pagesës ose ofruesi marrës i shërbimit të pagesës për shërbimet e ofruara në përputhje me nenin 11 deri në nenin 13 të kësaj rregulloreje, përveç atyre të përmendura në pikat 1, 2 dhe 3 të këtij neni, duhet të jenë të arsyeshme dhe në përputhje me kostot aktuale të mbartura nga ofruesi i shërbimit të pagesave.



Neni 15

Humbja financiare për konsumatorët

1. Çdo humbje financiare, përfshirë tarifat dhe interesat, të pësuar nga konsumatori si rezultat i drejtpërdrejtë i mosrespektimit nga një ofrues i shërbimit të pagesave pjesëmarrës në procesin e transferimit të detyrimeve të përcaktuara në nenet 11 deri në 13 të kësaj rregulloreje, do të rimbursohet pa vonesë nga i njëjti ofrues i shërbimit të pagesave.

2. Përgjegjësia e përmendur në pikën 1 të këtij neni nuk do të zbatohet në rast të rrethanave jonormale dhe të paparashikueshme, që dalin përtej kontrollit të ofruesit të shërbimit të pagesave, që apelon për ekzistencën e këtyre rrethanave, pasojat e të cilave nuk mund të ishin shmangur pavarësisht nga gjithë kujdesi i treguar ose në rastet kur një ofrues i shërbimit të pagesave është i detyruar nga detyrime të tjera ligjore sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

Neni 16

Informacioni në lidhje me shërbimin e transferimit

1. Ofruesit e shërbimeve të pagesave vënë në dispozicion të konsumatorëve informacionin e mëposhtëm në lidhje me procesin e transferimit:

a) rolin e ofruesit transferues të shërbimit të pagesës dhe rolin e ofruesit marrës të shërbimit të pagesës për secilin hap të procesit të transferimit;

b) afatin kohor për përfundimin e hapave përkatës;

c) tarifat, nëse ka, të ngarkuara për procesin e transferimit;

d) çdo informacion që do t'i kërkohej konsumatorit të sigurojë; dhe

e) procedurat alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve.

2. Informacioni i parashikuar në pikën 1 të këtij neni duhet të jetë i disponueshëm falas dhe duhet t'u ofrohet konsumatorëve sipas kërkesës:

a) në letër ose me anë të një mjeti tjetër të qëndrueshëm komunikimi në të gjitha ambientet e ofruesit të shërbimit të pagesave të arritshëm për konsumatorët;

b) të jetë i disponueshëm në formë elektronike në faqen zyrtare të internetit të ofruesit të shërbimit të pagesave, në çdo kohë.

KREU IV

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 17

Ankesat e klientëve

Ofruesit e shërbimeve të pagesave marrin masat e nevojshme për të zbatuar kërkesat e përcaktuara në nenin 93 të ligjit “Për shërbimet e pagesave”, për zgjidhjen e ankesave të konsumatorëve.

Neni 18

Masat mbikëqyrëse dhe ndëshkimore

Banka e Shqipërisë, në rast mosplotësimi të detyrimeve të kësaj rregulloreje, zbaton masat mbikëqyrëse dhe ndëshkimore të parashikuara në ligjin “Për bankat”, në ligjin “Për shërbimet e pagesave” dhe në aktet e tjera nënligjore, në zbatim të tyre.

KRYETAR I KËSHILLIT MBIKËQYRËS

Gent Sejko

ANEKS NR. 1

DOKUMENT QË PËRMBAN INFORMACION MBI TARIFAT

Ofruesi i shërbimeve të pagesave: _____

Emri i konsumatorit: _____

Data: _____

- Ky dokument ju informon për tarifat për përdorimin e shërbimeve kryesore të lidhura me llogarinë e pagesës. Kjo do t'ju ndihmojë të krahasoni këto tarifa me ato të llogarive të tjera.
- Tarifat mund të zbatohen gjithashtu për përdorimin e shërbimeve të lidhura me llogarinë të cilat nuk janë të listuara këtu. Informacioni i plotë është në dispozicion në [specifikoni emrat e dokumenteve përkatëse



parakontraktore dhe kontraktore].

- Një fjalor i termave të përdorur në këtë dokument është në dispozicion falas.

Shërbimi	Tarifa
Shërbime të përgjithshme të llogarisë	
[shërbimi kryesor]	[•]
Përfshin një paketë shërbimesh të përbërë nga: Shërbimet përtej këtyre sasive do të tarifohen veçmas.	
Pagesat (me përjashtim të kartave)	
	[•]
Kartat dhe tërheqjet në para fizike	
	[•]
Kredi kufi dhe shërbimet përkatëse	
	[•]
Shërbime të tjera	
	[•]

Paketa e shërbimeve	Tarifa
	[•] [•]
Shërbimet përtej këtyre sasive do të tarifohen veçmas.	

Informacion mbi shërbimet shitesë Informacion mbi tarifat për shërbimet që tejkalojnë sasinë e shërbimeve të mbuluara nga paketa e shërbimeve (me përjashtim të tarifave të renditura më sipër)	
Shërbime	Tarifa
[emri tregtar (<i>brand name</i>)]	[•]

Treguesi gjithëpërfshirës i kostos	[•]
---	-----

SHËNIME SHPJEGUESE PËR PLOTËSIMIN E “DOKUMENTIT QË PËRMBAN INFORMACION MBI TARIFAT”

Seksioni 1: Kërkesa të përgjithshme

1. Ofruesit e shërbimeve të pagesave përdorin modelin/formatin e “Dokumentit që përmban informacion mbi tarifat” siç përcaktohet në këtë aneks dhe e plotësojnë atë në mënyrën e përcaktuar në seksionet 2 deri në 13 të shënimeve shpjeguese.

2. Ofruesit e shërbimeve të pagesave nuk modifikojnë modelin/formatin e “Dokumentit që përmban informacion mbi tarifat” në plotësimin e tij, përveç sa parashikohet në këtë aneks. Në veçanti, ofruesit e shërbimeve të pagesave ndjekin rendin e informacionit, titujve dhe nëntitujve të përcaktuar në këtë model/format.

Dokumenti që përmban informacion mbi tarifat:

- paraqitet në format portret A4;



b) ka titullin “Dokument që përmban informacion mbi tarifat” në krye të faqes së parë;

c) shkrimi i përdorur të jetë “*Times New Roman*” ose një lloj tjetër i ngjashëm me të, me madhësi shkrimi 11, me përjashtim të titullit “Dokument që përmban informacion mbi tarifat”, për të cilin përdoret madhësi shkrimi 16 të theksuar (*bold*); madhësi shkrimi 14 të theksuar (*bold*) për titujt, dhe madhësi shkrimi 12 të theksuar (*bold*) për nëntitujt, përveçse nëse kërkohet një rritje në madhësinë e shkrimit ose përdorimi i shkrimit “*Braille*” për personat me shikim të dëmtuar sipas ligjit, ose siç bihet dakord ndërmjet konsumatorit dhe ofruesit të shërbimeve të pagesave;

d) paraqitet bardh e zi, me përjashtim të logos së ofruesit të shërbimeve të pagesave që mund të paraqitet me ngjyra, siç përcaktohet në seksionin 2;

e) i ka faqet e tij të numërtuara.

3. Ofruesi i shërbimeve të pagesave siguron një dokument të veçantë që përmban informacion mbi tarifat në lidhje me secilën prej llogarive të pagesave që u ofron konsumatorëve.

4. Në rastet kur një ofrues i shërbimeve të pagesave u ofron konsumatorëve vetëm një llogari pageze që mund të kombinohet me paketa të ndryshme të shërbimeve të përmendura në pikën 4 të nenit 6 të kësaj rregulloreje, ofruesi i shërbimeve të pagesave mund të paraqesë më shumë se një dokument që përmban informacion mbi tarifat në lidhje me atë llogari, me kusht që secili dokument që përmban informacion mbi tarifat të përmbajë të paktën një paketë.

Seksioni 2: Logoja e ofruesit të shërbimeve të pagesave

1. Logoja e ofruesit të shërbimeve të pagesave do të jetë e një madhësie 2.5 cm x 2.5 cm dhe paraqitet majtas në krye të tabelës sipas këtij aneksi.

2. Logoja mund të paraqitet me ngjyra ose bardh e zi. Kur shtypet ose fotokopjohet bardh e zi, logoja duhet të jetë e qartë dhe e lexueshme.

Seksioni 3: Emri i ofruesit të shërbimeve të pagesave

1. Emri i ofruesit të shërbimeve të pagesave që ofron shërbimin e llogarisë përfshihet me shkronja të theksuara (*bold*) dhe majtas.

Seksioni 4: Emri i konsumatorit

1. Emri i konsumatorit përfshihet me shkronja të theksuara (*bold*), të vendosur në të majtë dhe poshtë emrit të ofruesit të shërbimeve të pagesave.

Seksioni 5: Data

1. Data kur ofruesi i shërbimit të pagesës ka përditësuar për herë të fundit dokumentin që përmban informacion mbi tarifat, përfshihet duke përdorur llojin e shkrimit të përcaktuar në shkronjën “d”, pika 2 e seksionit 1, të vendosur në të majtë dhe poshtë emrit të konsumatorit.

Seksioni 6: Deklarata hyrëse

1. Teksti i deklaratës hyrëse i përcaktuar në model/format riparaqitet në dokumentin që përmban informacion mbi tarifat, duke përdorur hapësirën e rreshtit 1.15, 0 *pt* para dhe 10 *pt* pas tekstit.

2. Ofruesit e shërbimeve të pagesave do të zëvendësojnë kllapat katrore me emrat e dokumenteve përkatëse parakontraktore dhe kontraktore.

Seksioni 7: Tabela “Shërbimi dhe Tarifa”

1. Ofruesit e shërbimeve të pagesave rendisin shërbimet që janë të përfshira në listën përfundimtare të shërbimeve më përfaqësuese të lidhura me një llogari pageze të parashikuar në pikën 1 të nenit 5 të kësaj rregulloreje, kur ofruesi i shërbimeve të pagesave ofron shërbime të tilla, dhe tarifat e tyre përkatëse në tabelën mbi shërbimet dhe tarifat si më poshtë:

a) shërbimet të futen në kolonën “Shërbimi”, majtas, me shkronja të theksuara (*bold*);

b) secili shërbim të renditet vetëm një herë dhe të shfaqet nën nëntitujt përkatës të paraqitur në tabelë, siç është ofrimi ose mirëmbajtja e llogarisë, të cilët renditen në nëntitullin “Shërbime të përgjithshme të llogarisë”;

c) tarifat që korrespondojnë me shërbimet të shfaqen në kolonën “Tarifa”, djathtas;

d) kur tarifa ngarkohet bazuar në një frekuencë përdorimi dhe jo mbi bazën e një përdorimi të vetëm, frekuenca të tregohet në kolonën “Tarifa”, majtas, e shoqëruar nga tarifa përkatëse për atë periudhë djathtas; tarifa totale vjetore do të shfaqet në rreshtin poshtë shpeshësisë, me shkronjat e theksuara (*bold*), dhe duke përdorur “Tarifat totale vjetore” me tarifën përkatëse djathtas;

e) hapësira e rreshtit duhet të jetë e vetme (*single*), 0 *pt* para dhe 0 *pt* pas çdo shërbimi dhe tarife.

2. Në rastet kur asnjë nga shërbimet e ofruara nga një ofrues i shërbimeve të pagesave, i cili do të korrespondonte me një nëntitull, nuk përfshihet në listën përfundimtare të shërbimeve më



përfaqësuese të lidhura me një llogari pagese, i gjithë rreshti që lidhet me atë nëntitull fshihet, përfshirë titullin e nëntitullit.

3. Në rastet kur ofruesit e shërbimeve të pagesave nuk ofrojnë një ose më shumë shërbime nga lista përfundimtare e shërbimeve më përfaqësuese të përmendura në pikën 1 të nenit 5, ose kur shërbimi nuk është i disponueshëm në llogari, do të përdoret “shërbimi nuk është i disponueshëm”.

4. Në rastet kur tarifa të veçanta ngarkohen/tarifohen në një ose më shumë nga mënyrat e mëposhtme, ofruesit e shërbimeve të pagesave duhet të sigurojnë, në kolonën “Tarifa” të atij shërbimi edhe në një rresht të veçantë, një përshkrim të secilit rast, kanal komunikimi ose kusht të ngarkimit të tarifës (“llojet e tarifave”):

a) për raste të ndryshme të ngarkimit të tarifave të sigurimit të të njëjtit shërbim, të tilla si një tarifë fillestare dhe tarifat e ekzekutimit pasues për të njëjtin shërbim;

b) për kanale të ndryshme përmes të cilave kërkohet, ofrohet ose sigurohet i njëjti shërbim, të tilla si përmes telefonit, degës së ofruesit ose internetit;

c) në varësi të përmbushjes së një kushti specifik për të njëjtin shërbim, siç është respektimi i një shume minimale ose maksimale të kufirit për transferimet kredituese ose tërheqjet e parave, përshkrimi do të pasqyrohet në të majtë dhe tarifa do të pasqyrohet në të djathtë.

5. Kur tarifat ngarkohen në varësi të kombinimit të disa llojeve të tarifave, të tilla si tarifat që ndryshojnë sipas kanalit dhe më pas ndahen më tej në varësi të përmbushjes së një shume të kufirit, ofruesit e shërbimeve të pagesave, përveç zbatimit të pikës 4, pasqyrojnë në të djathtë përshkrimin e secilit lloj të tarifës shtesë.

Seksioni 8: Paraqitja e paketave të shërbimeve të tarifuara si pjesë e tarifave nën nëntitullin “Shërbime të përgjithshme të llogarisë”

1. Kur një paketë shërbimesh të lidhura me një llogari pagese vendoset si pjesë e tarifave nën nëntitullin “Shërbime të përgjithshme të llogarisë”, të gjitha shërbimet e përfshira në paketë, pavarësisht nëse ato përfshihen në listën përfundimtare të shërbimeve më përfaqësuese të lidhura me një llogari pagese të parashikuar në pikën 1 të nenit 5 të kësaj rregulloreje, do të pasqyrohen në nëntitullin e tabelës “Shërbime të

përgjithshme të llogarisë”, në rreshtin për paketën e shërbimeve.

2. Ofruesit e shërbimeve të pagesave përfshijnë informacion mbi tarifat shtesë për çdo shërbim që tejkalon sasinë e mbuluar nga paketa e shërbimeve siç përcaktohet në seksionin 10.

3. Kur numri i të gjitha shërbimeve të mbuluara nga paketa e shërbimeve nuk është i kufizuar, ofruesit e shërbimeve të pagesave do të fshijnë deklaratën në fund të rreshtit “Shërbimet përtej këtyre sasive do të tarifohen veçmas”.

4. Kur një paketë shërbimesh nuk ofrohet në llogari dhe kur paketa e shërbimeve tarifohet veçmas nga çdo tarifë për shërbimet e përgjithshme të llogarisë, hiqet i gjithë rreshti për paketën e shërbimeve.

Seksioni 9: Paraqitja e paketave të shërbimeve të tarifuara veçmas nga tarifat nën nëntitullin “Shërbime të përgjithshme të llogarisë”

1. Kur ofruesit e shërbimeve të pagesave ofrojnë një paketë shërbimesh të lidhura me një llogari pagese dhe paketa tarifohet veçmas nga çdo tarifë nën nëntitullin “Shërbime të përgjithshme të llogarisë”, siç referohet në tabelën e shërbimeve dhe tarifave, ofruesit e shërbimeve të pagesave përfshijnë informacionin e mëposhtëm në tabelën e paketës së shërbimeve:

a) një listë të të gjitha shërbimeve të përfshira në paketë, pavarësisht nëse ato përfshihen në listën përfundimtare të shërbimeve më përfaqësuese të lidhura me një llogari pagese të parashikuar në pikën 1 të nenit 5;

b) sasinë e secilit shërbim të mbuluar nga tarifa e paketës, e cila mund të jetë një numër ose një tregues se numri i shërbimeve nuk është i kufizuar;

c) tarifa e paketës, në kolonën “Tarifa”, djathtas.

2. Kur paketa është e tarifuar bazuar në një frekuencë përdorimi, frekuenca shfaqet në kolonën “Tarifa”, majtas, me tarifën totale vjetore të shfaqur në rreshtin poshtë frekuencës, me shkronja të theksuara dhe duke përdorur “Tarifa totale vjetore”.

3. Ofruesit e shërbimeve të pagesave përfshijnë informacion mbi tarifën shtesë për çdo shërbim që tejkalon sasinë e mbuluar nga paketa e shërbimeve siç parashikohet në seksionin 10.



4. Kur numri i të gjitha shërbimeve në paketë nuk është i kufizuar, ofruesit e shërbimeve të pagesave heqin deklaratën në fund të tabelës që lexon “Shërbimet përtej këtyre sasive do të tarifohen veçmas”.

5. Kur më shumë se një paketë, sipas parashikimit të pikës 1 të këtij seksioni, përfshihet në dokumentin që përmban informacion mbi tarifat, ofruesit e shërbimeve të pagesave duhet të sigurojnë informacionin sipas këtij seksioni për secilën paketë në një tabelë të veçantë, duke treguar emrin tregtar (*brand name*) të paketës së shërbimeve, nëse aplikohet.

6. Në rastet kur paketa e shërbimeve nuk ofrohet së bashku me llogarinë, ose kur paketa e shërbimeve ngarkohet si pjesë e tarifës për ndonjë shërbim të përgjithshëm të llogarisë, ofruesit e shërbimeve të pagesave fshijnë të gjithë tabelën.

Seksioni 10: Tabela mbi tarifat shtesë për shërbimet që tejkalojnë sasinë e mbuluar nga paketat e shërbimeve të lidhura me një llogari pagese

1. Ofruesit e shërbimeve të pagesave përfshijnë në këtë tabelë informacionin mbi tarifat shtesë për çdo shërbim që tejkalon sasinë e mbuluar nga një paketë e përmendur në seksionet 8 dhe 9, nëse ky informacion nuk përfshihet në tabelën e shërbimeve dhe tarifave, ose kur tarifa përkatëse për shërbimin është e ndryshme nga ajo që tregohet në tabelë.

2. Kur ofruesit e shërbimeve të pagesave ofrojnë më shumë se një paketë dhe tarifat shtesë të përmendura në pikën 1 të këtij seksioni ndryshojnë në varësi të paketës, ofruesit e shërbimeve të pagesave duhet të rendisin tarifat e ndryshme veçmas për secilën paketë dhe të përdorin emrin tregtar (*brand name*) të paketës, nëse aplikohet.

3. Në plotësimin e kësaj table, ofruesit e shërbimeve të pagesave ndjekin të njëjtën paraqitje dhe strukturë siç përcaktohet në këtë aneks, kur është e zbatueshme.

4. Kur dokumenti që përmban informacion mbi tarifat nuk përfshin ndonjë informacion mbi paketat e shërbimeve, ofruesit e shërbimeve të

pagesave do të fshijnë tabelën e përmendur në pikën 1 të këtij seksioni.

Seksioni 11: Treguesi gjithëpërfshirës i kostos

1. Ofruesit e shërbimeve të pagesave shfaqin treguesin gjithëpërfshirës të kostos që përmbledh koston e përgjithshme vjetore të llogarisë së pagesës, në një tabelë të veçantë.

Seksioni 12: Emrat tregtarë (*brand names*)

1. Kur përdoret një emër marke, emri i markës duhet të pasojë direkt pas emrit të shërbimit, duke përdorur llojin e shkrimit të përcaktuar në shkronjën “d”, pika 2 të seksionit 1 dhe në kllapa katrore.

Seksioni 13: Përdorimi i mjeteve elektronike

1. Kur dokumenti që përmban informacion mbi tarifat sigurohet me mjetet elektronike, ofruesit e shërbimeve të pagesave, me kusht që në të njëjtën kohë konsumatorit t’i sigurohet një kopje e dokumentit që përmban informacion mbi tarifat në përputhje me formularin e përcaktuar në këtë aneks dhe të plotësuar siç përcaktohet në seksionet 2 deri 12, mund të modifikojnë formularin vetëm sipas mënyrave të mëposhtme:

a) pa rënë ndesh me shkronjën “d”, pika 2, të seksionit 1, rritet madhësia e shkrimit, me kusht që të ruhet proporcioni i madhësive siç përcaktohet në pikën 2 të seksionit 1;

b) kur përmasat e mjeteve elektronike janë të tilla që përdorimi i disa tabelave dhe kolonave do ta vështirësonte leximin e dokumentit që përmban informacion mbi tarifat, përdoret një kolonë e vetme ose një tabelë e vetme nëse ruhet renditja e informacionit, titujve dhe nëntitujve;

c) të përdoren mjete elektronike, me kusht që titulli i dokumentit që përmban informacion mbi tarifat, deklaratat hyrëse, titujt dhe nëntitujt, të shfaqen në mënyrë të dukshme dhe të ruhet renditja e informacionit.

Përdorimi i mjeteve elektronike të përmendura në shkronjën “c” të pikës 1 nuk duhet të ndikojë apo shpërqendrojë konsumatorin nga informacioni i paraqitur në dokumentin që përmban informacion mbi tarifat.



ANEKS NR. 2
PASQYRA MBI TARIFAT E APLIKUARA

[Ofruesi i shërbimeve të pagesave]

[Detajet e kontaktit të ofruesit të shërbimeve të pagesave]

[Emri i konsumatorit]

[Detajet e kontaktit]

Llogaria	
Numri i identifikimit të llogarisë	
Periudha	Nga – deri
Data	

- Ky dokument ju ofron një përmbledhje të të gjitha tarifave për shërbimet e lidhura me llogarinë tuaj të pagesës gjatë periudhës së treguar më sipër.
- Ai gjithashtu ju informon për çdo interes që mund të keni paguar ose fituar gjatë kësaj kohe.
- Informacioni mbi transaksionet individuale dhe gjendjen e llogarisë mund të gjendet në pasqyrat e gjendjes së llogarisë.

Përmbledhje e tarifave dhe interesave

Tarifat totale të paguara (paketa totale e tarifave të shërbimeve dhe tarifat totale të paguara)	[•]
--	-----

Interesi total i paguar	[•]
-------------------------	-----

Interesi total i fituar	[•]
-------------------------	-----

Treguesi gjithëpërfshirës i kostos	[•]
------------------------------------	-----

Pasqyrë e detajuar e tarifave të paguara në llogari

Shërbimi		Tarifa		
Shërbimi	Numri i herëve që është përdorur shërbimi	Tarifa për njësi	Numri i herëve që u tarifua tarifa	Total
Shërbime të përgjithshme të llogarisë				
[•] Përfshin një paketë shërbimesh të përbërë nga: Shërbimet përtej këtyre sasive janë tarifuar veçmas				[•]
Pagesat (me përjashtim të kartave)				
				[•]
Kartat dhe <i>cash</i> -i				
				[•]
Kredi kufi				
				[•]
Shërbime të tjera				
				[•]
Tarifat totale të paguara				[•]



Detaje të tarifave të përfshira në paketën e shërbimeve

Paketa e shërbimeve	Tarifa	Numri i herëve që u tarifua tarifa
“Shërbimi i paketës” [emri i markës, nëse aplikohet] Përfshin:	[●]	[●]
Shërbimet përtej këtyre sasive janë tarifuar veçmas.		

Detaje të interesit të paguar në llogari

	Norma e interesit	Interesi
		[●]
Interesi total i paguar		[●]

Detaje të interesit të fituar nga llogaria

	Norma e interesit	Interesi
“Emri i llogarisë”		[●]
Interesi total i fituar		[●]

Informacion shtesë

[●]

SHËNIME SHPJEGUESE PËR
PLOTËSIMIN E “PASQYRËS MBI TARIFAT
E APLIKUARA”**Seksioni 1:** Kërkesa të përgjithshme

1. Ofruesit e shërbimeve të pagesave përdorin modelin/formatin e “Pasqyrës mbi tarifatat e aplikuar” siç përcaktohet në këtë aneks dhe e plotësojnë atë në mënyrën e përcaktuar në seksionet 2 deri në 18 të shënimeve shpjeguese.

2. Ofruesit e shërbimeve të pagesave nuk e ndryshojnë tabelën për pasqyrën e tarifave, gjatë plotësimit të saj, përveç sa parashikohet në këtë aneks. Në mënyrë të veçantë, ofruesit e shërbimeve të pagesave do të ndjekin renditjen e informacionit, titujt dhe nëntitujt e paraqitur në tabelë.

3. Pasqyra mbi tarifatat e aplikuar:

- paraqitet në format portret A4;
- përmban titullin “Pasqyra mbi tarifatat e aplikuar” në krye të faqes së parë, në qendër;
- përdor llojin e shkrimit “Times New Roman” ose një tjetër lloj shkrimi të ngjashëm me të dhe

madhësinë e shkronjës 11, me përjashtim të titullit “Pasqyra mbi tarifatat e aplikuar”, për të cilin përdoret madhësi e shkronjës 16, të theksuar (*bold*); madhësi e shkronjës 14, të theksuar (*bold*) për titujt dhe madhësinë e shkronjës 12, të theksuar (*bold*) për nëntitujt, në rast se nuk kërkohet rritja e madhësisë së shkronjës apo përdorimi i shkrimit “Braille” për personat me shikim të dëmtuar, sipas ligjit ose siç bihet dakord ndërmjet konsumatorit dhe ofruesit të shërbimeve të pagesave;

d) paraqitet bardh e zi, me përjashtim të logos së ofruesit të shërbimeve të pagesave, që mund të paraqitet me ngjyra, siç përcaktohet në pikën 2 të këtij seksioni;

e) i ka faqet e numëruara.

Seksioni 2: Logoja e ofruesit të shërbimeve të pagesave

1. Logoja e ofruesit të shërbimeve të pagesave do të jetë e një madhësie 2.5 cm x 2.5 cm dhe paraqitet e pozicionuar majtas në krye të tabelës sipas këtij aneksi.



2. Logoja mund të paraqitet me ngjyra ose bardh e zi. Logoja nëse printohet bardh e zi, duhet të jetë qartësisht e lexueshme.

Seksioni 3: Emri dhe detajet e kontaktit të ofruesit të shërbimit të pagesave për shërbimin e llogarisë

1. Ofruesit e shërbimeve të pagesave do të plotësojnë hapësirat ndërmjet kllapave katrore me emrin e ofruesit të shërbimit të pagesës për shërbimin e llogarisë (*account provider*) me shkronja të theksuara (*bold*), majtas.

2. Ofruesit e shërbimeve të pagesave do të plotësojnë hapësirat ndërmjet kllapave katrore me detajet e tyre të kontaktit, të tilla si adresa, numri i telefonit, adresa e postës elektronike, numri i faksit, adresa e faqes së internetit dhe personi/pika e kontaktit, që mbajtësi i llogarisë së pagesave mund të përdorë për korrespondencat e ardhshme.

Këto detaje të kontaktit do të paraqiten majtas.

Seksioni 4: Emri dhe detajet e kontaktit të mbajtësit të llogarisë së pagesave

1. Ofruesit e shërbimeve të pagesave do të plotësojnë hapësirat ndërmjet kllapave katrore me emrin e mbajtësit të llogarisë së pagesave.

Ky emër do të paraqitet me shkronja të theksuara (*bold*), majtas.

2. Ofruesit e shërbimeve të pagesave do të plotësojnë hapësirat ndërmjet kllapave katrore me adresën e mbajtësit të llogarisë së pagesave.

Kjo adresë do të paraqitet majtas dhe, me përjashtim të shkronjës së parë të çdo fjale, me shkronja të vogla.

Seksioni 5: Emri dhe identifikimi i llogarisë

1. Ofruesit e shërbimeve të pagesave do të paraqesin emrin e llogarisë së pagesave.

Ky emër do të paraqitet me shkronja të theksuara (*bold*), majtas dhe drejtpërdrejt pas fjalëve përkatëse.

2. Ofruesit e shërbimeve të pagesave do të paraqesin detaje që identifikojnë llogarinë e pagesave, të tilla si kodi identifikues i biznesit – kodi BIC (*Bank Identifier Code*), kodi identifikues ndërkombëtar i numrit të llogarisë së pagesës – kodi IBAN (*International Bank Account Number*), kodi kombëtar i numrit të llogarisë së pagesës – kodi BBAN dhe kodi kombëtar identifikues biznesi – kodi KIB (*national sort code*).

Këto detaje do të paraqiten majtas.

Seksioni 6: Periudha kalendarike

1. Ofruesit e shërbimeve të pagesave do të

paraqesin në rreshtin “periudha”, majtas, periudhën kalendarike që mbulohet nga pasqyra mbi tarifat e aplikuara.

Seksioni 7: Data

1. Ofruesit e shërbimeve të pagesave do të paraqesin në rreshtin “Data”, majtas, datën kalendarike kur ata kanë ofruar pasqyrën mbi tarifat e aplikuara.

Seksioni 8: Pasqyra hyrëse

1. Teksti i pasqyrës hyrëse, të specifikuar në tabelë, do të riprodhohet si i tillë në pasqyrën mbi tarifat e aplikuara, duke përdorur hapësirë mes rreshtash prej 1.15, 0 *pt* përpara dhe 10 *pt* pas tekstit.

Seksioni 9: Përmbledhja e tarifave dhe interesave

1. Ofruesit e shërbimeve të pagesave do të paraqesin me shkronja të theksuara (*bold*) dhe djathtas, shumat totale të tarifave dhe interesave, që do të përfshihen në katër tabelat e veçanta poshtë titullit “Përmbledhje e tarifave dhe interesave”.

2. Ofruesit e shërbimeve të pagesave do të përdorin formulimin “nuk aplikohen interesat”, me shkronja të vogla dhe djathtas, në rast se për një llogari specifike nuk paguhet interes.

3. Ofruesit e shërbimeve të pagesave do të vendosin “0” në tabelën përkatëse, në rast se aplikohet interes por, për periudhën specifike, ai është i barasvlershëm me zero.

4. Ofruesit e shërbimeve të pagesave do të paraqesin treguesin gjithëpërfshirës të kostos, i cili përmbledh koston e përgjithshme vjetore të llogarisë së pagesës në një tabelë të veçantë.

Seksioni 10: Pasqyrë e detajuar e tarifave të paguara për llogarinë

1. Ofruesit e shërbimeve të pagesave do të paraqesin në tabelën me titull “Pasqyrë e detajuar e tarifave të paguara në llogari”, të gjitha tarifat që zbatohen në periudhën e përcaktuar për shërbimet përkatëse.

Tarifat për hapjen ose mirëmbajtjen e llogarisë do të paraqiten poshtë nëntitullit “Shërbime të përgjithshme të llogarisë.”

2. Ofruesit e shërbimeve të pagesave do të paraqesin shërbimet në nënkolonën “Shërbimi”, majtas, me shkronja të theksuara (*bold*), duke përdorur hapësirë të vetme (single) midis rreshtave 0 *pt* përpara dhe 0 *pt* pas çdo shërbimi.

3. Ofruesit e shërbimeve të pagesave do të paraqesin djathtas në nënkolonën “Numri i herëve



që është përdorur shërbimi” të pasqyrës mbi tarifat e aplikuara, numrin e herëve që çdo shërbim është përdorur gjatë periudhës përkatëse, duke përdorur shkrimin e kërkuar sipas pikës 3, shkronja “d” të seksionit 1.

Ofruesit e shërbimeve të pagesave do ta lënë bosh nënkolonën “Numri i herëve që është përdorur shërbimi” në rastet kur shërbimi është përdorur, por ofruesi i shërbimeve të pagesave nuk ka ngarkuar tarifë për atë shërbim.

4. Ofruesit e shërbimeve të pagesave do të paraqesin djathtas në nënkolonën “Tarifa për njësi” strukturën e tarifës për njësi dhe koston për secilin nga shërbimet e përdorura.

5. Ofruesit e shërbimeve të pagesave do të paraqesin djathtas në nënkolonën “Numri i herëve që u tarifua shërbimi” të pasqyrës mbi tarifat e aplikuara, numrin e herëve që çdo shërbim është tarifuar gjatë periudhës përkatëse. Ofruesit e shërbimeve të pagesave do ta tregojnë këtë në nënkolonën përkatëse, duke përdorur formulimin “tarifë jo e tarifuar/ngarkuar”, në rastet kur shërbimi është përdorur, por nuk është ngarkuar/tarifuar tarifë për të.

6. Ofruesit e shërbimeve të pagesave do të paraqesin në nënkolonën “Total” shumën totale të tarifave të paguara për përdorimin e atij shërbimi gjatë periudhës përkatëse, me shkronja të theksuara (*bold*).

7. Në rastet kur një nëntitull nuk përmban asnjë shërbim, ofruesit e shërbimeve të pagesave do të fshijnë atë nëntitull. Ofruesit e shërbimeve të pagesave do të fshijnë gjithashtu nëntitullin, në rastet kur mbajtësi i llogarisë së pagesave nuk ka përdorur asnjë nga shërbimet përtej sasive të treguara në paketën e shërbimeve gjatë periudhës përkatëse.

8. Ofruesit e shërbimeve të pagesave do të paraqesin shumën totale të tarifave të paguara nga një mbajtës i llogarisë së pagesave gjatë periudhës përkatëse në rreshtin “Tarifat totale të paguara”, me shkronja të theksuara (*bold*).

Seksioni 11: Paraqitja e llojeve të tarifave

1. Në rastet kur ngarkohen/tarifohen tarifa të veçanta në një ose më shumë nga mënyrat e mëposhtme, ofruesit e shërbimeve të pagesave do të paraqesin, në tabelën “Pasqyrë e detajuar e tarifave të paguara në llogari” në kolonën “Shërbimi” të shërbimit përkatës, në një linjë të ndarë, një përshkrim të secilit rast të ngarkimit të

tarifës, kanalit ose kushtit (“lloje të tarifave”):

a) për raste të ndryshme të ngarkimit të tarifave mbi ofrimin e të njëjtit shërbim, të tillë si një tarifë fillestare konfigurimi (*initial set-up fee*) dhe tarifa të mëtejshme ekzekutimi për të njëjtin shërbim;

b) për kanale të ndryshme, përmes të cilëve i njëjti shërbim kërkohet, përdoret apo ofrohet, si për shembull përmes telefonit, degës së ofruesit apo *online*;

c) në varësi të faktit nëse përmbushet apo jo një kusht i veçantë për të njëjtin shërbim, i tillë si zbatimi i një kufiri minimal apo maksimal për transferimet e kredive apo tërheqjet e *cash*-it.

Përshkrimi do të jetë i pasqyruar majtas dhe tarifat do të paraqiten djathtas në kolonën “Tarifa e njësisë”.

2. Ofruesit e shërbimeve të pagesave do të vendosin djathtas përshkrimin e çdo lloji tarife shtesë, përveç zbatimit të pikës 5 të seksionit 10, në rastet kur tarifat ngarkohen në varësi të kombinimit të shumë llojeve të tarifave, siç janë tarifat që ndryshojnë nga kanali dhe më pas ndahen edhe më tej në varësi të faktit nëse është respektuar apo jo një shumë-kufi.

3. Ofruesit e shërbimeve të pagesave do të rendisin tarifat e zbatuara gjatë secilës periudhë, duke shtuar rreshta të rinj në kolonën “Tarifa e njësisë”, në rastet kur tarifa ka ndryshuar gjatë periudhës përkatëse.

Seksioni 12: Paraqitja e paketave të shërbimeve të tarifuar si pjesë e tarifave, poshtë nëntitullit “Shërbime të përgjithshme të llogarisë”

1. Në rastet kur një paketë e shërbimeve të lidhura me një llogari të pagesave, ofrohet me llogarinë dhe tarifohet si pjesë e tarifave poshtë nëntitullit “Shërbime të përgjithshme të llogarisë”, ofruesit e shërbimeve të pagesave do të përfshijnë në tabelën “Pasqyrë e detajuar e tarifave të paguara në llogari”, në rreshtin “Paketa e shërbimeve”, informacionin mbi shërbimet e përfshira në paketë në kolonën “Shërbimi” dhe numrin e herëve që është përdorur paketa në kolonën “Numri i herëve që është përdorur shërbimi”. Në kolonat poshtë “Tarifa”, ofruesit e shërbimeve të pagesave do të paraqesin tarifën e ngarkuar/tarifuar për paketën në tërësinë e saj, dhe numrin e herëve që tarifa e paketës është ngarkuar/tarifuar gjatë periudhës përkatëse, siç



përcaktohet respektivisht në pikën 1 të seksionit 11. Rreshti do të fshihet, në rast se paketa e shërbimeve tarifohet veçmas nga tarifimi për shërbimet e përgjithshme të llogarisë.

2. Çdo tarifë që tarifohet për ndonjë shërbim, që tejkalon sasinë e mbuluar nga paketa, do të paraqitet në tabelën që rendit shërbimet dhe tarifën, siç parashikohet në seksionet 1 deri 11 të shënimeve shpjeguese.

3. Në rastet kur numri i shërbimeve të paketës nuk është i kufizuar, ose kur nuk janë tejkuluar sasitë e shërbimeve të mbuluara nga paketa, ofruesit e shërbimeve të pagesave do të fshijnë deklaratën poshtë rreshtit “Shërbimet përtej këtyre sasive janë tarifuar veçmas”.

Seksioni 13: Paraqitja e paketave të shërbimeve të lidhura me një llogari të pagesave të tarifuar veçmas nga tarifën poshtë nëntitullit “Shërbime të përgjithshme të llogarisë”

1. Në rastet kur ofruesi i shërbimeve të pagesave ofron një paketë shërbimesh të lidhur me një llogari pagesash, së bashku me llogarinë, dhe ajo paketë është e tarifuar veçmas nga të gjitha tarifën poshtë nëntitullit “Shërbime të përgjithshme të llogarisë” për shërbimet e përgjithshme të llogarisë siç parashikohet në tabelën që rendit shërbimet dhe tarifën, ofruesit e shërbimeve të pagesave do të përfshijnë në tabelën mbi paketën e shërbimeve informacionin e mëposhtëm:

a) në kolonën mbi paketën e shërbimeve, emrin e markës, nëse është e mundur, ose përmbajtjen e paketës, duke fshirë kllapat katrore;

b) në kolonën “Tarifa”, tarifën e ngarkuar për paketën në tërësinë e saj për periudhën e pasqyrës mbi tarifën e aplikuar, djathtas;

c) në kolonën e tretë, numrin e herëve që tarifa e paketës është ngarkuar gjatë periudhës përkatëse.

Çdo tarifë shtesë e ngarkuar për ndonjë shërbim që tejkalon sasinë e mbuluar nga tarifa e paketës do të paraqitet në tabelën mbi shërbimet dhe tarifën, siç përmendet në seksionet 10 dhe 11 të shënimeve shpjeguese.

2. Në rastet kur paketa tarifohet bazuar në një frekuencë të caktuar përdorimi, frekuenca do të paraqitet në kolonën “Tarifa”, majtas, ndërsa kosto totale vjetore do të shfaqet në rreshtin që vjen menjëherë poshtë frekuencës së tarifimit, me shkronja të theksuara (*bold*) dhe duke përdorur formulimin “Kosto totale vjetore”.

3. Në rastet kur paketa të ndryshme u

nënshtrohen tarifave të ndryshme gjatë periudhës përkatëse, informacioni i paraqitur në pikën 1 do të ofrohet për secilën nga paketat në një tabelë më vete.

4. Ofruesit e shërbimeve të pagesave do të fshijnë të gjithë tabelën, duke përfshirë titullin “Detaje të tarifave të përfshira në paketën e shërbimeve”, nëse një paketë e shërbimeve nuk ofrohet bashkë me llogarinë, ose nëse paketa e shërbimeve e ofruar me llogarinë tarifohet/ngarkohet si pjesë e tarifës për çdo shërbim të përgjithshëm të llogarisë.

5. Në rastet kur numri i të gjitha shërbimeve të paketës nuk është i kufizuar, ose kur nuk janë tejkuluar sasitë e shërbimeve të mbuluara nga paketa e shërbimeve, ofruesit e shërbimeve të pagesave do të fshijnë deklaratën poshtë tabelës ku shkruhet “Shërbimet përtej këtyre sasive janë tarifuar veçmas”.

Seksioni 14: Detaje të interesit të paguar në llogari

1. Ofruesit e shërbimeve të pagesave do të paraqesin në tabelën “Detaje të interesit të paguar në llogari”, interesin e paguar nga mbajtësi i llogarisë së pagesave gjatë periudhës së mbuluar nga pasqyra mbi tarifën e aplikuar, aty ku është e aplikueshme.

2. Ofruesit e shërbimeve të pagesave do të paraqesin normën e interesit në kolonën “Norma e interesit” dhe si përqindje të zbatuar në bazë vjetore. Në rast se norma e interesit ka ndryshuar gjatë periudhës përkatëse, ofruesit e shërbimeve të pagesave do të rendisin çdo normë interesi që është aplikuar gjatë secilës periudhë në një rresht më vete.

3. Ofruesit e shërbimeve të pagesave do të paraqesin në kolonën “Interesi”, interesin e paguar nga një mbajtës i llogarisë së pagesave, të shprehur në monedhën e llogarisë, me shkronja të theksuara (*bold*). Nëse norma e interesit ka ndryshuar gjatë periudhës përkatëse, ofruesit e shërbimeve të pagesave do të tregojnë interesin e paguar nga mbajtësi i llogarisë së pagesave, më vete, për secilën nga periudhat përkatëse, secili në një rresht më vete.

4. Ofruesit e shërbimeve të pagesave do të paraqesin shumën totale të interesit, të paguar nga mbajtësi i llogarisë së pagesave gjatë periudhës përkatëse, me shkronja të theksuara (*bold*) në rreshtin “Interesi total i paguar”.



5. Ofruesit e shërbimeve të pagesave do të paraqesin fjalët “nuk aplikohet interes”, me shkronja të vogla, majtas, me *bold*, në rreshtin “Interesi total i paguar”, në rastet kur një mbajtës i një llogarie të pagesave nuk paguan interes, pasi nuk aplikohet interes mbi llogarinë.

Seksioni 15: Detaje të interesit të fituar nga llogaria

1. Ofruesit e shërbimeve të pagesave do të paraqesin në tabelën “Detaje të interesit të fituar nga llogaria”, interesin e fituar nga mbajtësi i llogarisë së pagesave gjatë periudhës së mbuluar nga pasqyra mbi tarifat e aplikuar, aty ku është e aplikueshme.

2. Ofruesit e shërbimeve të pagesave do të plotësojnë fushën “Emri i llogarisë” me emrin e llogarisë përkatëse, me shkronja të theksuara (*bold*).

3. Ofruesit e shërbimeve të pagesave do të paraqesin normën e interesit në kolonën “Norma e interesit” dhe si përqindje të aplikuar në bazë vjetore. Në rast se norma e interesit ka ndryshuar gjatë periudhës përkatëse, ofruesit e shërbimeve të pagesave do të rendisin çdo normë interesi që është aplikuar gjatë secilës periudhë në një rresht më vete.

4. Ofruesit e shërbimeve të pagesave do të paraqesin në kolonën “Interesi”, interesin e fituar nga një mbajtës i llogarisë së pagesave, të shprehur në monedhën e llogarisë, me shkronja të theksuara (*bold*). Nëse norma e interesit ka ndryshuar gjatë periudhës së mbuluar nga pasqyra mbi tarifat e aplikuar, ofruesit e shërbimeve të pagesave do të paraqesin interesin e fituar nga mbajtësi i llogarisë së pagesave, më vete, për secilën nga periudhat përkatëse, secili në një rresht më vete. Në rastet kur aplikohet normë interesi, por, për periudhën specifike, ajo është e barabartë me zero, ofruesit e shërbimeve të pagesave do të paraqesin “0” në kolonën “Interesi”.

5. Ofruesit e shërbimeve të pagesave do të paraqesin fjalët “nuk aplikohet interes”, me shkronja të vogla, majtas, në kolonën “Interesi”, në rastet kur një llogari e veçantë nuk paguan interes, për arsye se nuk aplikohet interes mbi llogarinë.

6. Ofruesit e shërbimeve të pagesave do të paraqesin në rreshtin “Interesi total i fituar” me shkronja të theksuara (*bold*), shumën totale të interesit, të fituar nga mbajtësi i llogarisë së pagesave gjatë periudhës së mbuluar nga pasqyra mbi tarifat e aplikuar.

7. Ofruesit e shërbimeve të pagesave do të paraqesin fjalët “nuk aplikohet interes”, me shkronja të vogla (majtas), me shkronja të theksuara (*bold*), në rreshtin “Interesi total i fituar”, në rastet kur një llogari e veçantë nuk paguan interes për arsye se mbi atë llogari nuk aplikohet interes.

Seksioni 16: Informacion mbi shërbimet shtesë

1. Ofruesit e shërbimeve të pagesave do të paraqesin në tabelën “Informacion mbi shërbimet shtesë”, çdo informacion shtesë që shkon përtej informacionit të parashikuar në seksionet 2 deri 15 dhe që është drejtpërsëdrejti i lidhur me shërbimet apo tarifat e paguara, ose interesin e ngarkuar apo të fituar, ose me normat e interesit të aplikuar, siç përcaktohet në nenin 7, pika 3, të kësaj rregulloreje gjatë periudhës së mbuluar nga pasqyra mbi tarifat e aplikuar. Informacioni mbi shërbimet shtesë, i paraqitur në atë tabelë, do të përfshijë informacionin e kërkuar nga rregulloret në fuqi.

2. Ofruesit e shërbimeve të pagesave do të ndjekin modelin/formatin e paraqitjes së përcaktuar në këtë aneks, gjatë plotësimit të tabelës, nëse kjo është e aplikueshme.

3. Ofruesit e shërbimeve të pagesave do ta fshijnë këtë tabelë, nëse ata nuk do të ofrojnë llojin e informacionit, që specifikohet në pikën 1 të kësaj pike.

Seksioni 17: Emrat e markës

1. Në rastet kur përdoret një emër tregtar (*brand name*), ai do të pasqyrohet menjëherë pas emrit të shërbimit, duke përdorur standardin e shkrimit të përmendur në pikën 3, shkronja “d” të seksionit 1 dhe brenda kllapave katrore.

Seksioni 18: Përdorimi i mjeteve elektronike

1. Në rastet kur pasqyra mbi tarifat e aplikuar ofrohet përmes mjeteve elektronike, ofruesit e shërbimeve të pagesave, me kusht që në të njëjtën kohë konsumatorit t’i vihet në dispozicion një kopje e pasqyrës mbi tarifat e aplikuar, në linjë me tabelën e paraqitur në aneks dhe të plotësuar siç përcaktohet në seksionet 2 deri 17, mund ta ndryshojnë tabelën vetëm në mënyrat e mëposhtme:

a) pa rënë ndesh me shkronjën “d”, të pikës 3 të seksionit 1, mund të rrisin madhësinë e shkrimit, me kusht që të ruhet proporcioni i madhësive, siç paraqitet në seksionin 1, pika 3;

b) në rastet kur përmasat e mjeteve elektronike janë të tilla që, përdorimi i shumë tabelave dhe



kolonave do ta vështirësonte leximin e pasqyrës mbi tarifat e aplikuara, mund të përdorin një kolonë të vetme ose një tabelë të vetme, nëse ruhet rendi i informacionit, titujt dhe nëntitujt;

c) të përdorin mjetet elektronike, me kusht që titulli i pasqyrës mbi tarifat e aplikuara, titujt dhe nëntitujt, të shfaqen në mënyrë të dukshme dhe të ruhet rendi i informacionit.

2. Përdorimi i mjeteve elektronike, që përmendet në shkronjën “c”, të pikës 1, nuk duhet të ndikojë apo shpërqendrojë konsumatorin nga informacioni që përmbahet në pasqyrën mbi tarifat e aplikuara.

VENDIM

Nr. 63, datë 21.12.2022

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR RAPORTIMIN STATISTIKOR TË MJETEVE DHE DETYRIMEVE TË FONDEVE TË INVESTIMIT”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; dhe ligjit nr. 30/2022, “Për miratimin e programit të statistikave zyrtare 2022–2026”; me propozimin e Departamentit të Statistikave Financiare, Këshilli Mbikëqytres i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren “Për raportimin statistikor të mjeteve dhe detyrimeve të fondeve të investimit”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet Departamenti i Statistikave Financiare të Bankës së Shqipërisë, për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gent Sejko

RREGULLORE

PËR RAPORTIMIN STATISTIKOR TË MJETEVE DHE DETYRIMEVE TË FONDEVE TË INVESTIMIT

Neni 1

Objekti dhe fusha e veprimit

Rregullorja përcakton kërkesat e raportimit në lidhje me informacionin statistikor të mjeteve dhe detyrimeve të fondeve të investimit që ushtrojnë aktivitet në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 2

Baza ligjore

Kjo rregullore nxirret në mbështetje të:

- a) nenit 26, pika 1, të ligjit nr. 17/2018 “Për statistikatat zyrtare”, i ndryshuar;
- b) ligjit nr. 30/2022 “Për miratimin e programit të statistikave zyrtare 2022–2026”.

Neni 3

Përkufizimet

Për qëllime të kësaj rregulloreje:

1. “fond investimi (FI)” nënkupton një sipërmarrje investimi kolektive, e cila:

a) ka si objekt sigurimin e kapitalit nga investitorët publikë dhe investimin e këtij kapitali në aktive financiare dhe/ose jofinanciare, siç referohet në pjesën 1 të shtojcës I bashkëlidhur kësaj rregulloreje,

b) është krijuar në përputhje me ligjin nr. 56/2020, datë 30.4.2020, “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”.

Në këtë përkufizim përfshihen:

c) sipërmarrjet, kuotat ose aksionet e të cilave, me kërkesë të zotëruesve, riblihen ose shlyhen drejtpërdrejt ose tërthorazi nga aktivet e ndërmarrjes, dhe

d) sipërmarrjet që kanë një numër fiks aksionesh të emetuara dhe aksionarët e të cilave duhet të blejnë ose shesin aksionet ekzistuese kur hyjnë ose dalin nga fondi.

Në këtë përkufizim nuk përfshihen:

e) “fond pensioni (FP)” ka të njëjtin kuptim siç përcaktohet në neni 5, pika 1, të ligjit nr. 10197, datë 10.12.2009, “Për fondet e pensionit vullnetar”,



f) fondet e tregut të parasë (FTP) siç përkufizohen në nenin 3, pika 4, të rregullores nr. 73/2021 të Bankës së Shqipërisë “Për raportimet në Bankën e Shqipërisë të zërave të bilancit të institucioneve të kreditit dhe të institucioneve monetare financiare”.

Për qëllimet e përkufizimit të FI, “publike” do të përfshijë investitorët individë, profesionistë dhe investitorë të tjerë institucionalë;

2. “Rezident” ka të njëjtin kuptim siç përcaktohet në nenin 3, pika 6, të rregullores nr. 73/2021 të Bankës së Shqipërisë “Për raportimet në Bankën e Shqipërisë të zërave të bilancit të institucioneve të kreditit dhe të institucioneve monetare financiare”;

3. “Institucion monetar financiar (IMF)” ka të njëjtin kuptim siç përcaktohet në nenin 3, pika 1, të rregullores nr. 73/2021 të Bankës së Shqipërisë “Për raportimet në Bankën e Shqipërisë të zërave të bilancit të institucioneve të kreditit dhe të institucioneve monetare financiare”;

4. “Ndërmjetës të tjerë financiar përveç shoqërive të sigurimit dhe fondeve të pensioneve”, nënkupton të gjitha institucionet e tjera që kryejnë ndërmjetësim financiar apo lehtësojnë ndërmjetësimin financiar të tilla si: institucionet e kreditit, institucionet që ofrojnë qirane financiare (leasing), institucionet e financimit të transaksioneve tregtare, institucionet e mikrokredisë, faktoringut, të gjitha shërbimet e pagesave dhe transferimit të parave, unionet e Shoqërive të Kursim Kreditit, shoqëritë administruese të fondeve të investimit dhe të fondeve të pensionit vullnetar etj.;

5. “Fonde investimi (FI) me aksione/kuota të regjistruara” do të thotë që institucioni financiar emeton aksione/kuota në lidhje me të cilat, në përputhje me legjislacionin shqiptar, mbahet një procesverbal që identifikon mbajtësit e aksioneve/njësive të tij, duke përfshirë informacionin mbi vendbanimin dhe sektorin e mbajtësit;

6. “Fonde investimi (FI) me aksione/kuota të prurësit” do të thotë që FI emeton aksione/kuota në lidhje me të cilat, në përputhje me legjislacionin shqiptar, nuk mbahet një regjistrim që identifikon mbajtësit e aksioneve/kuotave të tij, ose në lidhje me të cilat mbahet një regjistër i cili nuk përmban informacion mbi vendbanimin dhe sektorin e mbajtësit;

7. “të dhëna titull-për-titull” do të thotë të dhëna të detajuara për çdo titull.

Neni 4

Popullata aktuale raportuese

1. Popullata aktuale raportuese përbëhet nga shoqëritë administruese të Fondeve të Investimeve (FI) të licencuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF).

2. Popullata aktuale raportuese do t'i nënshtrohet kërkesave të plota të raportimit statistikor të përcaktuar në këtë rregullore.

Neni 5

Lista e FI-ve për qëllime statistikore

1. Banka e Shqipërisë (BSH) harton dhe përditëson listën e FI-ve, bazuar në informacionin e regjistruar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

2. BSH-ja publikon në faqen zyrtare të saj listën e përditësuar të FI-ve për qëllime statistikore.

Neni 6

Raportimi për çdo fond individual

1. Popullata aktuale raportuese duhet të raportojë të dhëna për aktivet dhe detyrimet e saj për çdo fond individual.

2. Pa cenuar pikën 1 të këtij neni, nëse një FI i ndan aktivet e saj në nënfonde të ndryshme në mënyrë të tillë që aksionet/kuotat që lidhen me secilin nënfond të mbështeten në mënyrë të pavarur nga aktive të ndryshme, çdo nënfond do të konsiderohet si një FI më vete.

3. Në përjashtim nga pikat 1 dhe 2 të këtij neni, vetëm në rast të miratimit paraprak dhe në përputhje me udhëzimet e BSH-së, fondet e investimit mund të raportojnë aktivet dhe detyrimet e tyre si grup, me kusht që kjo të çojë në rezultate që janë të ngjashme me raportimin individual të fondeve.

Neni 7

Kërkesat e raportimit statistikor tremujor

1. Popullata raportuese duhet të raportojë pranë AMF-së, informacionin e kërkuar sipas përcaktimeve në shtojcat I dhe II, pjesë bashkëlidhur e kësaj rregulloreje:



a) në baza tremujore të dhënat e stokut, në fund të periudhës, të aktiveve/pasiveve të FI-ve dhe, rregullimet tremujore të rivlerësimit ose transaksionet financiare në lidhje me aktivet/pasivet, kur është e aplikueshme;

b) në bazë tremujore, të dhënat e stokut në fund të periudhës, të aksioneve/njësive të emetuara të FI-ve, rregullimet mujore korresponduese të rivlerësimit ose transaksionet, nëse është e aplikueshme, dhe raportim të veçantë të emetimeve të reja dhe shlyerjeve të aksioneve/njësive të FI-ve gjatë muajit raportues.

2. Për të minimizuar barrën e raportimit mbi popullatën raportuese, BSH-ja do të kombinojë kërkesat e raportimit për qëllime të kësaj rregulloreje me të dhënat e mbledhura nga AMF-ja.

Neni 8

Rregullimet e rivlerësimit dhe transaksionet financiare

1. Popullata raportuese do të raportojë ndryshimet nga rivlerësimi ose transaksionet financiare, në përputhje me udhëzimet përkatëse të BSH-së, për informacionin e raportuar sipas përcaktimeve në shtojca I.

2. BSH-ja do të nxjerrë përafrime të vlerës së transaksioneve të titujve nga të dhënat titull-përtitull ose do të mbledhë drejtpërdrejt të dhëna për transaksione të tilla nga subjektet raportuese, sipas përcaktimeve në shtojcën I, pjesë bashkëlidhur e kësaj rregullore.

3. Udhëzime të mëtejshme në lidhje me hartimin e ndryshimeve nga rivlerësimi dhe transaksioneve financiare përcaktohen në shtojca II.

Neni 9

Parimet kontabël për qëllim të raportimit statistikor

1. Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë rregullore, rregullat e kontabilitetit të ndjekura nga IF-të për qëllime të raportimit sipas kësaj rregulloreje do të jenë ato të përcaktuara në rregullat e kontabilitetit kombëtar dhe standardet ndërkombëtare përkatëse.

2. Fshirjet dhe zhvlerësimet e përcaktuara nga praktikat përkatëse të kontabilitetit do të përjashtohen nga shuma e kryegjësë së papaguar të

huave dhe do të raportohen veçmas.

3. Pa cenuar praktikat kontabël dhe marrëveshjet e netimit që mbizotërojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë, të gjitha aktivet dhe detyrimet financiare do të raportohen në bazë bruto për qëllime statistikore.

Neni 10

Afati i raportimit

Popullata raportuese raporton të dhënat e kërkuara tremujore, jo më vonë se 45 ditë pas fundit të periudhës së referencës.

Neni 11

Standardet minimale dhe rregullat kombëtare të raportimit

1. Popullatat raportuese duhet të përmbushin kërkesat e raportimit statistikor, të cilave u nënshtrohen në përputhje me standardet minimale për transmetimin, saktësinë, përputhshmërinë me konceptet e përcaktuara në shtojcën 3.

2. BSH-ja përkufizon dhe zbaton rregullat e raportimit që ndiqen nga popullata raportuese aktuale, në përputhje me kërkesat kombëtare. BSH-ja garanton që rregullat e raportimit në fjalë mundësojnë të dhënat e kërkuara statistikore dhe lejojnë që përmbushja e standardeve minimale rreth transmetimit të informacionit, saktësisë, përputhshmërisë me konceptet e përcaktuara në shtojcën 3, të sigurohen në vijimësi.

Neni 12

Bashkimet me përthithje, ndarjet dhe riorganizimet

Në rast të një bashkimi me përthithje, ndarjeje ose riorganizimi që mund të ndikojë në përmbushjen e detyrimeve statistikore, çdo subjekt raportues i interesuar duhet të informojë BSH-në drejtpërdrejt ose nëpërmjet AMF-së, në përputhje me marrëveshjen e bashkëpunimit të lidhur ndërmjet dy institucioneve, sapo të jetë publikuar synimi për të zbatuar një operacion të tillë dhe brenda një kohe të arsyeshme përpara se të hyjë në fuqi, procedurat që janë planifikuar për të përmbushur kërkesat e raportimit statistikor të përcaktuara në këtë rregullore.



Neni 13

Mbledhja e të dhënave

BSH-ja bashkëpunon me AMF-në për mbledhjen nga popullata raportuese, të të dhënave të parashikuara në këtë rregullore, nëpërmjet lidhjes së një marrëveshjeje bashkëpunimi ndërmjet dy institucioneve.

Neni 14

Raportimi i parë

Raportimi i parë do të fillojë me të dhënat tremujore për tremujorin 4^t të vitit 2023.

Neni 15

Dispozitë e fundit

Shtojcat I, II dhe III bashkëlidhur kësaj rregulloreje janë pjesë përbërëse e saj.

KRYETAR I KËSHILLIT MBIKËQYRËS
Gent Sejko

SHTOJCA I
KËRKESAT PËR RAPORTIM
STATISTIKOR

PJESA 1

Kërkesat e përgjithshme të raportimit statistikor

1. Popullata aktuale raportuese duhet të sigurojë informacionin statistikor të mëposhtëm:

Në baza tremujore:

a) të dhëna për titujt me kode ISIN;

b) të dhënat për titujt pa kode ISIN, qoftë sipas raportimit titull-për-titull ose të përmbledhura, të ndara sipas kategorive të instrumentit, maturitetit dhe kundërpartisë;

c) të dhëna për mjetet dhe detyrimet e ndryshme nga titujt, të ndara sipas kategorive të instrumentit, maturitetit dhe kundërpartisë;

d) të dhëna për mjetet dhe detyrimet (përjashtuar titujt), të ndara sipas kategorive të instrumenteve, monedhës dhe kundërpartisë;

e) në baza tremujore, informacion të detajuar titull-për-titull për të gjitha aksionet/njësitet e emetuara nga FI-të.

2. Të dhënat e përmbledhura duhet të jepen në

terma të stogëve dhe në përputhje me udhëzimet e BSH-së për sa u përket: a) rivlerësimeve për shkak të ndryshimeve të çmimeve dhe kursit të këmbimit; ose b) transaksionet financiare.

3. Të dhënat që duhet të raportohen për titujt me kod ISIN specifikohen në tabelën 2. Kërkesat e agreguara të raportimit statistikor tremujor për stoqet dhe për rivlerësimet për shkak të ndryshimeve të çmimeve dhe kursit të këmbimit ose transaksioneve financiare, janë të specifikuara në tabelat 1a dhe 1b. Informacioni i agreguar tremujor për stoqet, rivlerësimet për shkak të ndryshimeve të çmimeve dhe kursit të këmbimit, transaksionet, si dhe emetimet e reja dhe shlyerjet e aksioneve/njësive të FI, janë specifikuar në tabelën 3.

PJESA 2

Rezidenca dhe sektori ekonomik i zotëruesve të aksioneve/njësive të FI

1. Subjektet raportuese raportojnë, në baza tremujore, të dhëna mbi rezidencën e mbajtësve të aksioneve/njësive të FI të lëshuara nga FI rezidente në Republikën e Shqipërisë, të detajuar në rezidentë, jorezidentë Eurozona dhe jorezidentë jashtë Eurozonës. Rezident, jorezident dhe Eurozona janë zëbërthyer më tej sipas sektorëve.

2. Për aksionet/njësitet e regjistruara, subjektet raportuese raportojnë të dhëna për rezidencën dhe ndarjen sektoriale të zotëruesve të aksioneve/njësive të emetuara nga FI. Nëse vendbanimi dhe sektori i mbajtësit nuk mund të identifikohen drejtpërdrejt, të dhënat përkatëse raportohen në bazë të informacionit të disponueshëm.

3. Sa u përket aksioneve/njësive të prurësit, agjentët raportues raportojnë të dhëna për rezidencën dhe ndarjen sektoriale të mbajtësve të aksioneve/njësive të FI, në përputhje me qasjen e vendosur nga BSH-ja. Kjo mund të realizohet duke zgjedhur një ose një kombinim të opsioneve të mëposhtme, që do të zgjidhen duke pasur parasysh organizimin e tregjeve përkatëse dhe rregullimet ligjore kombëtare në Shqipëri.

a) FI-të emetuese:

FI-të emetuese ose personat që i përfaqësojnë ligjërisht, ose subjektet e përmendura në nenin 3 pika 2 të kësaj rregulloreje, raportojnë të dhëna për vendbanimin dhe ndarjen sektoriale të zotëruesve



të aksioneve/njësive të tyre të emetuara. Një informacion i tillë mund të vijë nga agjenti që shpërndan aksionet/njësitet ose nga çdo subjekt tjetër i përfshirë në emetimin, blerjen ose transferimin e aksioneve/njësive.

b) Institucionet monetare financiare dhe ndërmjetësit e tjerë financiarë si kujdestarë të aksioneve/njësive të FI:

Si agjentë raportues, IMF-të dhe NTF-të që vepron si kujdestarë të aksioneve/njësive të FI-ve, raportojnë të dhëna për rezidencën dhe ndarjen sektoriale të mbajtësve të aksioneve/njësive të emetuara nga FI-të rezidente dhe të mbajtura në ruajtje në emër të mbajtësit ose të një ndërmjetësi tjetër që vepron gjithashtu si një kujdestar. Ky opsion është i zbatueshëm nëse: i) kujdestari dallon aksionet/njësitet e FI-ve të mbajtura për llogari të zotëruesve të aksioneve/njësive ose të një ndërmjetësi tjetër që vepron gjithashtu si kujdestar; dhe ii) shumica e aksioneve/njësive të FI-ve janë nën kujdestarinë e institucioneve vendase rezidente që klasifikohen si ndërmjetës financiarë (IMF ose NTF).

c) IMF-të dhe NTF-të si raportues të transaksioneve ndërmjet rezidentëve dhe jorezidentëve që përfshijnë aksione/njësi të një FI-je rezidente:

Si agjentë raportues, IMF-të dhe OFI-të, të cilët raportojnë transaksione të rezidentëve me

jorezidentët që përfshijnë aksione/njësi të një FI-je rezidente, do të raportojnë të dhëna mbi rezidencën dhe ndarjen sektoriale të mbajtësve të aksioneve/njësive të emetuara nga FI-të rezidente, të cilat ata i tregtojnë në emër të mbajtësit ose një ndërmjetësi tjetër të përfshirë gjithashtu në transaksion. Ky opsion është i zbatueshëm nëse: i) mbulimi raportues është gjithëpërfshirës, d.m.th. mbulon të gjitha transaksionet e kryera nga agjentët raportues; ii) jepen të dhëna të sakta për blerjet dhe shitjet me jorezidentë të shteteve anëtare të zonës së euros; (iii) diferencat ndërmjet vlerës së emetimit dhe vlerës së riblerjes, duke përjashtuar tarifat, të të njëjtave aksione/njësi janë minimale; dhe iv) shumica e aksioneve/njësive të mbajtura nga jorezidentët e shteteve anëtare të zonës së euros, të emetuara nga FI-të rezidente është e ulët.

d) Nëse pikat “a” deri “c” nuk zbatohen, agjentët raportues, duke përfshirë IMF-të dhe NTF-të, raportojnë të dhënat përkatëse në bazë të informacionit të disponueshëm.

4. Nëse aksionet/njësitet e regjistruara ose aksionet/njësitet e prurësit emetohen për herë të parë ose nëse zhvillimet e tregut kërkojnë një ndryshim të këtyre kërkesave, BSH-ja mund të japë derogime për një vit, në lidhje me kërkesat e përcaktuara në paragrafët 2 dhe 3

	EMRI I FORMULARIT:	Pasqyra e detajuar e mjeteve dhe detyrimeve të										
	PERIODICITETI:	Tremujor										
	MONEDHA E RAPORTIMIT:	Lekë										
	NJESIA:	Njësi monetare										
		Sektorët Rezidentë										
	Sektorët 2)	Banka qendrore	Bankat e nivelit të dytë	Shoqëritë e kursim kreditit	Fondet e Investimit	Ndërmjetës të tjerë financiarë (përveç shoqërive të sigurimit dhe fondëve të pensionit vullnetar) dhe ndihmësit financiarë	Shoqëritë e sigurimit + Fondet e pensionit vullnetar	Qeveria qendrore	Qeveria lokale	Korporatat financiare publike	Korporatat financiare private	Individët +institucione jo me qëllim fitimi që u shërbejnë individëve
I	M J E T E		-					-				
1	Arka											
	Në lekë											
	Në valutë											
	nga të cilat: në EUR											
	nga të cilat: në USD											
2	Llogari rrjedhëse											
	Në lekë											
	Në valutë											
	nga të cilat: në EUR											
	nga të cilat: në USD											
3	Depozita (pretendime)											
	Deri në një vit											
	Në lekë											
	Në valutë											
	nga të cilat: në EUR											
	nga të cilat: në USD											
	Mbi një vit											
	Në lekë											
	Në valutë											
	nga të cilat: në EUR											
	nga të cilat: në USD											

[illegible]



6	Aksione 3) dhe kapital tjetër												
	Në lekë												
	Aksione te listuara												
	Aksione te palistuar												
	Kapital tjetër												
	Në valutë												
	Aksione te listuara												
	Aksione te palistuar												
	Kapital tjetër												
	nga të cilat: në EUR												
	Aksione te listuara												
	Aksione te palistuar												
	Kapital tjetër												
	nga të cilat: në USD												
	Aksione te listuara												
	Aksione te palistuar												
	Kapital tjetër												
7	Kuota/aksione të fondeve të investimit 3)												
7.1	Kuota/aksione të fondeve të tregut të parashë 3) 4)												
	Në lekë												
	Në valutë												
	nga të cilat: në EUR												
	nga të cilat: në USD												
7.2	Kuota/aksione të fondeve të investimit jo të tregut të parashë 3) 5)												
	Në lekë												
	Në valutë												
	nga të cilat: në EUR												
	nga të cilat: në USD												
8	Derivativë financiarë												
	Në lekë												
	Në valutë												
	nga të cilat: në EUR												
	nga të cilat: në USD												



9	Llogari të arkëtueshme											
9.1	Kredi tregtare											
	Në lekë											
	Në valutë											
	nga të cilat: në EUR											
	nga të cilat: në USD											
9.2	Të tjera të arkëtueshme											
	Në lekë											
	Në valutë											
	nga të cilat: në EUR											
	nga të cilat: në USD											
II	DETYRIME											
1	Hua (të marra)											
	Deri në një vit											
	Në lekë											
	Në valutë											
	nga të cilat: në EUR											
	nga të cilat: në USD											
	Mbi një vit											
	Në lekë											
	Në valutë											
	nga të cilat: në EUR											
	nga të cilat: në USD											



Sektorët 2)	Sektorët Jorezidentë Euro zona							Jorezidentë të tjerë		
	Institucionet Monetare Financiare	Institucionet Monetare Jo Financiare								
		Qeveria e përgjithshme	Sektorë të tjerë (Total)							
			Fondet e Investimit	Ndërmjetës të tjerë financiarë (përveç shoqërive të sigurimit dhe fondeve të pensionit vullnetar)	Shoqëritë e sigurimit + Fondet e pensionit vullnetar	Korporata jo financiare	Individët +institucionet jo me qëllim fitimi që u shërbejnë individëve	nga të cilat shtetet anëtare të jo-euro zonës	nga të cilat SHBA	nga të cilat Japoni
M J E T E		-					-		-	
Arka										
Në lekë										
Në valutë										
nga të cilat: në EUR										
nga të cilat: në USD										
Llogari rrjedhëse										
Në lekë										
Në valutë										
nga të cilat: në EUR										
nga të cilat: në USD										
Depozita (pretendime)										
Deri në një vit										
Në lekë										
Në valutë										
nga të cilat: në EUR										
nga të cilat: në USD										
Mbi një vit										
Në lekë										
Në valutë										
nga të cilat: në EUR										
nga të cilat: në USD										



Hua (pretendime)								
Deri në një vit								
Në lekë								
Në valutë								
nga të cilat: në EUR								
nga të cilat: në USD								
Mbi një vit								
Në lekë								
Në valutë								
nga të cilat: në EUR								
nga të cilat: në USD								
Tituj të borxhit (investime) 3)								
Në lekë								
deri në një vit								
mbi një vit deri në 2 vjet								
mbi 2 vjet								
Në valutë								
deri në një vit								
mbi një vit deri në 2 vjet								
mbi 2 vjet								
nga të cilat: në EUR								
deri në një vit								
mbi një vit deri në 2 vjet								
mbi 2 vjet								
nga të cilat: në USD								
deri në një vit								
mbi një vit deri në 2 vjet								
mbi 2 vjet								



Aksione 3) dhe kapital tjetër									
Në lekë									
Aksione te listuara									
Aksione te palistuara									
Kapital tjetër									
Në valutë									
Aksione te listuara									
Aksione te palistuara									
Kapital tjetër									
nga të cilat: në EUR									
Aksione te listuara									
Aksione te palistuara									
Kapital tjetër									
nga të cilat: në USD									
Aksione te listuara									
Aksione te palistuara									
Kapital tjetër									
Kuota/aksione të fondeve të investimit 3)									
Kuota/aksione të fondeve të tregut të parësë 3) 4)									
Në lekë									
Në valutë									
nga të cilat: në EUR									
nga të cilat: në USD									
Kuota/aksione të fondeve të investimit jo të tregut të parësë 3) 5)									
Në lekë									
Në valutë									
nga të cilat: në EUR									
nga të cilat: në USD									
Derivativë financiare									
Në lekë									
Në valutë									
nga të cilat: në EUR									
nga të cilat: në USD									



Llogari të arkëtueshme										
Kredi tregtare										
Në lekë										
Në valutë										
nga të cilat: në EUR										
nga të cilat: në USD										
Të tjera të arkëtueshme										
Në lekë										
Në valutë										
nga të cilat: në EUR										
nga të cilat: në USD										
DETYRIME										
Hua (të marra)										
Deri në një vit										
Në lekë										
Në valutë										
nga të cilat: në EUR										
nga të cilat: në USD										
Mbi një vit										
Në lekë										
Në valutë										
nga të cilat: në EUR										
nga të cilat: në USD										



Tituj të borxhit 3)									
Në lekë									
deri në një vit									
mbi një vit deri në 2 vjet									
mbi 2 vjet									
Në valutë									
deri në një vit									
mbi një vit deri në 2 vjet									
mbi 2 vjet									
nga të cilat: në EUR									
deri në një vit									
mbi një vit deri në 2 vjet									
mbi 2 vjet									
nga të cilat: në USD									
deri në një vit									
mbi një vit deri në 2 vjet									
mbi 2 vjet									
Kuota/aksione të fondeve të investimit 3)									
Në lekë									
Në valutë									
nga të cilat: në EUR									
nga të cilat: në USD									
Derivatë financiarë									
Në lekë									
Në valutë									
nga të cilat: në EUR									
nga të cilat: në USD									



Llogari të pagueshme										
Kredi tregtare										
Në lekë										
Në valutë										
nga të cilat: në EUR										
nga të cilat: në USD										
Të tjera të pagueshme										
Në lekë										
Në valutë										
nga të cilat: në EUR										
nga të cilat: në USD										

- Shënime:**
- 1) Të dhënat në tabelën 2 duhet të jenë të barabarta me të dhënat respektive të raportuara në bilanc (tabela1).
 - 2) Interesat e përlogaritur raportohen në instrumentin përkatës
 - 3) Shpjegimet për sektorët i gjeni në faqen "Sektorët"
 - 4) Tituj të borxhit dhe aksionet në këtë formular raportohen me vlerën e tregut.
 - 7) Pasqyra plotësohet vetëm në qelizat ku disponohet informacion.

[Sektorët](#)

	Nuk është i aplikueshem (nuk vendoset vlerë)
	Formule

Tabela 2
Të dhënat e titujve – databaza “titull për titull”

Kodi ISIN	Nr i ankandit	Emri i titullit të blerë nga sektori bankar	Tipi i instrumentit	Maturiteti	Listimi në bursë	Klasa e instrumentit	Data e emetimit	Data e blerjes	Data e maturimit	Emri i emetuesit	Sektori i emetuesit	Rezidenca e emetuesit	Kodi i vendit të emetuesit	Monedha	Transaksioni (+/-) gjatë periudhës (në vlerë tregu)	Çmimi i blerjes	Vlera e tregut në fund të periudhës	Vlera kontabile në fund të periudhës	Interesi i përlogaritur në fund të periudhës



Tabela 3
Të dhëna tremujore

	Sektorët Rezidentë									Jorezidentët/ Eurozona									
	Banka qendrore	Bankat e nivelit të dytë	Shoqëritë e kursim kreditit	Fondet e Investimit	Ndërmjetës të tjerë financiarë (përveç shoqërive të sigurimit + Fondet e pensionit vullnetar dhe ndihmës)	Shoqëritë e sigurimit + Fondet e pensionit vullnetar	Qeveria e përgjithshme	Korporata jofinanciare	Individët + institucione tjera që u shërbejnë individëve	Banka qendrore	Bankat e nivelit të dytë	Shoqëritë e kursim kreditit	Fondet e Investimit	Ndërmjetës të tjerë financiarë (përveç shoqërive të sigurimit dhe fondeve të pensionit vullnetar) dhe ndihmës	Shoqëritë e sigurimit + Fondet e pensionit vullnetar	Qeveria e përgjithshme	Korporata jofinanciare	Individët + institucione tjera që u shërbejnë individëve	
DETYRIME																			Jorezidentë të tjerë
Kuota/aksione të fondeve të investimit 1)																			
Emetime																			
Shlyerje																			

1. Të dhëna gjendje/stok, ndryshimet e rivlerësimeve ose transaksionet



SHTOJCA II
PËRSHKRIME

PJESA 1

Përcaktimet e kategorive të instrumenteve

1. Kjo tabelë ofron një përshkrim standard të detajuar të kategorive të instrumenteve. As lista e instrumenteve financiare individuale në tabelë dhe as përshkrimet e tyre përkatëse nuk synojnë të jenë shteruese. Përshkrimet i referohen Sistemit Evropian të Llogarive të krijuar nga Rregullorja (BE) nr. 1073/2013 (më tej “ESA 2010”).

2. Për disa nga kategoritë e instrumenteve kërkohen ndarje të maturitetit. Këto i referohen maturitetit origjinal, pra maturimit në emetim, që

është periudha fikse e jetës së një instrumenti financiar përpara së cilës ai nuk mund të blihet, p.sh. titujt të borxhit.

3. Detyrimet financiare mund të dallohen nëse janë të negociueshme apo jo. Një detyrim është i negociueshëm nëse pronësia e tij është lehtësisht e aftë të transferohet nga një njësi në tjetrën me dorëzim ose nënshkrim ose të kompensohet në rastin e derivateve financiare. Ndërkohë që çdo instrument financiar mund të tregtohet, instrumentet e negociueshme janë krijuar për t'u tregtuar në një bursë të organizuar ose “pa bursë”, megjithëse tregtimi aktual nuk është një kusht i domosdoshëm për negociueshmëri.

Tabela A

**Përshkrimi i kategorive të instrumenteve në aktivet dhe detyrimet fondeve të investimeve
Mjetet**

Kategoritë instrumenteve	Përshkrimi i instrumenteve
1.Cash	Mbajtësit e kartëmonedhave dhe monedhave të huaja në qarkullim, të cilat përdoren gjerësisht për kryerjen e transaksioneve.
2.Depozitat dhe huat	Për qëllime të kësaj forme raportimit, kjo kategori përbëhet nga fondet e dhëna hua nga FI-ve për huamarrësit ose huat e marra nga FI-ve, të cilat ose janë të evidentuara nga dokumente të panegociueshme ose jo të evidentuara me dokumente. Kjo kategori përfshin zërat e mëposhtëm: -depozita njëditore, depozita me afat maturimi të dakordësuar -zotërimet e titujve të panegociueshëm: zotërimet e titujve të borxhit të cilat nuk janë të negociueshme dhe nuk mund të tregtohen në tregjet dytësore -hua të tregtueshme: huat që de facto janë bërë të negociueshme klasifikohen në kategorinë “Depozitat dhe huat”, që nuk ka dëshmi të tregtimit të tregut sekondar. Përndryshe ato klasifikohen si titujve borxhi (kategoria 2), -borxhi i varur në formën e huave: instrumentet e borxhit të varur sigurojnë një pretendim shtesë ndaj institucionit emetues që mund të ushtrohet vetëm pasi të jenë përmbushur të gjitha pretendimet me status më të lartë, duke u dhënë atyre disa nga karakteristikat e kapitalit. Për qëllime statistikore, borxhi i varur klasifikohet si 'hua' ose 'tituj borxhi' sipas natyrës së instrumentit. Kur zotërimet e një FI-ve në të gjitha format e borxhit të varur identifikohen si një shifër e vetme për qëllime statistikore, kjo shifër duhet të klasifikohet nën kategorinë tituj të borxhit', me arsyetimin se borxhi i varur është kryesisht në formën e tituj të borxhit, -pretendimet e marrëveshjeve të riblerjeve repo ose huamarrjen e titujve kundrejt kolateralit në para
3.Tituj të borxhit	Zotërimet e tituj të borxhit, të cilat janë instrumente financiare të negociueshme që shërbejnë si dëshmi e borxhit, zakonisht tregtohen në tregjet dytësore. Ato gjithashtu mund të kompensohen në treg dhe nuk i japin mbajtësit asnjë të drejtë pronësie mbi institucionin emetues. Kjo kategori përfshin: — zotërimet e titujve të cilat i japin mbajtësit të drejtën e pakushtëzuar për një të ardhur fikse ose të përcaktuar me kontratë në formën e pagesave të kuponit dhe/ose një shumë fikse të deklaruar në një datë ose data specifike, ose duke filluar nga një datë e caktuar në koha e emetimit, — kreditë që janë bërë të tregtueshme në një treg të organizuar dytësor. Nëse nuk plotësohet ky kusht, ato duhet të klasifikohen në kategorinë 1 “Depozitat dhe huat” (shih gjithashtu “kredi të tregtueshme” në të gjitha kategoritë), — borxhi i varur në formën e titujve të borxhit (shih gjithashtu 'borxhi i varur në pajisje e huave' në kategorinë 2). Tituj të dhënë hua sipas operacioneve të huadhënies së titujve ose të shitura sipas një marrëveshjeje riblerjeje mbeten në bilancin fillestar të pronarit (dhe nuk regjistrohen në bilancin e blerësit të



	përkohshëm) ku ka një angazhim të vendosur për të anuluar operacionin dhe jo thjesht një opsion për ta bërë këtë. Kur blerësi i përkohshëm shet tituj të marra, kjo shitje duhet të regjistrohet si një transaksion i plotë në tituj dhe të futet në bilancin e blerësit të përkohshëm si një pozicion negativ në portofolin e titujve.
4.Kapitali dhe aksionet në fondet e investimit	Mjetet financiare që përfaqësojnë të drejtat e pronësisë në korporata ose thuajse-korporata. Mjete të tilla financiare përgjithësisht u japin zotëruesve të drejtën për një pjesë në fitimet e korporatave ose kuazikorporatat, dhe për një pjesë në aktivet e tyre neto në rast likuidimi. Kjo kategori përfshin aksione të listuara dhe të palistuar dhe kapitale të tjera si dhe zotërimet e aksioneve ose njësive të emetuara nga fondet e tregut të parasë (FTP) dhe fondet e investimeve joFTP (d.m.th. fondet e investimeve të ndryshme nga FTP). Tituj të kapitalit të dhëna hua në kuadër të operacioneve të huadhënies së titujve ose të shitura sipas një marrëveshjeje riblerjeje, trajtohen në përputhje me rregullat në kategorinë 2 'Tituj të borxhit'
4.a Kapitali dhe aksionet në fondet e investimit/ aksionet e të cilave janë të listuara	Tituj të kapitalit të listuara në bursë. Bursa mund të jetë një bursë e njohur ose çdo formë tjetër e tregut dytësor. Aksionet e listuara quhen gjithashtu aksione të kuotuar.
4.b Kapitali dhe aksionet në fondet e investimit/ kuotat e fondeve të investimit	Ky zë përfshin zotërimet e aksioneve ose njësive të emetuara nga fondet e tregut të parasë (FTP) dhe fondet e investimeve joFTP (d.m.th. fondet e investimeve të ndryshme nga FTP)
(3+4) a nga të cilat tituj (titujt e borxhit, aksionet/ kuotat e fondeve të investimit) të dhëna me hua ose të shitura sipas marrëveshjeve të riblerjes	Ky zë përfshin ata tituj, të raportuara sipas kategorive 2 (tituj të borxhit) dhe 3 (aksionet/njësitë e kapitalit dhe fondeve të investimit), të cilat janë dhënë hua sipas operacioneve të huadhënies së titujve ose janë shitur sipas marrëveshjeve të riblerjes (ose çdo lloj operacioni tjetër të ngjashëm, si p.sh. transaksionet e shitjes dhe blerjes)
5.Derivatet financiare	Derivatet financiare janë instrumente financiare të lidhura me një instrument financiar të caktuar, tregues ose mall, nëpërmjet të cilit rreziqet financiare specifike mund të tregtohen në tregjet financiare më vete. Kjo kategori përfshin: — opsionet, — garancitë, — kontratat e së ardhmes, — transfertat, — shkëmbimet, — derivativët e kredisë. Derivatet financiare regjistrohen me vlerën e tregut në bilanc në bazë bruto. Kontratat individuale derivate me vlera pozitive tregu regjistrohen në anën e mjeteve të bilancit dhe kontratat me vlera negative të tregut në anën e detyrimeve të bilancit. Angazhimet bruto të ardhshme që rrjedhin nga kontratat derivate nuk duhet të futen si zëra në bilanc. Derivatet financiare mund të regjistrohen në bazë neto sipas metodave të ndryshme të vlerësimit. Në rast se vetëm pozicionet neto janë të disponueshme, ose pozicionet regjistrohen ndryshe nga vlera e tregut, këto pozicione raportohen në vend të tyre.
6.Llogari të tjera të arkëtueshme/ pagueshme	Ky është zëri i mbetur në anën e të tjerëve, që është aktiv në shoqërinë e “pasuri që nuk merr pjesë”. BSH-të mund të raportojnë e nën-pozicioneve të veçanta të përfshira në këto kategori, të tilla si: — dividendët e arkëtueshëm, — interesi i akumuluar i arkëtueshëm nga depozitat, — interesi i përlllogaritur i arkëtueshëm nga huat, — interesi i përlllogaritur i arkëtueshëm për titujt e borxhit, — qiraja e përlllogaritur e arkëtueshme, — shumat e arkëtueshme të cilat nuk kanë të bëjnë me biznesin kryesor të FI.
7.Mjete të tjera jofinanciare	Mjete të qëndrueshme dhe të paqëndrueshme, të ndryshme nga mjetet financiare. Kjo kategori përfshin, ndërtesat dhe pajisjet e tjera, makineritë, produktet e pronësisë intelektuale si softuerët kompjuterikë dhe bazat e të dhënave.

**Detyrimet**

Kategoritë e instrumenteve	Përshkrimi i instrumenteve
8.Hua të marra	Shumat e borxhit ndaj kreditorëve nga FI, përveç atyre që dalin nga emetimi i titujve të negociueshme. Kjo kategori përbëhet nga: — kreditë: huatë e dhëna FI-ve të cilat ose janë të evidentuara me dokumente të panegociueshme ose të padëshmuara me dokumente, — marrëveshjet e riblerjes repo dhe titujve kundrejt kolateralit në para. —kolaterali në para i marre në këmbim të titujve të huazuara: — kolaterali në para i marre në operacionet që përfshijnë transferimin e përkohshëm të arit kundrejt kolateralit.
9.Titujve të borxhit të emetuara	Tituj të emetuara nga FI, përveç kapitalit, që zakonisht janë instrumente të negociueshme dhe tregtohen në tregje dytësore, ose që mund të kompensohen në treg dhe nuk i japin mbajtësit asnjë të drejtë pronësie në lidhje me institucionin emetues.
10.Derivatet financiare	Shiko kategorinë 4.
11.Llogari të arketueshme/pagueshme	Ky është zëri i mbetur në anën tjetër të bilancit, i përcaktuar si 'detyrime të papërfshira diku tjetër', të tilla si: — shumat e pagueshme që nuk lidhen me biznesin kryesor të FI-ve, d.m.th. shumat që detyrohen furnitorëve, taksave, pagave, sociale etj. pensionet, dividendët etj., — pozicionet e neto që rrjedhin nga huadhënia e titujve me vlerën e pakolateralit në para, — shumat neto të pagueshme në lidhje me shlyerjet e tyre, të cilat kanë vlerë në tituj, — interesi i përllogaritur i pagueshëm për huat.

PJESA 2**Përshkrimet e attributeve të raportimit “titull për titull”****Tabela B**

Kategoria	Përshkrimi
1.ISIN	Kodi ISIN përfaqëson një numër identifikues të veçantë për çdo titull
2.Emri i titujve	Emri i titujve përfaqëson emrin e titullit që raportohet, ashtu siç është specifikuar në kontratë.)
3.Tipi i instrumentit	Tipi i instrumentit përfaqëson tipin e titullit, si tituj kapitali-aksione më pak se 10%, obligacione dhe dëftesa, bono thesari, derivativë financiarë etj.
4.Listimi në bursë	Listimi në bursë tregon nëse titulli është e listuar apo jo në një treg të organizuar titujve, bursë.
5.Klasa e instrumentit	Klasa e instrumentit tregon nëse titulli është e tregtueshme, e vendosjes apo e investimit.)
6.Data e emetimit	Data e emetimit përfaqëson datën kur instrumenti është emetuar për herë të parë.
7.Data e blerjes	Data e blerjes përfaqëson datën kur subjekti raportues ka blerë instrumentin
8.Data e maturimit	Data e maturimit përfaqëson datën kur instrumenti është maturuar
9.Emri i emetuesit	Emri i emetuesit tregon emrin e subjektit që ka emetuar titullin.
10.Sektori i emetuesit	Sektori institucional sipas kategorive të përcaktuara në ESA.
11.Rezidenca e emetuesit	Rezidenca e emetuesit tregon shtetin e rezidencës së subjektit që ka emetuar titullin.
12.Emri i zotëruesit	Emri i zotëruesit tregon emrin e subjektit që zotëron titullin.
13.Sektori i zotëruesit të titullit	Sektori institucional sipas kategorive të përcaktuara në ESA.
14.Monedha	Monedha tregon monedhën origjinale në të cilën titulli është emetuar dhe në të cilën shlyhet apo ripaguhet.
15.Transaksioni	Transaksioni gjatë periudhës tregon blerjen ose shitjen e titullit gjatë periudhës.
16.Vlera e tregut në fund të periudhës	Vlera e tregut në fund të periudhës përfaqëson vlerën e tregut të stokut të titullit në fund të periudhës.
17.Vlera kontabile në fund të periudhës	Vlera kontabile në fund të periudhës përfaqëson vlerën kontabile të stokut të titullit në fund të periudhës.
18.Interesi i përllogaritur në fund të periudhës	Interesi i përllogaritur në fund të periudhës përfaqëson interesin e përllogaritur për tituj të borxhit: obligacione dhe dëftesa, bono thesari etj.
19.Dividendi i paguar	Dividendi i paguar përfaqëson dividendin që paguhet për tituj të tipit “aksione më pak se 10% e kapitalit”.
20.Interesi i përllogaritur gjatë periudhës	Interesi i përllogaritur gjatë periudhës përfaqëson pjesën e interesit që përllogaritet vetëm për atë periudhë (fluksi). Kjo vlerë llogaritet si diferenca e stoqeve të interesit të dy periudhave të njëpasnjëshme minus interesin e paguar. Vlera është gjithmonë pozitive dhe kërkohet për tituj të borxhit.
21.Interesi i paguar	Interesi i paguar përfaqëson interesin e paguar për tituj të borxhit: obligacione dhe dëftesa, bono thesari etj.



PJESA 3 Përshkrimet sipas sektorëve

ESA 2010 ofron standardin për klasifikimin e sektorëve institucionalë. Tabela C jep një përshkrim të detajuar të sektorëve subjektet raportuese duhet

të përdorin në klasifikimet e tyre kombëtare në përputhje me këtë rregullore. Kundërpartite rezidentë identifikohen sipas sektorit të tyre në përputhje me listat e publikuara nga BSH-ja dhe INSTAT-i për qëllime statistikore

Tabela C

Sektori	Përshkrimi
1. <i>Qeveria qendrore</i>	Përfshin të gjitha departamentet administrative të shtetit dhe agjencitë qendrore kompetencat e të cilave shtrihen mbi të gjithë territorin ekonomik të vendit. Të tilla janë ministrat dhe administrata publike qendrore, organizatat jo me qëllim fitimi të kontrolluara nga qeveria
2. <i>Qeveria lokale</i>	përfshin bashkitë dhe pushtetin lokal. Të përfshira në këtë nënsektor janë gjithashtu, ato institucione jofitimprurëse, të cilat janë të kontrolluara nga pushteti vendor dhe që ushtrojnë aktivitetin e tyre vetëm brenda territorit ekonomik të qeverisë lokale.
3. <i>Fondet e sigurimeve shoqërore</i>	përfshin njësitë institucionale qendrore dhe lokale aktiviteti kryesor i të cilave është të sigurojë përfitime sociale dhe plotësojnë këto kriterë: a) me ligj ose me rregullore, grupe të caktuara të popullsisë janë të detyruara të marrin pjesë në skema ose të paguajnë kontributet ; dhe b) qeveria e përgjithshme është përgjegjëse për menaxhimin e institucionit në lidhje me zgjidhjen ose miratimin e kontributeve dhe përfitimeve në mënyrë të pavarur nga roli i tij si organ mbikëqyrës ose punëdhënës.
4. <i>Banka qendrore</i>	funksioni kryesor i saj është që të emetojë monedhën, të ruajë vlerën e brendshme dhe të jashtme të monedhës si dhe të mbajë të gjitha ose një pjesë të rezervave ndërkombëtare të vendit.
5. <i>Banka</i>	të gjitha subjektet që ushtrojnë veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë në bazë të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë.
6. <i>Shoqëritë e kursim kreditit</i>	janë institucione jo me qëllim fitimi, të cilat organizohen si bashkime vullnetare të personave juridikë ose fizikë. Ato mbledhin fonde nga anëtarët e tyre dhe u japin kredi vetëm anëtarëve të tyre. Veprimtaria e tyre rregullohet nga ligji “Për Shoqëritë e Kursim Kreditit” nr. 8782, date 03.05.2001 dhe nga rregulloret e Bankës së Shqipërisë.
7. <i>Fondet e investimeve</i>	të cilat njihen edhe si fonde të përbashkëta ose institucione për investim kolektiv përfshin të gjitha skemat e investimeve kolektive të angazhuara në ndërmjetësim financiar. Aktiviteti i tyre është të emetojë aksione dhe kuota të fondeve të investimit, të cilat mund të jenë ose jo zëvendësues të afërt të depozitave, dhe bëjnë investime në mjete financiare afatshkurtra dhe afatgjata dhe në aktive jofinanciare (zakonisht në pasuri të patundshme). Në Shqipëri këto institucione operojnë në përputhje me ligjin nr. 10 198, datë 10.12.2009 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”. Shoqëritë administruese të fondeve të investimit nuk klasifikohen në këtë sektor, por klasifikohen si “Ndërmjetës të tjerë financiarë dhe ndihmësit financiarë”.
8. <i>Ndërmjetës të tjerë financiarë (përveç shoqërive të sigurimit dhe fondeve të pensionit vullnetar) dhe ndihmësit financiarë</i>	– përfshin të gjitha institucionet e tjera që kryejnë ndërmjetësim financiar apo lehtësojnë ndërmjetësimin financiar (përfshijë kompanitë e sigurimit dhe fondet e pensionit) të tillë si, institucionet e kreditit, institucionet që ofrojnë qiranë financiare (leasing), institucionet e financimit të transaksioneve tregtare, institucionet e mikrokreditit, faktoringut, të gjitha shërbimet e pagesave dhe transferimit të parave, unionet e Shoqërive të Kursim Kreditit, shoqëritë administruese të fondeve të investimit dhe të fondeve të pensionit vullnetar et.
9. <i>Shoqëritë e sigurimit</i>	- ofrojnë shërbimet e sigurimit të jetës dhe jojetës për individë dhe kompani, si edhe risigurimin e kompanive të tjera të sigurimit. Këto kompani u sigurojnë përfitime financiare klientëve dhe personave të mbijetuar në raste aksidentesh, sëmundjesh, vdekjesh, katastrofash natyrore etj. Kompanitë e sigurimit financiar ose të sigurimit të kredisë sigurojnë mbulimin e riskut të humbjes financiare nga mos pagesat e ndryshme të kredisë etj.
10. <i>Fondet e pensionit vullnetar</i>	- përfshin të gjitha kompanitë, të cilat janë të angazhuara kryesisht në ndërmjetësim financiar si pasojë e grupimit të rreziqeve sociale dhe të nevojave të personave të siguruar. Fondet e pensioneve ashtu si skema e sigurimeve shoqërore, sigurojnë të ardhura pas daljes në pension dhe përfitime në raste paafësie dhe vdekje. Në këtë nënsektor përfshihen vetëm fondet e pensioneve të cilat janë njësi institucionale të ndara nga kompanitë që i krijojnë ato. Të tilla fonde autonome kanë autonominë e vendimmarrjes dhe mbajnë një grup të plotë të llogarive, përfshirë bilancin kontabël. Pjesëmarrja në këto fonde është vullnetare dhe nuk përjashton detyrimin e personave për t'u siguruar sipas dispozitave ligjore në fuqi.
11. <i>Korporatat jofinanciare</i>	- janë korporata jofinanciare rezidente, thuajse korporata dhe institucione jo me qëllim fitimi, të



<i>publike</i>	angazhuara në prodhim tregu, që kontrollohen dhe financohen kryesisht nga qeveria. Kontrolli mund të ushtrohet nga zotërimi i më tepër se gjysmës së të drejtave votuese ose nëpërmjet ligjit, me dekrete ose me rregullore, të cilat vendosin politikën nëpërmjet të cilës qeveria mund të emëtojë drejtuesit. Këtu përjashtohen institucionet jo me qëllim fitimi, të cilat nuk angazhohen në prodhim tregu.
12. Korporatat jofinanciare private	– përfshijnë të gjitha njësitë institucionale, të cilat janë subjekte juridike të pavarura të krijuara me qëllim prodhimin e mallrave dhe shërbimeve jofinanciare për tregun dhe që nuk kontrollohen nga qeveria. Këtu përfshihen korporatat jofinanciare rezidente, thuajsekorporatat dhe institucione jo me qëllim fitimi të angazhuara në prodhimin e mallrave dhe shërbimeve për tregun. Thuajsekorporatat janë ndërmarrje joaksionere, të cilat funksionojnë si korporata. Që një thuajse korporatë të ekzistojë, ajo duhet të jetë e aftë të krijojë një plan të plotë llogarish, duke përfshirë bilancin kontabël, për të dalluar thuajsekorporatën nga pronarët e saj. Mjetet dhe detyrimet e lidhura me biznesin të thuajsekorporatës duhen ndarë nga mjetet dhe detyrimet e pronarëve. Gjithashtu, duhet të jetë i mundur identifikimi i flukseve të kapitalit dhe të të ardhurave që shkaktohen midis thuajsekorporatës dhe pronarëve të saj. Praktikisht, në nënsektorin e korporatave jofinanciare do të klasifikohen të gjitha shoqëritë tregtare private (jofinanciare) ose bizneset private të cilat ushtrojnë aktivitetin e tyre në përputhje me ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”. Përfashtim bëjnë vetëm personat fizikë të cilët ushtrojnë aktivitetin e tyre në përputhje me nenin 1 të ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe që do të klasifikohen në sektorin “Individët” (ekonomitë familjare).
13. Individët (Ekonomitë familjare)	- përbëhet nga individë dhe grupe individësh, të cilët janë kryesisht konsumatorë. Ata ndajnë të njëjtën banesë, mbledhin një pjesë ose të gjitha të ardhurat dhe konsumojnë kolektivisht mallrat dhe shërbimet. Ky sektor përbëhet, gjithashtu, nga individë ose grupe individësh, të cilët janë sipërmarrës, pra janë të angazhuar edhe në aktivitet ekonomik, për shitje në treg ose për konsumin e vetë ekonomisë familjare, me kusht që prodhimi i mallrave dhe shërbimeve nuk realizohet nëpërmjet njërive ekonomike të ndara të trajtuara si thuajse-korporata. Aktivitetet prodhuese të integruara në sektorin e ekonomive familjare, quhen ndërmarrje të patrupëzuara. Ato angazhohen në biznes nëpërmjet punës, kapitalit fizik dhe burimeve financiare të ekonomisë familjare. Gjithashtu, ato mund të marrin hua për të financuar aktivitetet prodhuese. Kapitali fizik dhe mjetet financiare të përdorura nga ndërmarrjet e patrupëzuara, i përkasin ekonomisë familjare, e cila është plotësisht përgjegjëse për huan dhe për detyrimet në lidhje me të. Ky biznes, nuk mund të angazhohet në transaksione me njësi të tjera për llogari të tij dhe nuk mund të zotërojë mjete apo të marrë përsipër detyrime në emër të tij. Sektori i ekonomive familjare përfshin: - individë ose grupe anëtarësh funksioni kryesor i të cilëve është konsumi; - personat që jetojnë në mënyrë të përhershme në institucione që kanë pak ose aspak autonominë e veprimit ose vendimit në çështjet ekonomike (p.sh. anëtarët e sekteve fetare që jetojnë në manastire, personat e moshuar që jetojnë në mënyrë të përhershme në shtëpitë e të moshuarve (azile) etj. - individë ose grupe anëtarësh funksioni kryesor i të cilëve është konsumi dhe që prodhojnë mallra dhe shërbime për përdorim final ekskluzivisht vetjak; - pronësitë personale dhe bashkëpronësitë pa status juridik, (përveç atyre të cilat trajtohen si thuajsekorporata dhe të cilat janë prodhues tregu). Të tillë do të konsiderohen personat fizikë të cilët kryejnë aktivitet tregtar në përputhje me nenin 1, ligji nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”. - institucionet jofitimprurëse që i shërbejnë ekonomive familjare, të cilat nuk kanë status të pavarur juridik.
14. Institucionet jo me qëllim fitimi në shërbim të individëve	- përfshin institucionet jo me qëllim fitimi të cilat janë njësi ligjore të pavarura, u shërbejnë ekonomive familjare dhe janë prodhues privat që nuk prodhojnë për tregun. Institucionet jo me qëllim fitimi, të angazhuar në prodhim, por jo për tregun, i sigurojnë ekonomive familjare mallra dhe shërbime falas, ose me çmime që nuk janë ekonomikisht domethënëse. Ato financohen kryesisht nga kontributet vullnetare, nga kuotat e anëtarëve, pagesat e bëra nga qeveria e përgjithshme apo nga fitimet që rrjedhin nga mbajtja e mjeteve financiare ose jofinanciare. Llojet kryesore të institucioneve jo me qëllim fitimi në shërbim të ekonomive familjare janë: - sindikatat, shoqatat profesionale, shoqatat e konsumatorëve, partitë politike, kisha apo shoqëritë fetare (duke përfshirë edhe ato të financuara, por jo të kontrolluara nga qeveria) dhe klubet sociale, kulturore, sportive etj.; dhe - organizatat bamirëse, mbështetëse dhe të ndihmës, të financuara nga transfertat vullnetare në para (cash) ose në natyrë nga njësi të tjera institucionale. Institucionet jo me qëllim fitimi në shërbim të ekonomive familjare jo për tregun, të kontrolluara nga qeveria e përgjithshme klasifikohen në sektorin e qeverisë. Institucionet jo me qëllim fitimi, të cilat janë nën kontrollin e qeverisë klasifikohen në sektorin e qeverisë që i kontrollon ato.



PJESA 4

**Përshkrimet e transaksioneve financiare
dhe ndryshimet nga rivlerësimi**

1. “Transaksionet financiare” u referohen atyre transaksioneve që lindin nga krijimi, likuidimi ose ndryshimi i pronësisë së mjeteve ose detyrimeve financiare. Këto transaksione përlogariten si diferencë midis pozicioneve stok të periudhës së referencës, nga të cilat zbriten efektet e ndryshimeve që rezultojnë “Rivlerësimi” (si pasojë e ndryshimeve të çmimeve dhe kursit të këmbimit) dhe “riklasifikimeve të tjera”. Banka e Shqipërisë kërkon informacion statistikor me qëllim të përpilimit të të dhënave për transaksionet financiare në formën e ndryshimeve që përfshijnë 'riklasifikime dhe ndryshimeve të tjera' si dhe 'rivlerësimet të çmimeve dhe kursit të këmbimit'.

2. 'Ndryshimet e rivlerësimit' i referohet ndryshimeve në vlerësimin e mjeteve dhe detyrimeve që rrjedhin nga ndryshimet në çmimin e mjeteve dhe detyrimeve dhe/ose efekti i kursit të këmbimit të mjeteve dhe detyrimeve të shprehura në monedhe e huaj. Rivlerësimet e çmimeve përfshijnë ndryshimet që ndodhin me kalimin e kohës në vlerën e stoqeve në ditën e fundit të periudhës së referencës, për shkak të ndryshimeve në vlerën e referencës në të cilën ato regjistrohen, d.m.th. fitimet/humbjet e mbajtjes. Lëvizjet në kurset e këmbimit kundrejt monedhës vendëse (lek) që ndodhin ndërmjet datave të raportimit në fund të periudhës sjellin ndryshime në vlerën e mjeteve/detyrimeve në valutë të huaj kur shprehen në lek. Duke qenë se këto ndryshime përfaqësojnë fitime/humbje të mbajtjes dhe nuk janë pasojë e transaksioneve financiare, *këto efekte duhet të hiqen nga të dhënat e transaksioneve.*

3. 'Zhvlerësimet/fshirjet' i referohen uljes së vlerës së një kredie të regjistruar në bilanc, ku kredia konsiderohet të jetë një aktiv pa vlerë (zhvlerësim) ose kur mendohet se kredia do të të mos rikuperohet plotësisht (fshirje). Përfshihen gjithashtu zhvlerësimet/fshirjet e njohura në momentin kur një kredi shitet ose transferohet te një palë e tretë, aty ku janë të identifikueshme.

SHTOJCA III

**STANDARDET MINIMALE QË DUHET
TË PËRMBUSHË POPULLATA E
SUBJEKTEVE RAPORTUESE**

Subjektet raportuese duhet të përmbushin standardet minimale të mëposhtme për të përmbushur kërkesat e raportimit statistikor të Bankës së Shqipërisë.

1. Standardet minimale për tejçimin/ përcjelljen e informacionit:

a) raportimi duhet të jetë në kohë dhe brenda afateve të përcaktuara nga Banka;

b) raportet statistikore duhet të jenë në përputhje me formën dhe formatin e tyre nga kërkesat e raportimit teknik të përcaktuara nga Banka;

c) subjekti raportues duhet t'i japë Bankës të dhënat e një ose më shumë personave kontaktues;

d) duhet të ndiqen specifikimet teknike për transmetimin e të dhënave në Bankën e Shqipërisë.

2. Standardet minimale për saktësinë:

a) informacioni statistikor duhet të jetë i saktë: të gjitha kufizimet paralele/ rregullat e kontrollit duhet të përmbushen (p.sh. mjetet dhe detyrimet duhet të balancohen, nëntotale duhet të mbliidhen në total) dhe të dhënat duhet të jenë të qëndrueshme në të gjitha frekuencat e raportimit;

b) subjektet raportuese duhet të jenë në gjendje të japin informacion mbi zhvillimet që tregojnë të dhënat e dërguara;

c) informacioni statistikor duhet të jetë i plotë dhe nuk duhet të përmbajë boshllëqe të vazhdueshme dhe strukturore. Mangësitë ekzistuese duhet të njihen, t'i shpjegohen Bankës qendrore dhe, kur është e aplikueshme, të kapërcehen sa më shpejt që të jetë e mundur;

d) subjektet raportuese duhet të ndjekin dimensionet, politikën e rrumbullakosjes dhe numrat dhjetorë të vendosur nga Bankat për përcjelljen teknike të të dhënave.

3. Standardet minimale për përputhshmërinë me konceptet:

a) informacioni statistikor duhet të jetë në përputhje me përkufizimet dhe klasifikimet e përfshira në këtë rregullore;

b) në rast të devijimeve nga këto përkufizime dhe klasifikime, subjektet raportuese duhet të monitorojnë dhe të përcaktojnë në mënyrë të rregullt diferencën ndërmjet metodologjisë së



përdorur dhe asaj që përcakton kjo rregullore;

c) subjektet raportuese duhet të jenë në gjendje të shpjegojnë ndryshimet/ thyerjet në të dhënat e përcjella më parë/ transmetuara krahasuar me shifrat e periudhave të mëparshme.

4. Standardet minimale për rishikime: duhet të ndiqen politikat dhe procedurat e rishikimeve të përcaktuara nga Banka e Shqipërisë. Rishikimet që devijojnë nga rishikimet e rregullta duhet të shoqërohen me shënime shpjeguese të detajuara.

VENDIM

Nr. 64, datë 21.12.2022

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR RAPORTIMIN STATISTIKOR TË MJETEVE DHE DETYRIMEVE TË FONDEVE TË PENSIONIT”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; si dhe të ligjit nr. 30/2022, “Për miratimin e programit të statistikave zyrtare 2022–2026”, me propozimin e Departamentit të Statistikave Financiare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren “Për raportimin statistikor të mjeteve dhe detyrimeve të фондеве të pensionit”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet Departamenti i Statistikave Financiare të Bankës së Shqipërisë, për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR
Gent Sejko**

RREGULLORE

PËR RAPORTIMIN STATISTIKOR TË MJETEVE DHE DETYRIMEVE TË FONDEVE TË PENSIONIT

Neni 1

Objekti dhe fusha e veprimit

Rregullorja përcakton kërkesat e raportimit në lidhje me informacionin statistikor të mjeteve dhe detyrimeve të фондеве të pensionit që ushtrojnë aktivitet në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 2

Baza ligjore

Kjo rregullore nxirret në mbështetje të:

- a) nenit 26, pika 1, të ligjit nr. 17/2018, “Për statistikave zyrtare”;
- b) ligjit nr. 30/2022, “Për miratimin e programit të statistikave zyrtare 2022–2026”.

Neni 3

Përcaktime

Për qëllime të kësaj rregulloreje:

- 1. “fond pensioni (FP) ka të njëjtin kuptim siç përcaktohet në nenin 5, pika 1, të ligjit nr. 10197, datë 10.12.2009, “Për fondet e pensionit vullnetar”.

Më poshtë nuk përfshihen në përkufizim:

- a) “fondet e investimeve” (FI), siç përcaktohet në nenin 2, pika 23, të ligjit nr. 56/2020, datë 30.4.2020, “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”;

- b) “entitet me qëllim të posaçëm” (SPV) të përfshira në transaksionet e titullzimit, siç përcaktohet në nenin 4, pika 2, paragrafi 43, të rregullores nr. 48/2013 “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”;

- c) “institucionet financiare monetare” (IMF), siç përcaktohet në nenin 3, pika 2, të rregullores nr. 73/2021 të Bankës së Shqipërisë “Mbi raportimet në Bankën e Shqipërisë të zërave të bilancit të institucioneve të kreditit dhe të institucioneve monetare financiare”;

- d) “shoqëritë e sigurimit”, siç përcaktohet në nenin 4, pika 43, të ligjit nr. 52, datë 22.5.2014, “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”;

- e) “fondet e pensioneve jo autonome”, që janë фонде pensioni të cilat nuk janë njësi institucionale



dhe mbeten pjesë e njësisë institucionale që i ka krijuar,

f) fondet e sigurimeve shoqërore përfshijnë njësitë institucionale qendrore dhe lokale aktiviteti kryesor i të cilave është të sigurojnë përfitime sociale dhe plotësojnë këto kritere:

- me ligj ose me rregullore, grupe të caktuara të popullsisë janë të detyruara të marrin pjesë në skema ose të paguajnë kontributet, dhe

- qeveria e përgjithshme është përgjegjëse për menaxhimin e institucionit në lidhje me zgjidhjen ose miratimin e kontributeve dhe përfitimeve, në mënyrë të pavarur nga roli i tij si organ mbikëqyrës ose punëdhënës;

2. “rezident” ka të njëjtin kuptim siç përcaktohet në nenin 3, pika 7, të rregullores nr. 73/2021 të Bankës së Shqipërisë “Mbi raportimet në Bankën e Shqipërisë të zërave të bilancit të institucioneve të kreditit dhe të institucioneve monetare financiare”;

3. “administrator” ka të njëjtin kuptim sipas përcaktimeve në nenin 4, shkronja “c”, të ligjit nr. 10197, datë 10.12.2009, “Për fondet e pensionit vullnetar”;

4. “të dhëna titull-për-titull” nënkupton të dhënat individuale për titujt;

5. “të dhëna zë-për-zë” nënkupton të dhënat e ndara në mjete ose detyrime individuale;

6. “të dhëna të përmbledhura” do të thotë të dhëna që nuk janë zbërthyer në mjete ose detyrime individuale;

7. “transaksion financiar” nënkupton një transaksion që rrjedh nga krijimi, likuidimi ose ndryshimi i pronësisë së mjeteve ose detyrimeve financiare, siç përshkruhet më tej në pjesën 5 të shtojcë II;

8. “ndryshime nga rivlerësimi” do të thotë ndryshime në vlerën e mjeteve dhe detyrimeve që rrjedhin nga ndryshimet në çmim /ose efekti i kursit të këmbimit të mjeteve dhe detyrimeve të shprehura në një monedhë të huaj, siç përshkruhet më tej në pjesën 5 të shtojcës II.

Neni 4

Popullata aktuale raportuese

1. Popullsia aktuale raportuese përbëhet nga shoqëritë administruese të fondeve të pensioneve të licencuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF).

2. Popullata aktuale raportuese do të nënshtrohet kërkesave të plota të raportimit statistikor.

Neni 5

Lista e fondeve të pensionit për qëllime statistikore

1. Banka e Shqipërisë (BSH) harton dhe përditëson listën e fondeve të pensionit (FP) që formojnë popullsinë aktuale raportuese, bazuar në informacionin statistikor të regjistruar nga AMF-ja.

2. BSH-ja publikon në faqen zyrtare të saj listën e përditësuar të FP-ve, dhe datën më të fundit të përditësimit.

Neni 6

Kërkesat e raportimit statistikor

1. Popullata raportuese raporton nëpërmjet AMF-së, në përputhje me marrëveshjen e bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve, informacionin e kërkuar në përputhje me shtojcat I dhe II, pjesë përbërëse dhe bashkëlidhur e kësaj rregulloreje:

- a) me bazë tremujore, të dhënat e stokut tremujor mbi aktivet/pasivet e FP-ve dhe rregullimet tremujore të rivlerësimit ose transaksionet financiare në lidhje me aktivet/pasivet, kur është e aplikueshme;

- b) më bazë vjetore, të dhënat e fundvitit për numrin e anëtarëve të fondeve të pensionit të ndara në anëtarë aktivë, anëtarë pasive dhe anëtarë në pension.

2. BSH-ja përllogarit vlerësime tremujore për informacionin statistikor të FP-ve bazuar në të dhënat e ofruara në baza vjetore nga subjektet raportuese, në përputhje me nenin 6/1/b.

3. BSH-ja informon popullatën raportuese për qëllimet e ndryshme për të cilat janë mbledhur të dhënat e tyre.

4. Për të minimizuar barrën e raportimit të popullatës raportuese, BSH-ja do të kombinojë kërkesat e raportimit për qëllime të kësaj rregulloreje me të dhënat që mbledh AMF-ja.



Neni 7

Rregullimet e rivlerësimit dhe transaksionet financiare

1. Informacioni për ndryshimet nga rivlerësimi dhe transaksionet financiare do të merret si më poshtë:

a) popullata raportuese do të raportojë ndryshimet nga rivlerësimi ose transaksionet financiare, në përputhje me udhëzimet përkatëse të BSH-së, për informacionin e raportuar, sipas shtojcë II dhe III;

b) BSH-ja do të nxjerrë përafrime të vlerës së transaksioneve të titujve nga të dhënat titull-përtitull ose do të mbledhë drejtpërdrejt të dhëna për transaksione të tilla nga popullata raportuese. BSH-ja mund të ndjekë gjithashtu një qasje të ngjashme për aktivet e tjera përveç titujve kur mbledhin të dhëna zë-për-zë;

c) në rastin e përfitimeve të pensioneve të dhëna nga FP-të, përafrimet e vlerës së transaksioneve financiare do të nxirren:

i. nga popullata raportuese, në përputhje me udhëzimet përkatëse të BSH-së në shtojcat bashkëlidhur kësaj rregulloreje,

ii. nga BSH-ja, bazuar në të dhënat e ofruara nga subjektet raportuese.

2. Udhëzime të mëtejshme në lidhje me hartimin e ndryshimeve nga rivlerësimi dhe transaksioneve financiare përcaktohen në shtojcën II, pjesa 4.

Neni 8

Parimet kontabël për qëllim të raportimit statistikor

1. Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë rregullore, rregullat e kontabilitetit të ndjekura nga FP-të për qëllime të raportimit sipas kësaj rregulloreje do të jenë ato të përcaktuara në rregullat e kontabilitetit kombëtar dhe standardet ndërkombëtare përkatëse.

2. Fshirjet dhe zhvlerësimet e përcaktuara nga praktikat përkatëse të kontabilitetit do të përjashtohen nga shuma e principalit të papaguar të huave dhe do të raportohen veçmas.

3. Pa cenuar praktikat kontabël dhe marrëveshjet e netimit që mbizotërojnë në territorin e Shqipërisë, të gjitha aktivet dhe detyrimet financiare do të raportohen në bazë bruto për qëllime statistikore.

Neni 9

Afati i raportimit

1. Popullata raportuese raporton të dhënat e kërkuara tremujore, jo më vonë se 45 ditë pas fundit të periudhës së referencës.

2. Popullata raportuese raporton të dhënat e kërkuara vjetore, jo më vonë se 70 ditë pas periudhës së referencës.

Neni 10

Standardet minimale dhe rregullat kombëtare të raportimit

1. Popullata raportuese duhet të përmbushë kërkesat e raportimit statistikor të cilave u nënshtrohen, në përputhje me standardet minimale për transmetimin, saktësinë, përputhshmërinë me konceptet e përcaktuara në shtojcën III.

2. BSH-ja përkufizon dhe zbaton rregullat e raportimit që ndiqen nga popullata raportuese aktuale, në përputhje me kërkesat kombëtare. Këto rregulla të raportimit mundësojnë identifikimin e të dhënave të duhura statistikore dhe lejojnë që përmbushja e standardeve minimale rreth transmetimit të informacionit, saktësisë, përputhshmërisë me konceptet e përcaktuara në shtojcën III, të sigurohet në vijimësi.

Neni 11

Bashkimet me përthithje, ndarjet dhe riorganizimet

Në rast të një bashkimi me përthithje, ndarjeje ose riorganizimi që mund të ndikojë në përmbushjen e detyrimeve statistikore, çdo subjekt raportues i interesuar duhet të informojë AMF-në sapo të jetë publikuar synimi për të zbatuar një operacion të tillë dhe brenda një kohe të arsyeshme përpara se të hyjnë në fuqi procedurat që janë planifikuar për të përmbushur kërkesat e raportimit statistikor të përcaktuara në këtë rregullore.

Neni 12

Mbledhja e të dhënave

BSH-ja bashkëpunon me AMF-në për mbledhjen nga popullata raportuese të të dhënave të parashikuara në këtë rregullore, nëpërmjet lidhjes së një marrëveshjeje bashkëpunimi midis dy institucioneve.



Neni 13

Raportimi i parë

Raportimi i parë do të fillojë me të dhënat tremujore për tremujorin 4-t të vitit 2023 dhe të dhënat vjetore për vitin 2023.

Neni 14

Dispozitë e fundit

Shtojcat I, II dhe III bashkëlidhur kësaj rregulloreje janë pjesë përbërëse e saj.

KRYETAR I KËSHILLIT MBIKËQYRËS
Gent Sejko

SHTOJCA I
KËRKESAT PËR RAPORTIM
STATISTIKOR

PJESA 1
KËRKESAT E PËRGJITHSHME TË
RAPORTIMIT STATISTIKOR

1. Popullata aktuale raportuese duhet të sigurojë informacionin statistikor të mëposhtëm, në baza tremujore:

- a) të dhëna për titujt me kode ISIN;
- b) të dhënat për titujt pa kode ISIN, qoftë sipas raportimit titull-për-titull ose të përmbledhura, të ndara sipas kategorive të instrumentit, maturitetit dhe kundërpartisë;
- c) të dhëna për mjetet dhe detyrimet e ndryshme nga titujt, të ndara sipas kategorive të

instrumentit, maturitetit dhe kundërpartisë.

2. Të dhënat e përmbledhura duhet të jepen në terma të stoqeve dhe, në përputhje me udhëzimet e BSH-së për sa i përket: a) rivlerësimeve për shkak të ndryshimeve të çmimeve dhe kursit të këmbimit; ose b) transaksionet financiare.

3. Standardi i raportimit për dhënat që duhet të jepen sipas formatit titull-për-titull specifikohen në tabelën 2. Kërkesat e agreguara të raportimit statistikor tremujor për stoqet dhe për rivlerësimet për shkak të ndryshimeve të çmimeve dhe kursit të këmbimit ose transaksioneve financiare, janë të specifikuara në tabelat 1a dhe 1b. Të dhënat vjetore që duhen dhënë në lidhje me numrin e anëtarëve të skemave pensionale janë të specifikuara në tabelën 3.

PJESA 2

Rezervat e fondit të pensionit

1. Sa i përket rezervave të fondit të pensionit, për kërkesat e raportimit të listuara më poshtë, subjektet raportuese duhet të kryejnë vlerësime nëse të dhënat nuk janë të disponueshme direkt, në përputhje me udhëzimet e përcaktuara nga BSH-ja dhe bazuar në praktikat më të mira evropiane:

- të drejtat e pensionit të ndara sipas skemave të kontributeve dhe përfitimeve të përcaktuara,
- ndryshimet nga rivlerësimi (përfshirë ndryshimet nga luhatja e kursit të këmbimit) ose transaksionet financiare për të gjitha ndarjet e kërkuara siç tregohet në tabelën 1b.



PJESA 3 TABELAT E RAPORTIMIT
TABELA 1A/B

Bilanci

Stoqet dhe ndryshimet nga rivleresimi (përfshirë ndryshimet nga kursi i këmbimit) ose transaksionet financiare Tremujore

EMRI I FORMULARIT:	Pasqyra e detajuar e mjeteve dhe detyrimeve të Fondeve të Pensionit 1) 6)													
PERIODICITETI:	Tremujor													
MONEDHA E RAPORTIMIT:	Lekë													
NJESIA:	Njësi monetare													
	Sektorët 2)	Sektorët Rezidentë											Jorezidentët	Total
		Banka qendrore	Bankat e nivelit të dytë	Shoqëritë e kursim kreditit	Fondet e Investimit	Ndërmjetës të tjerë financiarë (përveç shoqërive të sigurimit dhe fondeve të pensionit vullnetar) dhe ndihmësit financiarë	Shoqëritë e sigurimit + Fondet e pensionit vullnetar	Qeveria qendrore	Qeveria lokale	Korporata jofinanciare publike	Korporata jofinanciare private	Individët + institucionet jo me qëllim fitimi që u shërbejnë individëve		
I	MJETE													
1	Arka													
	Në lekë													
	Në valutë													
	nga të cilat: në EUR													
	nga të cilat: në USD													
2	Llogari rrjedhëse													
	Në lekë													
	Në valutë													
	nga të cilat: në EUR													
	nga të cilat: në USD													
3	Depozita (pretendime)													
	Deri në një vit													
	Në lekë													
	Në valutë													
	nga të cilat: në EUR													
	nga të cilat: në USD													
	Mbi një vit													
	Në lekë													
	Në valutë													
	nga të cilat: në EUR													
	nga të cilat: në USD													

[illegible]

[illegible]

[illegible]



Shënime: 1) Të dhënat në tabelën 2 duhet të jenë të barabarta me të dhënat respektive të raportuara në bilanc (tabela1).

2) Interesat e përlogaritur raportohen në instrumentin përkatës

3) Shpjegimet për sektorët i gjeni në faqen "Sektorët"

[Sektorët](#)

4) Tituj të borxhit dhe aksionet në këtë formular raportohen me vlerën e tregut.

5) Fonde të tregut të parasë - Fonde të tregut të parasë janë korporata financiare ose thuajse korporata, përveç bankës qendrore dhe institucioneve të kreditit, të cilat emetojnë kuota/aksione të fondeve të investimit që janë zëvendësues të përafërt të

6) Fonde të investimit **jo të tregut të parasë** - të cilat njihen edhe si fonde të përbashkëta ose institucione për investim kolektiv përfshin të gjitha skemat e investimeve kolektive të angazhuara në ndërmjetësim financiar. Aktiviteti i tyre është të emetojë

7) Pasqyra plotësohet vetëm në qelizat ku disponohet informacion.

	Nuk është i aplikueshëm (nuk vendoset vlerë)
	Formulë

Tabela 2
Të dhënat e titujve – databaza “titull për titull”

Kodi ISIN	Nr i ankandit	Emri i titullit të blerë nga sektori bankar	Tipi i instrumentit	Maturiteti	Listimi në bursë	Klasa e instrumentit	Data e emetimit	Data e blerjes	Data e maturimit	Emri i emetuesit	Sektori i emetuesit	Rezidenca e emetuesit	Kodi i vendit të emetuesit	Monedha	Transaksioni (+/-) gjatë periudhës (në vlerë tregu)	Çmimi i blerjes	Vlera e tregut në fund të periudhës	Vlera kontabile në fund të periudhës	Interesi i përlogaritur në fund të periudhës

Tabela 3
Numri i anëtarëve të skemës së pensioneve
Vjetore

Numri i anëtarëve	Total	Nga të cilët: anëtarë aktivë	Nga të cilët: anëtarë pasivë	Nga të cilët: anëtarë në pension
-------------------	-------	------------------------------	------------------------------	----------------------------------



SHTOJCA II PËRSHKRIME

PJESA 1 PËRSHKRIME TË KATEGORIVE TË INSTRUMENTEVE

1. Kjo tabelë ofron një përshkrim standard të detajuar të kategorive të instrumenteve. As lista e instrumenteve financiare individuale në tabelë dhe as përshkrimet e tyre përkatëse nuk synojnë të jenë shteruese. Përshkrimet i referohen Sistemit Evropian të Llogarive të krijuar nga rregullorja (BE) nr. 549/2013 (më tej “ESA 2010”).

2. Për disa nga kategoritë e instrumenteve kërkohen ndarje të maturitetit. Këto i referohen

maturiteti original, pra maturimit në emetim, që është periudha fikse e jetës së një instrumenti financiar përpara së cilës ai nuk mund të blihet, p.sh. tituj të borxhit.

3. Detyrimet financiare mund të dallohen nëse janë të negociueshme apo jo. Një detyrim është i negociueshëm nëse pronësia e tij është lehtësisht e aftë të transferohet nga një njësi në tjetrën me dorëzim ose nënshkrim ose të kompensohet në rastin e derivateve financiare. Ndërkohë që çdo instrument financiar mund të tregtohet, instrumentet e negociueshme janë krijuar për t'u tregtuar në një bursë të organizuar ose “pa bursë”, megjithëse tregtimi aktual nuk është një kusht i domosdoshëm për negociueshmëri.

Tabela A

Përshkrimi i kategorive të instrumenteve në aktivet dhe detyrimet fondeve të pensionit Mjetet

Kategoritë e instrumenteve	Përshkrimi i instrumenteve
1. Monedha dhe depozita	Mbajtja e kartëmonedhave dhe monedhave në lek dhe valutë të huaj në qarkullim që përdoren zakonisht për të bërë pagesa dhe depozita të vendosura nga fondi i pensioneve (FP) pranë institucioneve financiare monetare (IFM). Ato mund të përfshijnë depozitat njëditore, depozitat me afat dhe depozitat me njoftim paraprak, si dhe marreveshjet e anasjella repo, ose borxhi i titujve kundrejt kolateralit në para (kjo zbatohet vetëm nëse pala tjetër është një korporatë depozituese (ESA 2010, paragrafi 5.130).
1.1 Depozita të transferueshme	Depozitat e transferueshme janë depozita të cilat janë drejtpërdrejt të transferueshme sipas kërkesës për të bërë pagesa tek agentët e tjerë ekonomikë me mjete pagese të përdorura zakonisht, si transferimi i kredisë dhe debitimi direkt, mundësisht edhe me kartë krediti ose debiti, transaksione me para elektronike, çeqe ose mjete të ngjashme, pa vonesa, kufizime apo penalite të konsiderueshme. Depozitat që mund të përdoren vetëm për tërheqje parash dhe/ose depozita nga të cilat fondet mund të tërhiqen ose transferohen vetëm përmes një llogarie tjetër të të njëjtit pronar nuk duhet të përfshihen si depozita të transferueshme.
2. Tituj të borxhit	Zotërimet e titujve të borxhit, të cilat janë instrumente financiare të negociueshme që shërbejnë si dëshmi e borxhit, zakonisht tregtohen në tregjet dytësore. Ato gjithashtu mund të kompensohen në treg dhe nuk i japin mbajtësit asnjë të drejtë pronësie mbi institucionin emetues. Kjo kategori përfshin: — zotërimet e titujve të cilat i japin mbajtësit të drejtën e pakushtëzuar për një të ardhur fikse ose të përcaktuar me kontratë në formën e pagesave të kuponit dhe/ose një shumë fikse të deklaruar në një datë ose data specifike, ose duke filluar nga një datë e caktuar në koha e emetimit, — kreditë që janë bërë të tregtueshme në një treg të organizuar dytësor. Nëse nuk plotësohet ky kusht, ato duhet të klasifikohen në kategorinë 3 “Kredi” (shih gjithashtu “kredi të tregtueshme” në të gjitha kategoritë), — borxhi i varur në formën e titujve të borxhit (shih gjithashtu “borxhi i varur në pajisje e huave” në kategorinë 3 “Kredi”).
3. Huat	Për qëllime të kësaj forme raportimit, kjo kategori përbëhet nga fondet e dhëna hua nga FP për huamarrësit, ose hua të marra nga FP-të, të cilat ose janë të evidentuara nga dokumente të panegociueshme ose jo të evidentuara me dokumente. Kjo kategori përfshin zërat e mëposhtëm: — zotërimet e titujve të panegociueshëm: zotërimet e titujve të borxhit të cilat nuk janë të negociueshme dhe nuk mund të tregtohen në tregjet dytësore, — hua të tregtueshme: hua që de facto janë bërë të negociueshme klasifikohen në kategorinë “Hua”, që nuk ka dëshmi të tregtimit të tregut sekondar. Përndryshe ato klasifikohen si tituj borxhi (kategoria 2), — borxhi i varur në formën e huave: instrumentet e borxhit të varur sigurojnë një pretendim shtesë ndaj institucionit emetues që mund të ushtrohet vetëm pasi të jenë përmbushur të gjitha pretendimet me status



	më të lartë, duke u dhënë atyre disa nga karakteristikat e kapitalit. Për qëllime statistikore, borxhi i varur klasifikohet si “hua” ose “tituj borxhi” sipas natyrës së instrumentit. Kur zotërimet e një FP në të gjitha formave të borxhit të varur identifikohen si një shifër e vetme për qëllime statistikore, kjo shifër duhet të klasifikohet nën kategorinë tituj të borxhit, me arsyetimin se borxhi i varur është kryesisht në formën e titujve të borxhit. —pretendimet e marrëveshjeve të riblerjeve repo ose huamarrjen e titujve kundrejt kolateralit në para (kjo zbatohet vetëm nëse pala tjetër nuk është një korporatë depozituese (ESA 2010, paragrafi 5.130)): Kjo kategori përjashton asetet në formën e depozitave të vendosura nga FP (të cilat përfshihen në kategorinë 1).
4. Kapitali	Mjetet financiare që përfaqësojnë të drejtat e pronësisë në korporata ose thuajse-korporata. Mjete të tilla financiare përgjithësisht u japin zotëruesve të drejtën për një pjesë në fitimet e korporatave ose kuazikorporatat, dhe për një pjesë në aktivet e tyre neto në rast likuidimi. Kjo kategori përfshin aksione të listuara dhe të palistuara dhe kapitale të tjera.
4.1Aksione të listuara	Titujt të kapitalit të listuara në bursë. Bursa mund të jetë një bursë e njohur ose çdo formë tjetër e tregut dytësor. Aksionet e listuara quhen gjithashtu aksione të kuotuar.
4.2Aksione të palistuara	Aksionet e palistuara janë tituj të kapitalit që nuk janë të listuara në bursë
4.3.Kapitale të tjera	Kapitali tjetër përfshin të gjitha format e kapitalit, përveç aksioneve të listuara dhe aksioneve të palistuara.
5. Kuotat e fondeve të investimit	Kjo kategori përfshin zotërimet e aksioneve ose njërive të emetuara nga fondet e tregut të parasë (FTP) dhe fondet e investimeve joFTP (d.m.th. fondet e investimeve të ndryshme nga FTP).
5.1 Aksionet e FTP	Zotërimet e aksioneve ose kuotave të emetuara nga FTP.
5.2 Aksionet e jo FTP	Zotërimet e aksioneve ose kuotave të emetuara nga fondet e investimeve (FI) të ndryshme nga FTP-të.
6. Rezervat e fondeve të pensionit	Kjo kategori përfshin: — pretendimet e PF-ve ndaj menaxherëve të pensioneve siç përkufizohen në ESA 2010, paragrafët 5.186 dhe 17.78, — pretendimet financiare të FP-ve ndaj korporatave të risigurimit të lidhura me rezervat e pensioneve (të rikuperueshmet nga risigurimi).
7. Derivatet financiare	Derivatët financiarë janë instrumente financiare të lidhura me një instrument financiar të caktuar, tregues ose mall, nëpërmjet të cilit rreziqet financiare specifike mund të tregtohen në tregjet financiare më vete. Kjo kategori përfshin: — opsionet, — garancitë, — kontratat e së ardhmes, — transfertat, — shkëmbimet, — derivativët e kredisë. Derivatët financiarë regjistrohen me vlerën e tregut në bilanc në bazë bruto. Kontratat individuale derivative me vlera pozitive tregu regjistrohen në anën e mjeteve të bilancit dhe kontratat me vlera negative të tregut në anën e detyrimeve të bilancit. Angazhimet bruto të ardhshme që rrjedhin nga kontratat derivative nuk duhet të futen si zëra në bilanc. Derivatët financiarë mund të regjistrohen në bazë neto sipas metodave të ndryshme të vlerësimit. Në rast se vetëm pozicionet neto janë të disponueshme, ose pozicionet regjistrohen ndryshe nga vlera e tregut, këto pozicione raportohen në vend të tyre.
8. Llogari të tjera të arkëtueshme/pagueshme	Ky është zëri i mbetur në anën e të tjerëve, që është aktiv në shoqërinë e “pasuri që nuk merr pjesë”. BSH-të mund të raportojnë e nën-pozicioneve të veçanta të përfshira në këto kategori, të tilla si: — dividendët e arkëtueshëm, — interesi i akumuluar i arkëtueshëm nga depozitat, — interesi i përllogaritur i arkëtueshëm nga huat, — interesi i përllogaritur i arkëtueshëm për titujt me vlerën e borxhit, — qiraja e përllogaritur e arkëtueshme, — shumat e arkëtueshme të cilat nuk kanë të bëjnë me biznesin kryesor të FP.
9. Mjete të tjera jofinanciare	Mjete të qëndrueshme dhe të paqëndrueshme, të ndryshme nga mjetet financiare. Kjo kategori përfshin, ndërtesat dhe pajisjet e tjera, makineritë, produktet e pronësisë intelektuale si softuerët kompjuterikë dhe bazat e të dhënave.



Detyrimet

Kategoritë instrumenteve	Përshkrimi i instrumenteve
10. Hua të marra	Shumat e borxhit ndaj kreditorëve nga FP, përveç atyre që dalin nga emetimi i titujve me vlerë të negociueshme. Kjo kategori përbëhet nga: — kreditë: hua e dhëna PF-ve të cilat ose janë të evidentuara me dokumente të panegociueshme ose të padëshmuara me dokumente, — marrëveshjet e riblerjes repo dhe tituj kundrejt kolateralit në para. — kolaterali në para i marre në këmbim të titujve të huazuar: — Kolaterali në para i marre në operacionet që përfshijnë transferimin e përkohshëm të arit kundrejt kolateralit.
11. Titujt të borxhit të emetuar	Tituj të emetuar nga FP, përveç kapitalit, që zakonisht janë instrumente të negociueshme dhe tregtohen në tregje dytësore, ose që mund të kompensohen në treg dhe nuk i japin mbajtësit asnjë të drejtë pronësie në lidhje me institucionin emetues.
12. Kapitali	Shiko kategorinë 4.
13. Rezervat teknike	Shuma e kapitalit që FP mban për të përmbushur kërkesat e ardhshme të pretendimeve të pensioneve të anëtarëve e tij.
13.1. Nga të cilat përfitimet e pensioneve	Shuma e kapitalit që FP mban për të përmbushur kërkesat e ardhshme për përfitimet të skemave të tij të pensioneve.
përfitimet e pensioneve, nga të cilat skema të përcaktuara kontributi	Shuma e që FP mban në mënyrë që të plotësojë kapitalin e tij të pensioneve të anëtarëve të saj. Në një skemë kontributesh të tjera, të ardhurat janë paguar nga performanca e mjeteve të fituara nga skema e pensioneve. Detyrimet i një skeme të përcaktuar kontributesh janë sa vlera e tregut të mjeteve të fondit.
Përfitimet e pensioneve, nga të cilat skema të përcaktuara përfitimi	Shuma e kapitalit që FP mban në mënyrë që të plotësojë kërkesat e ardhshme të pensioneve të anëtarëve të tij të skemës së përfitimeve të përcaktuara. Në një skemë pensioni me përfitime të përcaktuara, niveli i përfitimeve të pensioneve që u premtohen anëtarëve përcaktohet nga një formulë e rënë dakord paraprakisht. Detyrimi i një skeme pensioni me përfitime të përcaktuara është i barabartë me vlerën aktuale të përfitimeve të premtuara. <i>Skemat nocionale</i> të kontributeve të përcaktuara dhe <i>skemat hibride</i> grupohen si skema të përfitimeve të përcaktuara. Një skemë nocionale e kontributeve të përcaktuara është e ngjashme me një skemë kontributesh të përcaktuara, por me një shumë minimale të garantuar për t'u paguar. Skemat hibride janë ato skema të cilat kanë një element përfitimi të përcaktuar dhe një element kontributi të përcaktuar.
14. Pretendimet e fondeve të pensionit për menaxheret e pensionit	Shiko kategorinë 6
15. Përfitimet për jopërfituesit e pensioneve	Kjo është tejkalimi i kontributeve neto mbi përfitimet, që paraqet një rritje të detyrimit të skemës së sigurimit ndaj përfituesve.
16. Derivatet financiare	Shiko kategorinë 7
17. Llogari të arketueshme/pagueshme	Ky është zëri i mbetur në anën tjetër të bilancit, i përcaktuar si “detyrime të papërfshira diku tjetër”, të tilla si: — shumat e pagueshme që nuk lidhen me biznesin kryesor të FP-së, d.m.th. shumat që detyrohen furnitorëve, taksave, pagave, sociale etj. pensionet, dividendët etj., — pozicionet e neto që rrjedhin nga huadhënia e titujve me vlerë e pakolateralit në para, — shumat neto të pagueshme në lidhje me shlyerjet e tyre, të cilat kanë vlerë në titujt, — interesi i përlogaritur i pagueshëm për hua.
18. Net worth	Ky është zëri balancues i një bilanci.

PJESA 2

PËRSHKRIMET E ATRIBUTEVE TË RAPORTIMIT “TITULL PËR TITULL”

Tabela B

Kategoria	Përshkrimi
1. ISIN	Kodi ISIN përfaqëson një numër identifikues të veçantë për çdo titull
2. Emri i titullit	Emri i titullit përfaqëson emrin e titullit që raportohet, ashtu siç është specifikuar në kontratë.)
3. Tipi i instrumentit	Tipi i instrumentit përfaqëson tipin e titullit, si tituj kapitali-aksione më pak se 10%, obligacione dhe dëftesa, bono thesari, derivativë financiarë etj.
4. Listimi në bursë	Listimi në bursë tregon nëse titulli është e listuar apo jo në një treg të organizuar titujsh, bursë
5. Klasa e instrumentit	Klasa e instrumentit tregon nëse titulli është i tregtueshëm, e vendosjes apo e investimit.)
6. Data e emetimit	Data e emetimit përfaqëson datën kur instrumenti është emetuar për herë të parë.



7.Data e blerjes	Data e blerjes përfaqëson datën kur subjekti raportues ka blerë instrumentin
8.Data e maturimit	Data e maturimit përfaqëson datën kur instrumenti është maturuar
9.Emri i emetuesit	Emri i emetuesit tregon emrin e subjektit që ka emetuar titullin
10.Sektori i emetuesit	Sektori institucional sipas kategorive të përcaktuara në ESA.
11.Rezidenca e emetuesit	Rezidenca e emetuesit tregon shtetin e rezidencës së subjektit që ka emetuar titullin.
12.Emri i zotëruesit	Emri i zotëruesit tregon emrin e subjektit që zotëron titullin.
13.Sektori i zotëruesit të titullit	Sektori institucional sipas kategorive të përcaktuara në ESA.
14.Monedha	Monedha tregon monedhën origjinale në të cilën titulli është emetuar dhe në të cilën shlyhet apo ripaguhet.
15.Transaksioni	Transaksioni gjatë periudhës tregon blerjen ose shitjen e titullit gjatë periudhës.
16.Vlera e tregut në fund të periudhës	Vlera e tregut në fund të periudhës përfaqëson vlerën e tregut të stokut të titullit në fund të periudhës.
17.Vlera kontabile në fund të periudhës	Vlera kontabile në fund të periudhës përfaqëson vlerën kontabile të stokut të titullit në fund të periudhës.
18.Interesi i përlogaritur në fund të periudhës	Interesi i përlogaritur në fund të periudhës përfaqëson interesin e përlogaritur për titujt e borxhit: obligacione dhe dëftesa, bono thesari etj.
19.Dividendi i paguar	Dividendi i paguar përfaqëson dividendin që paguhet për titujt të tipit “aksione më pak se 10% e kapitalit”.
20.Interesi i përlogaritur gjatë periudhës	Interesi i përlogaritur gjatë periudhës përfaqëson pjesën e interesit që përlogaritet vetëm për atë periudhë (fluksi). Kjo vlerë llogaritet si diferenca e stoqeve të interesit të dy periudhave të njëpasnjëshme minus interesin e paguar. Vlera është gjithmonë pozitive dhe kërkohet për titujt e borxhit.
21.Interesi i paguar	Interesi i paguar përfaqëson interesin e paguar për titujt të borxhit: obligacione dhe dëftesa, bono thesari etj.

PJESA 3

Tabela C

Përshkrimi i anëtarëve të fondeve të pensionit

Kategoria	Përshkrimi
22.Numri i anëtarëve të skemave të pensionit	Numri i përgjithshëm i anëtarëve të skemave të pensionit. Kjo shumë është e barabartë me shumën e anëtarëve aktivë, anëtarëve pasivë dhe anëtarëve në pension. Shihni kategoritë 2, 3 dhe 4.
23.Nga të cilët anëtarë aktivë	Numri i anëtarëve aktivë të skemës së pensioneve. Anëtar aktiv është një anëtar i skemës së pensioneve që jep kontribute (dhe/ose në emër të të cilit po bëhen kontributet) dhe po grumbullon mjete ose ka mjete të grumbulluara në të kaluarën dhe nuk është ende në pension.
24.Nga të cilët anëtarë pasivë	Numri i anëtarëve pasivë të skemës së pensioneve. Një anëtar pasiv është një anëtar i skemës së pensioneve i cili nuk kontribuon më ose nuk grumbullon përfitime nga skema, por nuk ka filluar ende të marrë përfitime pensioni nga ajo skemë.
25.Nga të cilët anëtarë në pension	Numri i anëtarëve në pension të skemës së pensioneve. Një anëtar i pensionuar është një anëtar i skemës së pensioneve, i cili nuk kontribuon më ose nuk grumbullon përfitime nga skema dhe ka filluar të marrë përfitime pensioni nga kjo skemë.

PJESA 4

PËRSHKRIMET SIPAS SEKTORËVE

ESA 2010 ofron standardin për klasifikimin e sektoreve insitucionale. Tabela D jep një përshkrim të detajuar të sektorëve subjektet raportuese duhet

të përdorin në klasifikimet e tyre kombëtare në përputhje me këtë rregullore. Kundërpartite rezidentë identifikohen sipas sektorit të tyre në përputhje me listat e publikuara nga BSH-ja dhe INSTAT-i për qëllime statistikore.



Tabela D

Sektori	Përshkrimi
1. Qeveria qendrore	Përfshin të gjitha departamentet administrative të shtetit dhe agjencitë qendrore kompetencat e të cilave shtrihen mbi të gjithë territorin ekonomik të vendit. Të tilla janë ministrat dhe administrata publike qendrore, organizatat jo me qëllim fitimi të kontrolluara nga qeveria
2. Qeveria lokale	përfshin bashkitë dhe pushtetin lokal. Të përfshira në këtë nënsektor janë gjithashtu, ato institucione jofitimprurëse, të cilat janë të kontrolluara nga pushteti vendor dhe që ushtrojnë aktivitetin e tyre vetëm brenda territorit ekonomik të qeverisë lokale.
3. Fondet e sigurimeve shoqërore	përfshin njësitë institucionale qendrore dhe lokale aktiviteti kryesor i të cilave është të sigurojë përfitime sociale dhe plotësojnë këto kriterë: a) me ligj ose me rregullore, grupe të caktuara të popullsisë janë të detyruara të marrin pjesë në skema ose të paguajnë kontributet ; dhe b) qeveria e përgjithshme është përgjegjëse për menaxhimin e institucionit në lidhje me zgjidhjen ose miratimin e kontributeve dhe përfitimeve në mënyrë të pavarur nga roli i tij si organ mbikëqyrës ose punëdhënës.
4. Banka qendrore	funkcioni kryesor i saj është që të emetojë monedhën, të ruajë vlerën e brendshme dhe të jashtme të monedhës si dhe të mbajë të gjitha ose një pjesë të rezervave ndërkombëtare të vendit.
5. Banka	të gjitha subjektet që ushtrojnë veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë në bazë të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë.
6. Shoqëritë e kursim kreditit	janë institucione jo me qëllim fitimi, të cilat organizohen si bashkime vullnetare të personave juridikë ose fizikë. Ato mbledhin fonde nga anëtarët e tyre dhe u japin kredi vetëm anëtarëve të tyre. Veprimtaria e tyre rregullohet nga ligji “Për shoqëritë e kursim-kreditit” nr. 8782, datë 3.5.2001 dhe nga rregulloret e Bankës së Shqipërisë.
7. Fondet e investimeve	të cilat njihen edhe si fonde të përbashkëta ose institucione për investim kolektiv përfshin të gjitha skemat e investimeve kolektive të angazhuara në ndërmjetësim financiar. Aktiviteti i tyre është të emetojë aksione dhe kuota të fondeve të investimit, të cilat mund të jenë ose jo zëvendësues të afërt të depozitave, dhe bëjnë investime në mjete financiare afatshkurtra dhe afatgjata dhe në aktive jofinanciare (zakonisht në pasuri të patundshme). Në Shqipëri këto institucione operojnë në përputhje me ligjin nr. 10 198, datë 10.12.2009, “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”. Shoqëritë administruese të fondeve të investimit nuk klasifikohen në këtë sektor, por klasifikohen si “Ndërmjetës të tjerë financiarë dhe ndihmësit financiarë”.
8. Ndërmjetës të tjerë financiarë (përveç shoqërive të sigurimit dhe fondeve të pensionit vullnetar) dhe ndihmësit financiarë	– përfshin të gjitha institucionet e tjera që kryejnë ndërmjetësim financiar apo lehtësojnë ndërmjetësimin financiar (përfshijë kompanitë e sigurimit dhe fondet e pensionit) të tillë si, institucionet e kreditit, institucionet që ofrojnë qiranë financiare (<i>leasing</i>), institucionet e financimit të transaksioneve tregtare, institucionet e mikrokredisë, faktoringut, të gjitha shërbimet e pagesave dhe transferimit të parave, unionet e Shoqërive të Kursim Kreditit, shoqëritë administruese të fondeve të investimit dhe të fondeve të pensionit vullnetar etj.
9. Shoqëritë e sigurimit	- ofrojnë shërbimet e sigurimit të jetës dhe jojetës për individë dhe kompani, si edhe risigurimin e kompanive të tjera të sigurimit. Këto kompani u sigurojnë përfitime financiare klientëve dhe personave të mbijetuar në raste aksidentesh, sëmundjesh, vdekjesh, katastrofash natyrore etj. Kompanitë e sigurimit financiar ose të sigurimit të kredisë sigurojnë mbulimin e riskut të humbjes financiare nga mos pagesat e ndryshme të kredisë etj.
10. Fondet e pensionit vullnetar	- përfshin të gjitha kompanitë, të cilat janë të angazhuara kryesisht në ndërmjetësim financiar si pasojë e grupimit të rreziqeve sociale dhe të nevojave të personave të siguruar. Fondet e pensioneve ashtu si skema e sigurimeve shoqërore, sigurojnë të ardhura pas daljes në pension dhe përfitime në raste paaftësie dhe vdekje. Në këtë nënsektor përfshihen vetëm fondet e pensioneve të cilat janë njësi institucionale të ndara nga kompanitë që i krijojnë ato. Të tilla fonde autonome kanë autonominë e vendimmarrjes dhe mbajnë një grup të plotë të llogarive, përfshirë bilancin kontabël. Pjesëmarrja në këto fonde është vullnetare dhe nuk përjashton detyrimin e personave për t'u siguruar sipas dispozitave ligjore në fuqi.
11. Korporatat jofinanciare publike	- janë korporata jofinanciare rezidente, thuajse korporata dhe institucione jo me qëllim fitimi, të angazhuara në prodhim tregu, që kontrollohen dhe financohen kryesisht nga qeveria. Kontrolli mund të ushtrohet nga zotërimi i më tepër se gjysmës së të drejtave votuese ose nëpërmjet ligjit, me dekrete ose me rregullore, të cilat vendosin politikën nëpërmjet të cilës qeveria mund të emërojë drejtuesit. Këtu përjashtohen institucionet jo me qëllim fitimi, të cilat nuk angazhohen në prodhim tregu.
12. Korporatat jofinanciare private	– përfshijnë të gjitha njësitë institucionale, të cilat janë subjekte juridike të pavarura të krijuara me qëllim prodhimin e mallrave dhe shërbimeve jofinanciare për tregun dhe që nuk kontrollohen nga qeveria. Këtu përfshihen korporata jofinanciare rezidente, thuajse korporata dhe institucione jo me qëllim fitimi



	të angazhuara në prodhimin e mallrave dhe shërbimeve për tregun. Thuajse korporatat janë ndërmarrje joaksionere, të cilat funksionojnë si korporata. Që një thuajse korporatë të ekzistojë, ajo duhet të jetë e aftë të krijojë një plan të plotë llogarish, duke përfshirë bilancin kontabël, për të dalluar thuajse korporatën nga pronarët e saj. Mjetet dhe detyrimet e lidhura me biznesin të thuajse korporatës duhen ndarë nga mjetet dhe detyrimet e pronarëve. Gjithashtu, duhet të jetë i mundur identifikimi i flukseve të kapitalit dhe të të ardhurave që shkaktohen midis thuajse korporatës dhe pronarëve të saj. Praktikisht, në nënsektorin e korporatave jofinanciare do të klasifikohen të gjitha shoqëritë tregtare private (jofinanciare) ose bizneset private të cilat ushtrojnë aktivitetin e tyre në përputhje me Ligjin nr. 9901 dt. 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”. Përfshijmë bëjnë vetëm personat fizikë të cilët ushtrojnë aktivitetin e tyre në përputhje me nenin 1 të ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe që do të klasifikohen në sektorin “Individët” (ekonomitë familjare).
